



# Vlerësimi i situatës së minoriteteve etnike në Kosovë

(në periudhën kohore prej qershorit deri në shtator 2000)

## Përmbledhje ekzekutive

Në këtë raport të përbashkët dhe të gjashtin me radhë, qëllimi ynë është që t'ju paraqesim një pasqyrë të përgjithshme lidhur me gjendjen ekzistuese me të cilën përballohen komunitetet e minoriteteve në Kosovë; duke përshkruar kështu qështjet e sigurisë të cilat ndikojnë në minoritete; dhe duke ilustruar efektet kumulative në mirqenien e këtyre komuniteteve si pasojë e mungesës së vazhdueshme të sigurisë së tyre.<sup>1</sup>

Duke përkujtuar raportet e mëhershme, jemi munduar që të përqëndrohemi në qështjet e caktimit të kornizave organizative. Sfidat janë duke u shtuar dhe duke u bërë më komplekse por mbetet në përgjegjësi të bashkësisë ndërkombëtare e posaqërisht në UNMIK dhe KFOR, e që është më me rëndësi gjithashtu edhe në përgjegjësi të të gjithë Kosovarëve që ti adresojnë ato. Ne përshkruajmë përmirësimet aty ku kanë ndodhur dhe afirmojmë ato veprime të cilat ende janë të nevojshme për sigurimin e një mbrojtje të plotë të minoriteteve, duke u lejuar atyre të luajnë një rol aktiv dhe të plotë në zhvillimin së ardhmes së Kosovës. Vetëm atëherë kur kjo të arrihet do të jetë e mundur për minoritetet ekzistuese që të mbesin këtu, me besim në një të ardhme të qëndrueshme, dhe për dhjetra mijëra refugjatë dhe të çvendosur të kthehen në siguri dhe me dinjitet.

Ekipi i përbashkët ad hoc mbi minoritetet, bashkarisht të udhëhequra nga UNHCR-ja dhe OSBE-ja, ka vazhduar të jetë forum për diskutime dhe qasje të gjërsishme të qështjeve që kanë të bëjnë me minoritetet. Gjatë muajve të kaluar ekipi i përbashkët ka zhvilluar një rishqyrtim sistematik të një numri të problemeve madhore dhe kjo punë ka kontribuar në pregaditjen e këtij raporti. Ndhimesa kryesore dhe vazhdon të jetë megjithatë, ka ardhur nga informacionet si rrjedhë e prezencës së të dy organizatave në terren. Pra prezenca në terren është ajo e cila na mundëson që të kemi një pasqyrë të gjërë se si e kalojnë minoritetet.

Siguria **adekuate** mbetet qështja kryesore për minoritetet. Ajo që ka nxitur dhe njëkohësisht është përshkruar në këtë raport është rritja e shumëllojshmërisë së përvojave të minoriteteve. Për disa si p.sh. Romët në pjesën veriore të Kosovës, për periudhën të cilën përfshinë ky raport, ka pasur incidente serioze në numër dukshëm të ulët. Megjithatë gjendja për shumicën e grupeve minoritare mbetet e pasigurtë. Incidentet e përshkruara tregojnë se nuk duhet të knaqemi lidhur me gjendjen e sigurisë. Periudhat e gjata relativisht të qeta mund të ndërprehen nga incidentet e dhunës. Ngacmimi i vazhdueshëm dhe i shkallës së ulët ndaj minoriteteve gjithashtu mund të ketë efekt demoralizues dhe gjendje të paqëndrueshme. Mungesa e sigurisë vazhdon të kufizojë lirinë e lëvizjes. Këto ndikime ndaj komuniteteve dhe individëve janë shkatërruese ku disa prej të cilëve kanë kaluar gati më tepër se një vit pa liri efektive të lëvizjes. Fakti se kjo qështje mbetet e njëjtë prej një vlerësimi në vlerësimin tjetër na përkujton punën e madhe që kërkohet nga bashkësia ndërkombëtare.

**Përgjigja e bashkësisë ndërkombëtare** është kryesore në përcaktimin se çfarë të ardhme të qëndrueshme minoritetet mund të presin. Ndërsa qasja e bashkësisë ndërkombëtare është e ndryshme. Shumë agjencione akoma kanë nevojë për të bërë më shumë në orvatjet e tyre

<sup>1</sup> Ashtu si në raportet e mëhershme, ne definojmë minoritetet etnike si grupe të cilat për nga numri janë minoritet në raport me fqinjët e tyre të afërt në një pjesë të caktuar të Kosovës. Në bazë të kësaj nuk kemi konsideruar Sërbët e Kosovës në ato komuna të veriut ku ata përbëjnë shumicën numerike por kemi përfshirë shqiptarët e Kosovës që gjinden në ato lokacione specifike dhe ndjejnë vehtën si minoritet dhe përballen me të njëjtat probleme me të cilat përballohen shumica e minoriteteve në Kosovë.

për nevojat e minoritetëve, krahas komunitetit të shumicës. Vlerësimet tregojnë një përgjigje të ndryshme, prej një komuniteti në komunitetin tjetër, prej një regjioni në regjionin tjetër. Në regjionet sikur janë pjesa perendimore, dhe së fundi në jug-lindje, përgjigjet kreative nga autoritetet, përfshirë këtu edhe masat speciale të sigurisë dhe patrollimet e shtuara, si duket kanë ndihmuar zbutjen e situatës. Numri i policëve të UNMIK-ut vazhdon të ngritet. Raportet e mira ndërmjet minoriteteve dhe autoriteteve për siguri janë jetësore, por jo edhe të vetmet që së risigurohen minoritetet se mbrojtja e tyre konsiderohet si qështje serioze. Vlerësimet tregojnë se është bërë një përparim në këto raporte por ende duhet punë dhe sfida të reja që shfaqen krahas bartjes së përgjegjësisë në subjektet vendore.

**Një sistem gjyqësor efektiv dhe i drejtë** është kusht i domosdoshëm për një shoqëri demokratike. Vetëm me një sistem gjyqësor plotësisht funksional dhe i paanshëm mund të vendoset sundimi ligjor dhe pandëshkueshmëria të kundërshtohet. Kjo ka rëndësi të posaqme në Kosovë ku minoritetet konsiderojnë vehten si subjekt i një gjyqësie jo të drejtë. Fatkeqësisht në disa raste ky vlerësim duket se ka dalur në dritë. Roli i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar në kuadër të sistemit gjyqësor vendor duhet edhe më tej të zhvillohet dhe të sigurojmë që potenciali i tyre shfrytëzohet në mënyrë maksimale. Mbështetja e tyre nuk duhet kufizuar pjesmarrjen e tyre të drejtë për drejtë vetëm në rastet ku përfshihen minoritetet. Më e dëshirueshme do të ishte që ata të shihen si një burim me vlerë, që kontribuon në procesin e vlerësimeve të zhvillimit të gjyqësisë dhe që ofrojnë mbështetje dhe këshillime adekuate.

Jashta përkujdesjes së shqetësimeve imediate të sigurisë, paraqitet nevoja e një qasje të gjithanshme të ndihmoj pajtimin ndërmjet grupeve minoritare dhe shumicës shqipëtare të Kosovës. Vetëm me përparimet në këtë drejtim, mund të garantohet një realizim afatgjatë i sigurisë. Derisa janë ndërmarrur disa hapa përshëndetës në nivel qendror ku përfshihen të gjitha grupet, dhe në nivelin lokal ndërmjet shqipëtarëve e fqinjëve të tyre, romëve dhe sllavëve musliman, disa zhvillime të konsiderueshme janë mundësuar edhe në nivelin lokal ndërmjet shqipëtarëve dhe serbëve. Raporti përshkruan disa **iniciativa të rëndësishme** të ndërmarra në raport me adresimin e nevojave të minoriteteve, përfshirë këtu edhe memorandumun e mirëkuptimit në mes të PSSP dhe kns, platforma për veprim të përbashkët për komunitetin e romëve, hashkalive dhe egjiptasve, konferenca e arli house-it e cila ka për qëllim ndihmimin e dialogut ndërmjet serbëve dhe shqipëtarëve të Kosovës dhe zërat e fuqishme të komunitetit të OJQ-ve duke dënuar dhunën. Të gjitha këto mund të përshkruhen si "nisma të mira". Ajo çka mbetet të shiqohet është si si do të zhvillohen këto iniciativa në hapa praktik dhe të qëndrueshëm.

Raporti i kthehet qështjeve kryesore të cilat janë qasur nga ana e vlerësimeve të mëhershme dhe gjurmon se cilat nga këto qështje janë zgjedhur dhe ku duhet të përqendrohen orvatjet e mëtutjeshme. Në gati secilin regjion, përgjigja e autoriteteve mund të përshkruhet si e përzier. Në disa regjione ka pasur iniciativa që janë vërejtur dhe njëkohësisht të mira, por një qëndrim i gjithanshëm drejt mbrojtjes së mbrojtjes së të drejtave kryesore të minoriteteve akoma mungon në shumë qështje të rëndësishme.

Qasja në shërbimet elementare ende mbetet kritike. Ne i rikthehemi qasjes në **arsimim, shëndetësi, shërbime publike dhe mirëqenie sociale**, dhe qasjeve se si këto nevoja të minoriteteve përballen në realitet. Ne i ndërmarrim këto vlerësime përkunër ndryshimeve të shpejta në rëmbjen e mbështetjes. Ndihma humanitare është reduktuar dhe fokusimi shkon në drejtim të subjekteve afatgjate që do të takohen me nevojat sociale. Është mirë që të analizohet në këtë fazë se në çfarë mase këto sisteme do të përballen me nevojat e minoriteteve. Ky raport tregon se qasja e shumicës së minoriteteve në shërbimet elementare mbetet në kufizuar për shkaqe sigurie dhe mungesës së lirisë së lëvizjes, por gjithashtu edhe për shkak të diskriminimit të drejt për drejtë dhe politikës së efekteve diskriminuese indirekte. Jo diskriminimi është një nga parimet elementare të të drejtave të njeriut. Diskriminimi duhet kundërshtuar me veprime të patundura nga ana e bashkësisë ndërkombëtare në mënyrë që të shtrojë një bazë solide e cila do të mundësojë vazhdimin e ndërtimit të sistemeve lokale.

**Qasja në media** – në baza të drejta dhe të barabarta është kryesore për ofrimin e sensit për minoritetet që i takojnë Kosovës dhe është kryesore për promovimin e pajtimit. Hapat janë marrë në zgjidhjen e qështjes së **fjalimit të urrejtjes** në media, i cili nxitë jotolerancën ndëretnike. **Punësimi** është qështje kryesore për sigurimin e minoriteteve të kenë një të ardhme të qëndrueshme. Një ligj anti-diskriminues i cili do të zbatohet rigorozisht është mëse

i nevojshëm. Gjithashtu edhe hapa të posaqëm duhet të merren nga ana e autoriteteve publike në promovimin dhe mbajtjen e punësimit të minoriteteve.

Me zgjedhjet komunale është kritike edhe shqyrtimi i qështjes së qasjes në **strukturat politike**. Në këtë periudhë, në kohën më të madhe, minoritetet përfshirë këtu edhe sërbyt e Kosovës kanë marrë pjesë në strukturat qeveritare në kuadër të strukturës së përbashkët dhe të përkohshme administrative. Sidoqoftë sërbyt dhe turqit e Kosovës nuk kanë marrë pjesë gjatë gjithë kohës në procesin e regjistrimit dhe për atë shkak nuk do të marrin pjesë në zgjedhjet e 28 tetorit. Organet ekzekutive të formuara pas zgjedhjeve, që parashihet të kenë përgjegjësinë për udhëheqjen së komunave, munden megjithatë të mos përfaqësohen nga përfaqësuesit e popullatës për të cilën janë të zgjedhur. Si rezultat i kësaj kërkohet një mbikqyrje e afërt nga ana e bashkësisë ndërkombëtare në sigurimin se të drejtat dhe nevojat bashkësisë të minoriteteve nuk do të mbeten të pa vërejtura.

Qështje kryesore për shumicën e Kosovarëve, për që posaqërisht kanë efekt në minoritetet është qështja e pronës. Mungesa e qasjes në mekanizmat efektive në të dyjat edhe të mbrojtjes së të drejtave pronësore dhe të lejimit të rindërtimit të shtëpive, është një prej faktorëve të cilët parandalojnë rikthimin e minoriteteve. Një përparim i kufizuar i drejtorisë për qështje pronësore dhe banesore dhe komisionit të ankesave paraqet shqetësim të veçantë. Kjo qështje do të ketë rëndësi të shtuar gjatë vitit të ardhshëm.

Një tregues se si minoritetet e shohin të ardhmen e vet mund të shihet në lëvizjet e popullatës. Pasqyra e nisjeve, kthimeve dhe çvendosjeve të mbrendshme është e përzier. Disa bashkësi minoritare, posaqërisht sërbyt e Kosovës në pjesët urbane vazhdojnë të largohen për shkaqe të vazhdueshme të sigurisë. Në anën tjetër në këtë periudhë është parë edhe një rikthim spontan i një shkalle të ulët por i shpërndarë i komuniteteve minoritare e gjithashtu edhe disa hapa drejt mundësisë së rikthimit të organizuar. Krijimi i një forumi siq është komisioni i përbashkët për kthimin e sërbeve ka ofruar një mekanizëm punues për të gjithë akterët e interesuar të diskutojnë qështjet e interesit të përbashkët dhe koordinimin e veprimeve adekuate. Një qasje e gjithanshme dhe e koordinuar nga ana e bashkësisë ndërkombëtare në të gjitha qështjet që kanë të bëjnë me minoritetet e në veqanti qështjet e sigurisë, pronës, punësimit dhe qasjes në shërbime do të jetë e domosdoshme që kthimi të jetë i sigurtë dhe i qëndrueshëm.

Një vit pas publikimit të vlerësimit të parë të situatës së minoriteteve, një përparim i padyshimtë është arritur në një numër të regjioneve. Megjithatë, në realitet kushtet momentale në komunitetin e shumicës dhe minoriteteve rrjedhin kryesisht në drejtime paralele dhe në shumicën e rasteve akoma janë jo adekuate. Shembuj të sukseshëm në shkëmbimin e shërbimeve ekzistojnë dhe derisa kjo nuk është e mundur për të gjitha lokacionet apo për të gjitha rastet, qëllimi i gjithmbarshëm dhe krijimi i një sistemi me qasje të barabartë dhe të drejtë nuk duhet të harrohet.

Kosova momentalisht është në një udhëkryq kritik. Zgjedhjet komunale të 28 tetorit dhe implementimi i tyre paraqesin tërheqjen e parë dhe të konsiderueshme të bashkësisë ndërkombëtare nga qeverisja e drejtëpërdrejtë e Kosovës. E një rëndësie të posaqme është që autoritetet e zgjedhura në Kosovë jo vetëm të respektojnë të drejtat e minoriteteve por edhe të marrin hapa pozitiv në përmirësimin e situatës së tyre dhe të ndihmojnë rikthimin e tyre. Muajt e ardhshëm do të vuajnë në sprovë zgjidhjet e bashkësisë ndërkombëtare në sigurimin se trendet e shumëllojshme të cilat paraqiten për dallimin e grupeve minoritare nuk do të qojnë drejt asaj që ndonjë grup të mbetet mbrapa. Qëllim i gjithmbarshëm për të gjithë duhet të jetë që Kosova të sguroj parakushtet për respektimin e të drejtave të njeriut dhe dinjitetin e të gjithë banorëve të saj pa marrë parasyshë dallimet etnike.

## **Siguria**

1. Siguria vazhdon të jetë një çështje që brengos për së tepërmi komunitetet e minoriteteve. Në shumë pikëpamje ajo konsiderohet si **çështje vendimtare** dhe është e parashtuar më shpesh nëpër diskutime që për temë kanë mbrojtjen e minoriteteve se çështjet e tjera. Shkalla e sigurisë apo, siç është shpesh rasti me, pasigurinë, me të cilën ballafaqohen grupet minoritare është kriter themelor në bazë të të cilit edhe matet pësueshmëria e këtyre komuniteteve. Ky raport pasqyron incidentet e sigurisë dhe i vendos këto në kontekst të theksimit (potencimit) të reflektimit të tyre në kualitetin e jetës së minoriteteve

kombëtare në Kosovë. Nëse nuk përmirësohet gjendja e sigurisë, atëherë shumë komunitete minoritare nuk do të jenë të afta që të mbijetojnë në aspektin social e as në atë ekonomik, ato do të jenë të varura nga ndihmat humanitare ashtu që në fund nuk do të kenë ndonjë alternativë (opcion) tjetër përpos për ta lëshuar vendin. Vrasjet, zjarrvënësit dhe format e lehta të frikësimit paraqesin akoma një realitet ditor për shumë komunitete minoritare anëtarët e të cilave pasqyrohen në mënyrë disproporcionale në shifrat që i përkasin viktimave të krimeve. Aq e rëndësishme sa edhe incidentet individuale të dhunës është edhe efekti i tyre akumulues dhe **perceptimi i vazhdueshëm në mesin e minoriteteve i asaj që kuptohet si ndjenjë e pasigurisë në mesin e tyre**. Mungesa e sigurisë vazhdon të kufizojë lirinë e levizjes, e cila liri për shumë komunitete minoritare mund të jetë e mundshme vetëm nëpërmjet të sigurimit të linjave të veçanta të autobusëve dhe përcjelljeve për këto komunitete. Si rezultat i gjithë kësaj, minoritetet vazhdojnë të ballafaqohen me vështirësi për sa i përket qasjes në shërbimet elementare, sikurse që janë kujdesi shëndetësor dhe edukimi i mesëm, ku në të njëjtën kohë ata ballafaqohen edhe me një kualitet mjaft të varfër të jetës.

2. **Shkallët e sigurisë janë të lëkundura (valvitura) në dritën e rrethanave përkatëse që mbizotërojnë në vend.** Kjo pasqyrë ndërron prej komunës në komunë dhe prej komunitetit në komunitet. Derisa shihet një ulje e shkallës së dhunës së drejtuar ndaj disa prej komuniteteve, disa të tjera akoma vazhdojnë ti nënshtrohen sulmeve të pandërprera të dhunës. Ende nuk është e mundshme të thuhet (cekjet) se a është ndonjëra prej grupeve etnike duke u ballafaquar me një përmirësim të vazhdueshëm të gjendjes së sigurisë së përgjithshme apo jo; edhe pas gjithë këtyre muajve të një situatë të qetë, prapëprapë dhuna mund të mbisundojë andaj komunitetet minoritare të gjitha janë të vetëdijshme për faktin se gjithmonë do të ekzistojë kërcënimi me dhunë. Me të vërtetë këthimi i dhunës pas një periudhe kohore pak a shumë më të qetë mund të shkaktojë që disa prej komuniteteve të ndiejnë panik dhe pasiguri, të ballafaqohen me pasoja të thella dhe afatgjate, dhe së fundi e gjithë kjo mund të shkaktojë një dëm gjithë atij përparimi (progresi) të arritur deri në atë moment.

*Në vijim kemi paraqitur një pasqyrë jo të plotë në lidhje me incidentet që kanë të bëjnë me sigurinë e pakicave. Janë bërë përpjekje me qëllim të kategorizimit të llojit të krimeve për të cilat do të bëjmë fjalë këtu, mirëpo duhet të ceket se mund të vie edhe deri te një përputhje e pjesërishtme e interpretimeve të një rasti si p.sh një incident siç është sulmi me granatë mund të klasifikohet si një tentativë për vrasje apo sulm mbi pronën varësisht prej rrethanave nën të cilat ka ndodhur ai incident.*

#### Krimet e rënda (vrasjet, tentativat për vrasje)

3. Ka pasur tendencë gjatë këtyre 4 muajve të fundit që krimet e tilla të kenë natyrë sporadike, mirëpo të përsëritura (qëndrueshme) për sa i përket serbëve, romëve dhe hashkalinjve të cilët janë në shënjestër të dhunës më shumë se grupet e tjera minoritare.
4. Një numër i konsiderueshëm i sulmeve të dhunës të cilat ndodhën gjatë kësaj periudhe kohore ishin më shumë të koncentruara në regjionet e Prishtinës<sup>2</sup> dhe Gjilanit të banuara me serb të Kosovës. Cikli i parë i sulmeve (dhunës) filloi që në fillim të **Qeshorit** me një seri të vrasjeve që ndodhën brenda periudhës kohore prej tre ditëve duke filluar prej 31 majit deri më 2 qeshor. Dy serbë të Kosovës ishin vrarë nga të shtënat prej një makine: një në Kllokot (komuna e Vitisë), ndërsa tjetri në Babin Most (komuna e Obiliqit). Dy serb tjerë të Kosovës vdiqën në Prishtinë nga një minë tokësore e vendosur në rrugën e sapohapur nga KFOR-i që shërben si ndërlidhje në mes të Fushë Kosovës/Kosovo Polje dhe Graçanicës/Ulpianës. Dy serbë të tjerë vdiqën nga një minë tjetër tokësore në Lipjan

<sup>2</sup> Për hir të kontinuitetit dhe me qëllim të referimit më të lehtë emrat e vendeve që janë përdorur në këtë raport vazhdojnë ti përmbahen formatit Serbisht/Shqip i cili është përdorur në raportet e përpiluara mëparë nga ana e UNHCR-së dhe OSBE-së. Sidoqoftë është mirë të ceket se Rregullorja 2000/43 e 27 Korrikut 2000 përmban një listë zyrtare të emrave si për komuna ashtu edhe për rajone kadastrare që formojnë një komunë të vetme, në format Shqip/Serbisht dhe parashikon që çdo lloj i komunikimit zyrtar nuk guxon të përmbajë emra të cilët nuk janë të përfshira në Listën e Rregullores së sipërpërmendur, me përjashtim të atyre komunave në të cilat komunitetet e tjera etnike me veçori tjera gjuhësore se Shqip ose Serbisht formojnë një pjesë të rëndësishme të numrit të përgjishëm të popullatës së atyre komunave, në të cilin rast emrat e këtyre komunave duhet të jipen poashtu në gjuhët e këtyre komuniteteve. Ky është një hap të cilin duhet mirëpritur drejt sqarimit të politikës së përdorimit të gjuhës për sa i përket çështjes se cila gjuhë ku duhet të përdoret. Përgjatë periudhës së raportimit mediat lokale vazhduan të përdorin emra të rinj dhe të panjohur deri në atë moment për qytetet dhe fshatrat nëpër tërë Kosovën.

më 15 qeshor. Kjo rritje e papritur (befasishme) e numrit të vrasjeve të serbëve krijoi frikë dhe zemërim në mesin e komunitetit serb me një numër të madh të serbëve që demonstroi si përgjigje ndaj secilit incident të ndodhur. Ky reagim zemëruar mundej veçanërisht të vërrehej si rezultat i një sulmi me granatë në Graçanicë/Ulpianë me 6 qeshor 2000. Nuk u vra askush mirëpo ndodhi ajo që një turmë e madhe e serbëve filloi të shpreh dufin (zemërimin) e tyre në KFOR-in. Kjo valë e dhunës shtyri KNS-në (Graçanicë) që të suspendoi përkohësisht pjesëmarrjen e saj në strukturat e administratës së përbashkët të përkohshme si protestë ndaj dështimit të bashkësisë ndërkombëtare për të siguruar siguri të mjaftueshme për komunitetin serb në Kosovë. Ata u kthyen në këto struktura vetëm pasi u nënshkrua një deklaratë e përbashkët e mirëkuptimit në mes të UNMIK-ut dhe KNS-së me 29 qeshor, e cila deklaratë fokusohet më shumë në nevojat e sigurisë për komunitetin serb ndër çështjet e tjera. Shkalla e lartë e tendosjes (acarimit të situatës) në mesin e komunitetit serb mundej të vërrehej gjatë fundit të atij muaji, pasi që një bujk serb ishte kidnapuar dhe mëpastaj vlarë në shtëpce me 23 qeshor 2000.<sup>3</sup> Ky kidnapim shpiu kah një demonstratë e madhe e serbëve të Kosovës në qytetin e shtëpces dhe me një shkatërrim të pronës së UNMIK-ut në po në të njëjtin vend. Serbët e Kosovës nuk ishin viktimat e vetme, një djalosh i ri i nacionalitetit boshnjak ishte vlarë në gjakovë me 27 qeshor si dhe një sulm me granatë në lagjen e romëve në Mitrovicë që si rezultat kishte katër persona të lënduar, duke përfshirë këtu edhe një fëmi.

5. **Korriku** filloi me vrasjen e një bujku serb të moshuar në komunën e Gjilanit. Një incident tjetër mjaft i rëndë ndodhi me 13 korrik, kur tre priftërinjë u vranë në incidentin i cili do të mund të ketë qenë i lidhur me komentet e bëra në një artikull të gazetës me 4 korrik (shiko nën media, mëposhtë). Një numër i konsiderueshëm i zjarrvënies dhe sulmeve me granata ishin kryer kundër shtëpive të banuara me pjesëtarë të minoriteteve nëpër tërë provincën, ku më të shquarat ishin ato sulme me granata kundër shtëpive të banuara me romë në Shtimje e cila gjë vazhdoi të ndodh gjatë tërë muajit
6. **Gushti** ishte një muaj i cili nuk kishte pushim sa i përket sulmeve ndaj minoriteteve. Tre hashkalinjë u vranë nga një kurthë shpërthyes në halaç të vogël komuna e Lipjanit me 2 gusht 2000. Një rom u gjet i vlarë poashtu afër fshatit Landovicë komuna e Prizrenit me 25 gusht, si dhe dy trupa të pajetë të romëve u gjetën afër fshatit malësi e vogël komuna e Rahovecit me 30 gusht. Familjet romë në Shtimje vazhduan t'i nënshtrohen sulmeve me granata përgjatë tërë muajit gusht. Pjesëtarët e KFOR-it zbuluan një trup të pajetë të një mashkulli serb afër Lipjanit më 6 gusht, i cili ishte vlarë. Më 27 gusht, u zbulua trupi i pajetë i një Serbi afër Crkvena Vodica/Palaj. Ky zbulim ishte shkak i shumë protestave zemëruese që u organizuan nga ana e komunitetit vendas të serbëve të Kosovës, ku shkak më i madh ishte më shumë edhe incidenti teper i rëndë që ndodhi në po të njëjtin fshat më 18 gusht, që për shënjestër kishte fëmijët serbë që në momentin kur ishte hedhur granata në ta kishin qenë duke luajtur basketboll. Dhjetë fëmijë u lënduan si rrjedhojë e këtij sulmi. Fëmijët serbë ishin përsëri viktimat të një incidenti që për rezultat kishte shkeljen me makinë të fëmijëve dhe kryerësin e veprës që kishte ikur nga vendi i ngjarjes që ndodhi më 27 gusht në skulanovo, afër Lipjan/Lipjan-it, që poashtu si rrjedhojë kishte një fëmijë të vdekur dhe tre të tjerë të lënduar. Vozitësi shqiptar i cili kishte qenë duke e ngasur automjetin u arrestua nën dyshimin se qëllimisht e kishte ngasur atë në drejtim të fëmijëve.
7. Në **shtator** numri i vdekjeve ishte më i vogël edhe pse incidentet e rënda vazhduan të ndodhin me ritëm të njëjtë. Më 7 shtator në Lipjan/Lipjan, një rom mezi arriti që t'i shpëtojë vdekjes pasi që zbuloi një granatë të dorës të montuar si kurthë shpërthyes në portën e cila shfrytëzohej vetëm nga ai dhe nga një grua e moshuar serbe. Një grua tjetër serbe ishte vlarë në Kamenicë më 13 shtator. Një burrë tjetër serb në moshë ishte vlarë afër fshatit crkolez/cerkolez komuna e Istogut. Një burrë tjetër rom u lëndua rëndë nga eksplozimi i një kurthe shpërthyes. Përsëri ajo kurthë ishte montuar në dyrekun e portës dhe ishte detonuar pasi që personi në fjalë e kishte hapur portën. Një burrë serb vdiq më 18 shtator në Gjilan pasi që në të ishte hedhur një granatë derisa po punonte automjetin e tij i cili ndodhej në kopshtin e shtëpisë së tij. Në të njëjtën ditë ndodhi një incident tjetër në Strpce/Shterpce që si rrjedhojë kishte një rom të vdekur dhe tre të tjerë të lënduar. Në vazhdim ndodhën edhe një numër tjetër i zjarrvënies dhe incidenteve me granata kundër pronave të banuara dhe që për pronar kanë pjesëtarë të minoriteteve të cilat incidente mund të konsiderohen si tentativa të vrasjeve.

<sup>3</sup> Trupi i pajetë u gjet katër ditë më vonë, më 27 Qeshor 2000

## Krimet që kanë të bëjnë me pronën – zjarrvëniet/shkatërrimet e pronave/dëbimet me forcë

8. Krimet që kanë të bëjnë me pronën veçanërisht prekin minoritetet. Zjarrvënia, dhe shkatërrimi i pronës shpeshherë paraqitet të jetë e drejtuar kundër dikujt me qëllim që pjesëtarët e minoriteteve ta lëshojnë vendin mëpastaj, ose që të tjerët të mos kthehen në provincë. Zjarrvëniet kishin ngjarë nëpër tërë provincën, me një seri të sulmeve në Orahovac/Rahovec në fillim të qeshorit. Incidentet e përsëritura, duke përfshirë këtu edhe sulmet me granata dhe të shtënat në drejtim të pronës së një Serbi të Kosovës ndodhën në kosovo polje/fushe kosove, komuniteti i serbëve të Kosovës që shpesh përshkruhet nga ana e pjesëtarëve të po këtij komuniteti dhe akterët tjerë ndërkombëtarë. Edhe ngjarje të tjera të rëndësishme siç janë shkatërrimet e kishave kishin ndodhur nëpër vende të tjera siç janë ato që ndodhën në vitina/viti më 30 qeshor, dhe Kosovo Polje/Fushe Kosove më 16 Korrik 2000.
9. Kanë vazhduar edhe presione të tjera mbi minoritetet siç janë ato që për qëllim kanë që minoritetet t'i shesin (apo thjeshtë t'i lëshojnë) shtëpitë e tyre dhe ikin prej aty. Një gjë që mund të shquhet këtu posaqërisht siç është rasti me Fushë Kosovën, është frikësimi i vazhdueshëm i shkallës së ulët në formë të vizitave të përsëritura që i bëhen pjesëtarëve të minoriteteve dhe pronave të tyre, kishte një ndikim serioz në komunitetin e serbëve të Kosovës. P.sh vetëm gjatë një jave në muajin gusht, 5 prej 8 shtëpive serbe të mbetura në qytet ishin shitur. Një lloj aktiviteti i tillë ishte i dukshëm edhe në Obiliç/Obiliq dhe në Lipljan/Lipjan – të gjitha këto në regjionin e Prishtinës. Rasti me shkatërrimin e shtëpive të lëshuara serbe apo që janë dhënë për shitje shqiptarëve të Kosovës vazhdoi edhe mëtej edhe pse në një shkallë më të ulët.
10. Efektet e keqtrajtimit të vazhduar edhe pse në një shkallë më të ulët nuk duhen të nënçmohen. Keqtrajtimit gojore të pjesëtarëve të minoriteteve, të cilat janë si të them të hedhura në hije nga incidentet me natyrë më të dhunshme, vazhdon që të ndikojë në rënien e moralit në mesin e pjesëtarëve të minoriteteve që janë si pjesë e presionit që bëhet në ta me qëllim të lëshimit të vendit. Me rëndësi të veçantë për t'u cekur këtu është edhe involvimi i fëmijëve në incidentet me natyrë keqtrajtuese. Në Lipljan/Lipjan, gjatë muajit korrik filloi përsëri të raportohej mbi keqtrajtimit gojore dhe fyerjet që u bëheshin serbëve prej fëmijëve shqiptarë, pas gati disa muajve qetësie në këtë aspekt.<sup>4</sup>

## **Bashkëveprimi ndërmjet komunitetit ndërkombëtar dhe komuniteteve vendore**

11. Gjatë këtyre pesëmbëdhjetë muajve që prej komuniteti ndërkombëtar kishte hyrë në Kosovë, ai kishte pasur rast që të zhvillojë dhe përmirësojë përgjegje të përshtatshme dhe adekuate për sa i përket problemeve të sigurisë që vazhdojnë të ekzistojnë edhe mëtej në Kosovë. Siç është cekur (potencuar) në vlerësimet paraprake mbi gjendjen e minoriteteve, ekzistojnë një sërë çështjesh që përsëriten periodikisht mirëpo kërkojnë një vëmendje të veçantë, duke përfshirë këtu edhe vendosjen e policisë si dhe forcave të tjera të sigurisë, marrjen e masave të veçanta të sigurisë nga organet për zbatimin e ligjit si përgjegje ndaj incidenteve përkatëse, hetimin e krimeve të kryera kundër pjesëtarëve të minoriteteve; si dhe marrja e masave të tjera që kanë të bëjnë me këto çështje me qëllim të përmirësimit të gjendjes së sigurisë në këtë aspekt.
12. Padyshim mund të thuhet se forcat e sigurisë janë të ballafaquara me një sfidë mjaft të mëdha gjatë punës së tyre në terren sidomos gjatë përpjekjeve të tyre për të ofruar një mbrojtje adekuate komuniteteve minoritare. Klima ekzistuese e jo-tolerancës dhe pandëshkueshmërisë bën që detyrat e tyre të kryhen më me vështirësi. Kontributi i vetëm dhe më i madh që do të mundej të jepej me qëllim të përmirësimit të situatës së sigurisë do të ishte përmirësimi i marrëdhënieve në mes të pakicave dhe komunitetit shumicë. Në nivelin lokal janë ndërmarrë hapa përkatës sa i përket kësaj çështjeje. P.sh OSBE-ja ka ndjekur dhe përkrahur përpjekjet për pajtim që janë bërë në muajt e fundit në Gorazdevac/Gorazhdec në mes të (serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës); pastaj në Crkolez/Cerkolez në mes të (serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës); dhe në Zallq në mes të (egjiptasëve dhe shqiptarëve). Rezultatet janë të ndryshme varësisht prej vendit, dhe në të gjitha rastet, fatkeqësisht të kufizuara dei më tani.

<sup>4</sup> Ishte rasti në Lipljan/Lipjan me 1999 kur ekzistonin pohime se edhe të miturit ishin të involvuar në një seri të sulmeve me granata kundër minoriteteve. Shiko 'Sikur që është parë, sikur që është thënë Pjesa 2'.

13. Komunitetet në veçanti **nuk ndihmojnë punën e KFOR-it dhe Shërbimit Policor** gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Arsyet për këtë janë të numërta mirëpo në esencë ato janë të ndërlidhura me mungesën e besimit ndërmjet veti. Në vlerësimet e kaluara, ishin raportuar raste kur KFOR-i apo policia e UNMIK-ut përdornin përkthyes të nacionaliteteve të ndryshme në rajonet e banuara nga pjesëtarët e minoriteteve, një praktikë e cila rezultoi me bërjen e ankesave nga ana e pjesëtarëve të minoriteteve si dhe kontribuoi në keqkuptime të mungesës së bashkëpunimit nga të dyja palët si nga ana e autoriteteve ashtu edhe nga ana e pjesëtarëve të minoritetit përkatës. Gjatë kësaj periudhe të raportimit ekzistonin raste kur bllokimi i rrugëve, apo grumbullimi i turmave të mëdha pengonte kryerjen e hetimeve të incidenteve të rënda: p.sh siç ishte rasti me demonstratat që u mbajtën në Strpce/Shterpce, më 23 qeshor një demonstratë kjo e cila kërkonte prezencën e KFOR-it dhe policisë. Kishte raste të tjera kur policia e UNMIK-ut madje ishte edhe e sulmuar gjatë mbajtjes së demonstratave të tilla. Një gjë e tillë kishte ngjarë në komunën e Obiliqit gjatë muajit gusht 2000. Protesta e komunitetit të serbëve të Kosovës të cilët me të drejtë ishin të shqetësuar nga incidentet e 18 dhe 27 gushtit dhe kishin arsye për një gjë të tillë, të cilat incidente kishin prekur në komunitetin e tyre dhe në të cilat incidente ishin sulmuar edhe fëmijët e pafajshëm, humbi në vlerën e vet për shkak të formës që kishte marrur. Reagimi i tillë duke e sulmuar policinë e UNMIK-ut mund të kontribuoi vetëm në eskalimin e mëtutjeshëm të dhunës si dhe pengon policinë në kryerjen e detyrave të tyre.
14. Ankesat e bëra nga ana e autoriteteve për pjesëtarët e minoriteteve për mungesë të një bashkëpunimi të ndërsjellë, dhe nga ana e pjesëtarëve të minoritetit për mungesë të mbrojtjes së tyre, ndonjëherë mund të jenë me të drejtë, nga cilado perspektivë shiqofshim. Megjithatë, sigurimi i mbrojtjes në një atmosferë me nivel minimal të bashkëpunimit apo pa kurrfarë bashkëpunimi fare thjeshtë bën që kryerja e detyrave nga ana e policisë të jetë një punë e vështirë. Sa i përket KFOR-it dhe policisë së UNMIK-ut ato që të dyjat mund të mësojnë dhe zhvillohen në bazë të shembujve të një praktike të mirë, të paraqitura (përshkruara) mëposhtë, me qëllim të përmirësimit të marrëdhënieve të tyre me komunitetet e ndryshme; kjo gjë është posaqërisht e rëndësishme për shkak se rivendosja dhe ndërrimet e trupave të KFOR-it dhe policisë bëjnë që ndërtimi i marrëdhënieve të mira me pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme të jetë një punë e vështirë mirëpo megjithatë edhe jo një gjë e pamundur. Përdorimi i përkthyesve të nacionalitetit të njëjtë sikur se që janë viktimat apo personat të cilët informojnë për rastet e ndryshme, përfitimi i njohurisë mbi komunitetin përkatës, shkuarja nga ajo anë ashtu që komunitetit në fjalë ti shpjegohen në vend masat e sigurisë që duhet ndërmarrë dhe të diskutojnë për sa i përket ndërrimeve të propozuara të këtyre masave, do të ndihmojë në krijimin e raporteve më të mira të punës në mes të KFOR-it, organeve të policisë, dhe komuniteteve të pakicave.

*Mëposhtë kemi përshkruar dhe analizuar llojin, shumëllojshmërinë dhe ndikimin e një numri të mekanizmave përgjegjës që kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë.*

#### Vendosja e policisë dhe KFOR-it

15. Prezenca e dukshme e policisë së UNMIK-ut dhe KFOR-it mbetet indikacioni i vetëm dhe i qartë komuniteteve të pakicave se bashkësia ndërkombëtare ka ndër mend që t'i mbrojë ata. Numri i policëve të UNMIK-ut që janë prezent sot në Kosovë sillt rreth 4,155, shifër kjo e llogaritur prej 2 tetorit 2000. Kjo shifër paraqet atë më të madhen të arritur në këtë mision deri më tani mirëpo prapsepapë kjo paraqet shifër më të vogël se ajo prej 4700 prej tyre për të cilën edhe shtetet e ndryshme u zotuan në fillim. 3,209 policë ndërkombëtar prej shumës së përgjithshme janë veç duke punuar në terren derisa 820 të tjerë janë të caktuar të punojnë në njësi speciale dhe 26 janë në trajnim e sipër dhe presin emërimet e tyre nëpër postet përkatëse.
16. Ky numër kaq i madh i policëve të vendosur në Kosovë medoemos duhet mirëpritur, si dhe mund të ketë efekte të dukshme si në zvogëlimin e numrit të incidenteve ashtu edhe në përmirësimin e perceptimit të çështjes së sigurisë nga ana e minoriteteve. Për shembull, në Stimlje/shtime, rritja e numrit të personelit të policisë së UNMIK-ut dhe atij të KFOR-it bëri që numri i sulmeve kundër shtëpive të pjesëtarëve të minoriteteve (siç janë serbët, hashkalinjë dhe romët) të zvogëlohet në masë të caktuar. Fatkeqësisht, edhe me një numër të shtuar të personelit të policisë dhe KFOR-it, nuk ishte e mundur që këto sulme të ndalen në tërësi andaj çështja e sigurisë ende mbetet një problem të cilës duhet

kushtuar një rëndësi të veçantë në Shtimje. Mirëpo ky rajon mbetet ende si të themi me një numër shumë të vogël të policëve vetëm 3 prej tyre janë ndërkombëtar dhe 25 kadetë të SHPK-së për një popullatë prej 18,000 banorëve. Mungesa e një personeli të organeve për mbajtjen e rendit publik dhe sigurisë vazhdon të ketë ndikin në jetën e shumë komuniteteve të pakicave në tërë Kosovën, me policinë dhe KFOR-in thjeshtë si të themi të paaftë që t'i përgjigjen kërkesave të parashtruara nga ana e këtyre komuniteteve.

17. Forca e përgjithshme e shërbimit policor të Kosovës (duke i përfshirë ata që janë duke ndjekur mësimet e tyre në akademinë policore si dhe ata që janë në trajnim e sipër në terren momentalisht rezulton me shifrën prej 2284 sosh. Policia e UNMIK-ut konsideron se 238 prej tyre kanë pranuar emërimet e plota të tyre si policë. Prej 1,985 personave të cilët kanë diplomuar në akademinë policore, 131 (7%) prej tyre janë serbë; dhe 116 (6%) prej tyre vijnë nga ana e pjesëtarëve të minoriteteve të tjera, duke përfshirë këtu 51 turq; 9 romë (duke përfshirë këtu hashkalinjë dhe egjiptianë) dhe 56 prej tyre janë sllavo-musliman (duke përfshirë këtu pjesëtarët e nacionalitetit goran dhe atij boshnjak). Që prej fillimit të saj, Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës ka ndërmarrë hapa mjaft aktiv për të rekrutuar kandidatë që vijnë nga ana e minoriteteve, ku këtu duhet të përmendet përdorimi i nënpunësve special për ndërlidhje me komunitetet, të cilët vizitonin komunitetet e pakicave për të shpjeguar atyre mbi punën e SHPK-së në mënyrë që të thirrën sa më shumë pjesëtarë të minoriteteve për të aplikuar në këtë shkollë. Masat e tjera të veçanta, sikurse që është organizimi dhe mbajtja e provimeve pranuese në lokacione të sigurta për ta si dhe sigurimi i rregullt i transportit, tregon një shembull të mirë të cilën edhe agjencitë (shërbimet) tjera mund ta ndjekin, për atë se si një qasje konsekuente ndaj çështjes së rekrutimit të minoriteteve mund të ketë efekte pozitive.
18. Kohëve të fundit janë bërë të ditura planet për policët e SHPK-së në lidhje me marrjen e përgjegjësisve të tyre për zonat e caktuara gjeografike – të cilat plane janë në zhvillim e sipër p.sh në pjesën rurale në jug të Prishtinës, si dhe në Gracanica/Ulpiana. Përderisa masat e tilla lirojnë personelin e pamjaftueshëm të policisë ndërkombëtare që të kenë mundësi të marrin nën mbikëqyrjen e vet apo të kujdesen për zonat e tjera, prapsepapë do të nevojitet që të bëhet një monitorim i kujdesshëm i këtij tranzicioni dhe ndoshta do të jetë e nevojshme që policët ndërkombëtar të caktohen për të punuar nëpr njësi të reja. Disa prej komuniteteve të pakicave nuk i besojnë mjaft SHPK-së së sapoformuar, dhe vetëm pas një kohe dhe me përpjekjet dhe angazhimet e të gjitha palëve mund të krijohen marrëdhëniet e mirëbesimit në mes tyre.

### Masat e sigurisë

19. Çelësi kryesor për sigurinë komuniteteve të pakicave mbetet i dyfishtë: njëra është përmirësimi i sigurisë, si dhe perceptimi i përmirësuar mbi çështjen e sigurisë. Që të dyja këto çështje janë mjaft komplekse si dhe në të njëjtën kohë janë edhe mjaft të rëndësishme. Shumë pjesëtarë të këtyre minoriteteve në fjalë besojnë se një prezencë statike dhe e dukshme në vendet ku ata jetojnë mund të përmirësojë në masë gjendjen e sigurisë së tyre andaj edhe për këtë arsye ata shpeshherë kërkojnë vendosjen e pikave kontrolluese nëpër ato vende. Megjithatë KFOR-i nuk vlerëson se këto pika kontrolluese të jenë mënyra më e mirë për mbajtjen e sigurisë së një zone dhe ka mundësi që ata shpeshherë t'i refuzojnë dhe t'u rezistojnë kërkesave për vendosjen e këtyre pikave kontrolluese në vendet të cilat mund të shkaktojnë frikë tek komuniteti vendor. Përmirësimet reale për sa i përket gjendjes së sigurisë mund të kenë si rrjedhojë që KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut t'i largojë masat që janë në zbatim e sipër. Një shembull i tillë ishte largimi i njësisve speciale të policisë nga Obiliqi pa një lajmërim paraprak dhënë komunitetit vendor, një veprim i cili alarmoi pjesëtarët e minoritetit përkatës që jetojnë në Obiliq. Komunitetet e pakicave mund t'i keqinterpretojnë veprimet e tilla të ndërmarra nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, duke pasur atë ndjenjë se ata nuk janë duke bërë mjaft për t'ju përgjigjur shqetësimeve të tyre, ashtuqë perceptimi i çështjes së sigurisë nga ana e komuniteteve në fjalë mund të pësojë si rrjedhojë e gjithë kësaj.
20. **Patrullat mbrojtëse statike dhe lëvizëse** përfshijnë; postë rojet e përhershme mbrojtëse nëpër objekte të rëndësishme fetare dhe nëpër rrethina të enklavave ku jetojnë pjesëtarët e minoriteteve; pikat kontrolluese të vendosura në rrugë; patrullat në këmbë dhe me automjete; shoqërimet (përcjelljet) për shkak të sigurisë së minoriteteve të ofruara me



qëllim të lehtësimit të lëvizjes së popullatës pakicë; vazhdojnë të jenë një çështje thelbësore për sa i përket një përgjegje më të gjerë në aspektin e sigurisë nga ana e autoriteteve. Në ditët dhe javët e para të vendosjes së trupave të KFOR-it, i ballafaquar me sulme të shkallës së gjerë kundër komuniteteve të pakicave, KFOR-i ishte i obliguar që të dedikojë një personel me një numër të konsiderueshëm në mënyrë që të mbrojtë fizikisht mirëqenien e këtyre komuniteteve. Me kalimin e kohës përdorimi i rojeve të ashtuquajtura statike ishte modifikuar në pajtim me ndryshimet e situatës në atë vend. Mandati për siguri i cili i është caktuar (dedikuar) KFOR-it në bazë të rezolutës 1244 është mjaft i gjerë dhe aktivitetet e tyre nuk janë të kufizuara në bazë të këtij mandati kur është në pyetje mbrojtja e pakicave. Sidoqoftë mbetet ende një realitet fakti se një numër i madh i ushtarëve vazhdojnë të caktohen nëpër detyrat e tyre mbrojtëse që janë të drejtuara në mënyrë primare kah mbrojtja e komuniteteve të pakicave. Ushtarët e KFOR-it bëjnë më tepër roje nëpër kisha ortodokse se sa nëpër xhami; postë rojet janë të vendosura strategjikisht më shumë nëpër rrugët që kanë qasje drejt enklavave/lagjet ku jetojnë pakicat se sa nëpër vendet e tjerat. Shkalla e lartë e vendosjes së personelit ushtarak dhe shkalla në të cilën përpjekjet e tyre u janë përshtatur nivelit që kërkohet për mbrojtjen e pakicave, indikon në faktin se pakicat ende ballafaqohen me një numër të konsiderueshëm të kërcënimeve që kanë të bëjnë me sigurinë e tyre.

21. **Efektiviteti** i masave të tilla që paraqesin një mjet frenues kundër dhunës me motive etnike është mjaft i vështirë për tu vlerësuar. Gjatë periudhës së raportimit një numër i caktuar incidentesh mjaft të rënda ngjanë mu në afërsi të këtyre postë rojeve; më 6 qeshor një granatë e dorës u gjuajt nga automjeti i cili ishte duke kaluar andejpari në tregun e Graçanicës/Ulpianës; në të njëjtën ditë tre granata të minahedhësve qëlluan enklavën serbe në Gorazdevac/Gorazhdec, një rast (ngjarje) e përsëritur disa herë deri më tani; derisa më 21 qeshor manastiri ortodoks në Decani/Decan tani ishte ai që u qëllua nga 6 deri në 7 granata të minahedhësve. Përderisa ndodhja e këtyre incidenteve rezultoi në protesta të organizuara nga pjesëtarët e komuniteteve të pakicave të cilët protestonin për shkak të dështimit të bashkësisë ndërkombëtare për t'i mbrojtur ata, do të ishte më se e thjeshtë ta bijmë në pyetje efektivitetin e rojeve statike duke cituar shembuj specifik ku madje edhe prezenca e personelit ushtarak nuk pati sukses që ti parandalojë sulmet e tilla. Një kontra-argument i dukshëm drejtuar ankesave të tilla do të ishte fakti se shumë e shumë më tepër incidente të tjera do të kishin ndodhur nëse nuk do të kishim prezencën e rojeve të tilla.
22. **Rëndësia psikologjike** e rojeve të tilla nuk bën kursesi të nënçmohet. Prezenca e dukshme e personelit ushtarak të KFOR-it nga disa prej komuniteteve kuptohet si një pri-rekuizitë për sigurinë e tyre. Kjo në të kundërtën mund të rezultojë në një situatë të varshmërisë nga personeli ushtarak dhe ai policor, derisa tërheqja e tyre mund të shkaktojë frikë dhe panik, pa marrë parasysh se a ekziston rreziku i vërtetë nëpër ato zona ku jetojnë minoritetet apo jo. Kjo përvojë nuk është e njëllotë për të gjitha grupet etnike në të gjitha vendet ku ata jetojnë. Në fakt në disa vende siguria me prezencë të shkallës së lartë është zvogëluar proporcionalisht apo modifikuar në pajtim me përmirësimet e gjendjes së sigurisë nëpër ato vende. Ekzistojnë raste kur komunitetet e pakicave (siç janë p.sh lagjet e ashkalinjve) i janë larguar asaj që pranë shtëpive të tyre të ketë një prezencë të shkallës së lartë të personelit ushtarak apo atij policor duke u frikësuar për faktin se si e gjithë kjo do të kuptohej nga ana e popullatës shumicë. Shtrohet pyetja se a janë disa prej komuniteteve të pakicave duke e mbajtur mbi supet e tyre tërë barrën që e shkakton ky nivel i papranueshëm i frikësimit dhe keqtrajtimit, duke qenë të frikësuar që të raportojnë mbi ato raste dhe duke shpresuar se nëse e përballojnë gjithë këtë stuhi pa u munduar që të tërheqin vëmendjen e bashkësisë ndërkombëtare, atëherë atyre do t'u sigurohet një siguri më afatgjatë.
23. Fakti se një numër i incidenteve të sigurisë vazhdojnë të ndodhin ende atëherë kjo mund të mirret si një arsye e mjaftueshme e cila justifikon (i jep të drejtë) përdorimit të vazhdueshëm të këtyre mekanizmave mbrojtës. Megjithatë këto mekanizma në fund të fundit mund të jenë pësuese dhe të dëmshme për mirëqenien e përgjithshme të këtyre komuniteteve, për shkak se këto mekanizma prijnë të zgjasin izolimin dhe përforcojnë mentalitetin e shtetrrëthimit. KFOR-i nevojitet të jetë syhapët sa i përket masave të sigurisë dhe të vazhdojë në përpjekjet e tyre për të përfshirë edhe akterë të tjerë, më se me rëndësi është përfshirja e vendasve, në një debat konstruktiv në lidhje me strategjinë mbi sigurinë e përgjithshme e cila mbron interesat e banorëve të Kosovës në një mënyrë të drejtë dhe të barabartë.

24. Një shembull i mirë i kësaj qasjeje të hapur dhe fleksibile është mjaft e dukshme që prej arritjes së kontigjentit të ri të KFOR-it në Gjilan gjatë muajit maj. Këtu mënyra e punës së KFOR-it duket të jetë më shumë e orientuar kah mbrojtja e pakicave, gjë që edhe mund të shihet mjaft qartë. Andaj batalioni i cili operon në qytetin e Gjilanit ka krijuar marrëdhënie të mira me liderët e minoriteteve si dhe kanë vendosur pika të reja kontrolluese në pikat më të ndieshme (cenueshme); një linjë telefonike në të cilën punon një përkthyes i nacionalitetit serb është instaluar në stacionin e atjeshëm të policisë,<sup>5</sup> si dhe është hapur zyra kontaktuese e KFOR-it për çështje civile e cila punon gjatë tërë ditës në lagjen e populluar me pjesëtarë të nacionalitetit serb. Policia e UNMIK-ut e ka rritur prezencën e saj qytet, ku edhe patrullat e pavarura të SHPK-së kanë filluar të operojnë nëpër qytet gjithashtu. Një efekt i menjëhershëm është se kontrollimi i gjendjes në trafik rreth zonave të banuara me pjesëtarë të minoriteteve është përmirësuar dukshëm. Megjithatë, nevojiten të mirren masa të mëtutjeshme dhe më konstruktive për popullatën e banuar me pjesëtarë të nacionalitetit rom në qytetin e Gjilanit. Pas një tentimi për ti vënë zjarrin një shkollë vendore në atë lokalitet, komuniteti i atij vendi kërkoi përkrahjen e KFOR-it mirëpo për shkak të mungesës së personelit ushtarak atyre iu ishte thënë se duhen të organizojnë sigurinë e atij lokaliteti me iniciativën e tyre.<sup>6</sup> Kjo popullatë i është nënshtruar një keqtrajtimi të vazhdueshëm dhe afatgjatë. Këta njerëz jetojnë në një zonë të definuar qartë, më së shumti në një rrugicë të ngushtë andaj për këtë arsye ata kishin kërkuar vazhdimisht për përmirësime sa i përket gjendjes së sigurisë aty. Në shkurt të këtij viti, një pikë kontrolluese statike ishte vendosur në një rrugë hyrje të rrugës së banuar me romë, edhepse në atë pikë kontrolluese nuk ka gjatë tërë kohë ushtarë. Nëpërmjet të diskutimeve plotësuese me mekanizmat e KFOR-it dhe policisë së UNMIK-ut është arritur marrëveshja për përmirësimin e gjendjes së sigurisë rreth shkollës dhe në përgjithësi e tërë komunitetit në fjalë.
25. Policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i kanë ndërmarrë hapa të tjerë specifik në disa pjesë të tjera të Kosovës në mënyrë që të mirren me çështjet e sigurisë. Masat speciale për sigurinë vendore (mssv), të cilat u propozuan në fillim të këtij viti, duhet që tani të fillojnë të zbatohen në praktikë në komunën e Vitisë. MSSV-të e tilla janë një rezultat i idesë për “ ekipi special i përbashkët për siguri” i premtuar me memorandumun e mirëkuptimit të përpiluar si rezultat i marrëveshjes në mes të PSSP-së dhe peshkopit artemije më 29 qeshor 2000. Memorandumi përcakton qartë interesat me rëndësi kritike të shumicës së komunitetit serb në Kosovë, ku më kryesorja para së gjithash ishte çështja e sigurisë. Disa prej shqetësimeve të këtij komuniteti qëndrojnë tek këto masa, të cilat duken se janë të kufizuara në zonat e banuara me serb me përjashtim të zonave të tjera të banuara me minoritete të tjera apo zonave nevoja speciale të sigurisë. Mirëpo prapsepapë masat e tilla tregojnë për një qasje më kundërpërgjegjëse gjendjen e përmirësuar të sigurisë në një rrugë e cila për një kohë të gjatë ishte zona me shkallën më të lartë të dhunës në tërë provincën. Si gjithmonë, masat e tilla kërkojnë jo vetëm angazhim por edhe burime si aso financiare ashtu edhe njerëzore – me qëllim që të jenë më efikase.
26. Një propozim për mssv-në është shfrytëzimi i stacioneve lëvizëse dhe të përkohshme policore, me qëllim të sigurimit të prezencës së dukshme të tyre së paku për një kohë të caktuar, veçanërisht nëpër zonat e izoluara. Edhepse njësitë e tilla nuk mundën të risin shkallën e sigurisë prej sulmeve të brendshme (fshatrat përkatës mbeten subjekte të mundshme të cilat mund t'i nënshtrohen dhunës nëse këto njësi policore lëvizëse nuk janë më prezent aty) ato mundën të kontribuojnë në krijimin e një komunikimi më të fuqishëm dhe më të rregullt në mes të komuniteteve dhe policisë së UNMIK-ut apo SHPK-së. Fleksibiliteti i njësisve të tilla lëvizëse do t'ju lejoj gjithashtu atyre që të përdoren për një periudhë të caktuar kohore nëse gjendja e sigurisë nëpër lokacione të veçanta keqësohet, andaj sigurimi i një prezence të dukshme të personelit ushtarak dhe atij policor është më se i nevojshëm. Zbatimi në praktikë i vendosjes së stacioneve të tilla policore duhet të filloi sa më shpejt që është e mundshme.

<sup>5</sup> Përdorimi i përkthyesve që vijnë nga ana e minoriteteve mbetet një çështje thelbësore sidomos kur kemi të bëjmë me minoritete. Ky akt i bërë në Gjilan është më se i mirëseardhur; për shkak se minoritetet që jetojnë në këtë qytet dhe enklavat tjera përreth kanë raportuar vazhdimisht për problemet e lindura me përkthyes shqiptarë.

<sup>6</sup> Kjo qasje ndaj idesë për “ruajtja e vendeve ku jetojnë komunitetet në fjalë” është e diskredituar në masë të madhe. Një reagim (përgjegje) e KFOR-it dhënë komunitetit serb në Cernica/Cernice, rreth mbrojtjes së Kishës, në fund të fundit rezultoi me dështim. Serbët e këtij fshati i cili është i njohur si fshat me më së shumti probleme në sektorin juglindor ishin të frikësuar ta ruajnë Kishën gjatë natës. Më 30 Qeshor, Kisha e pambrojtur u shkatërrua nga një eksplozim i madh.

27. Reagimet e shpejta dhe praktike nga ana e forcave të sigurisë kanë treguar gjithashtu sukses të dukshëm në nivelin lokal. Për shembull vendosja e pengesave në rrugë (të dedikuara për zvogëlimin e shpejtësisë së automjeteve) nga ana e KFOR-it në vitina/viti në korrik muaj ky përplot me incidente dhe të shtëna nga automjetet që si shënjestër kishin pjesëtarët e komunitetit serb, ishte më se e mirëseardhur nga ana e po këtij komuniteti. Patrullat shtesë të bëra gjatë natës nga ana e KFOR-it në Klina/Kline dhe Djakovica/Gjakove gjatë muajit qeshor rezultuan me një zvogëlim të dukshëm të numrit të incidenteve kundër romëve dhe egjiptianëve. Ndërtimi i rrugëve alternative (dytësore) që shërben për uljen e tensioneve nëpër zona të përziera është edhe një masë tjetër që mund të na shpiejë kah rritja e shkallës së sigurisë nëpër ato zona. Ekzistojnë raste kur KFOR-i qëllimisht morri përsipër mbarimin e rrugës në mënyrë që t'ju mundësohet shqiptarëve ta anashkalojnë manastirin e Deçanit, e cila në një masë mjaft të madhe kontribuoi në uljen e tensionit në atë zonë, si dhe kemi rrugën e ndërtuar në lindje të Prishtinës e cila ju mundëson shqiptarëve që ti mënjanojnë kalimit nëpër Graçanicë.
28. Ndikimi i zonës së besimit në Mitrovica/mitrovice – që paraqet një rënë prej zonave me reagim më të gjerin në provincë për sa i përket cenueshmërisë së situatës së sigurisë në atë zonë – mbetet një çështje që kërkon sqarim. Duket se niveli i krimeve të rënda në qytet ka rënë, si në jug dhe veri të zonës së ashtuquajtur të besimit. Megjithatë, kjo zonë e besimit nuk është rritur deri në masën që është paraparë fillimisht ashtuqë “ruajtësit be urës” janë si duket ende duke e kufizuar lirinë e lëvizjes në pjesën veriore të banuar me serbë që ndodhet mëtej urës kryesore. Për pakicën shqiptare të izoluar në pjesën veriore të veriut të Mitrovicës, situata ende mbetet e tensionuar. Dëbimet me dhunë kanë vazhduar me një ritëm sporadik edhe gjatë verës. Policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i kanë ndërmarrur hapa drejt frenimit të kësaj tendence duke instaluar mekanizma për reagim të shpejtë, ku një oficer i KFOR-it është stacionuar në stacionin policor që gjendet në veri i gatshëm që shumë shpejt të jetë në gjendje t'i mobilizojë ushtarët me qëllim të ofrimit të ndihmës familjeve që janë në rrezik. Sidoqoftë, nuk u arrit ndonjë sukses i dukshëm për sa i përket zënies së keqbërësve përderisa kërcënimi i vazhdueshëm i dhunës sporadike e cila si rrjedhojë shpesh ka dëbimet me dhunë të qytetarëve nga banesat e tyre ende vazhdon të ekzistojë. UNHCR-ja siguroi shufra të metalit dhe dryrëve me qëllim të sigurimit të deryve të apartamenteve të personave të cilët ndodhen në rrezik.
29. Shikuar gjerësisht, përgjegjja ndaj problemeve reale që kanë të bëjnë me gjendjen e sigurisë si dhe perceptimit (kuptimit) të sigurisë kishte më tepër karakter imagjativ, dhe ka thirrur në një shkallë më të madhe të zbatimit të ligjit dhe përdorimit të metodave (teknikave) të rritjes së shkallës së sigurisë se mëparë. Shpresohet se ky vullneti i mirë i shtuar nga ana e autoriteteve me qëllim të përvetësimit të masave kreative, informimit të komuniteteve, dhe dhënies së përgjegjeve adekuate ndaj problemeve afatgjate, do të vazhdoi edhe në të ardhmen.

## **Liria e lëvizjes**

30. Liria e lëvizjes nuk është thjeshtë vetëm një çështje e lëvizshmërisë. Fakti se shqetësimet që kanë të bëjnë me çështjen e sigurisë pengojnë komunitetet e pakicave prej ushtrimit të të drejtës themelore të lirisë së lëvizjes është mjaft mirë e dokumentuar nëpërmjet të vlerësimeve të mëparshme të UNHCR/OSBE-së. Me keqardhje mund të them se gjërat e njëjta janë përsëritur edhe në këtë raport. Është mjaft e rëndësishme është shumë me rëndësi nëse vazhdojmë t'i ilustrojmë **efektet e lirisë së kufizuar të lëvizjes** me qëllim që ti vlerësojmë plotësisht pasojat e dëmshme dhe me shtrirje të gjerë që këto kanë për komunitetet e pakicave. Liria e kufizuar e lëvizjes është një problem i përbashkët për të gjitha minoritetet në Kosovë mirëpo nuk është i njëjlojtë për të gjitha grupacionet etnike në të gjitha zonat ku ata janë të përqëndruar. Serbët e Kosovës janë më vulgarisht dhe më egërsisht të prekur nga e gjithë kjo, derisa grupacionet e tjera etnike ballafaqohen me një shkallë tjetër të të njëjtit problem. Kufizimet në lirinë e lëvizjes pengojnë (frenojnë) aftësinë e njerëzve që ti ushtrojnë plotësisht të drejtat e tyre themelore. Duke shikuar nga një kënd më praktik kjo nënkupton të qenurit të paaftë me lëvizur lirisht në mënyrë që ti vizitojnë miqtë dhe familjet e tyre, pastaj të mos kenë mundësi që lehtë të kenë qasje në shërbimet e shëndetësisë dhe ato arsimore; të mos kenë mundësi ta mbajnë vendin e punës apo të kërkojnë punë të re; të mos kenë mundësi të punojnë tokën e tyre; të mos kenë mundësi që t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollat në të cilët ata dëshirojnë. Të gjitha këto çështje mund të shikohen nga shumë aspekte dhe potencojnë jo vetëm rëndësinë e lëvizshmërisë së papenguar por edhe

faktin se gjithë këto që u përmendën më lartë munden të realizohen vetëm në një situatë ku mbretëron një klimë tolerante dhe sigurisë së plotë.

31. UNHCR vazhdon t'i mbajë linjat e autobusëve anembanë provincës. Linjat e tilla janë të dizajnuara asisoji ashtu që të lehtësojnë lirinë e lëvizjes për komunitetet e pakicave të cilët përndryshe nuk kanë mjete të përshtatshme që do t'u mundësonin atyre të udhëtojnë edhe jashtë kufijve të enklavave të tyre. Përfituesit e vetëm nga këto shërbime janë vetë serbët e Kosovës. Si rrjedhojë e sulmit fatal me granatë mbi autobusin e UNHCR-së në Mitrovicë në shkurt të vitit 2000, të gjitha shërbimet e tilla ndërprehen punën duke pritur një rishikim (rishqyrtim) që duhet bërë sa i përket marrëveshjeve mbi çështjet e sigurisë. Kah fundi i prillit projekti në fjalë filloi

Së funksionuari përsëri. Numri i udhëtarëve nëpër ata autobusë sidomos gjatë muajve të verës shënoi një rritje të dukshme, duke arritur mesataren prej 30000 udhëtarëve në muaj. Fakti se autobusët e UNHCR-së detyroheshin të punonin në bazë të përcjelljeve që forcat e sigurisë ua bënin këtyre autobusëve është një përkujtues i freskët për rreziqet me të cilat minoritetet nevojitet të ballafaqoheshin në mënyrë që të ushtrojnë të drejtën e tyre elementare mbi lirinë e lëvizjes.

32. Shërbimet e UNHCR-së nuk janë mjete ekskluzivisht të dedikuara vetëm për udhëtim andaj për këtë shkak nevojitet të monitorohet frekuenca me të cilën udhëtojnë këta autobusë si dhe lokacionet e rrugëve përkatëse përdorura nevojitet një prezencë e personelit ushtarak nëpër ato lokacione varësisht prej nevojës rasti i njëjtë është edhe me zonën e Mitrovicës ku duket një përmirësim i gjendjes sa i përket çështjes së shërbimeve hekurudhore gjë që e ka zvogëluar dukshëm kërkesën për shfrytëzimin e autobusëve si mjet për udhëtim. Në Rahovec ka pasur një zhvillim pozitiv në këtë drejtim me një numër të rritur të kërkesave në këtë aspekt derisa shihet se një numër mjaft i madh i udhëtarëve janë duke përfutur nga udhëtimet e tilla dykahore. Shihet se linjat e tilla të autobusëve janë duke dhënë një kontribut të dukshëm dhënë lirisë së lëvizjes së komunitetit serb në Kosovë të cilat shërbime kundërshtoheshin fuqimisht për shkak se konsideroheshin si linja njëkahëshe dhe atë me destinim jashtë Kosovës. UNHCR-ja vazhdon të potencoi (theksoi) se linjat e autobusëve si të tilla që janë nuk janë masë e mjaftueshme e as e përshtatshme për të plotësuar kërkesat (përmëshur nevojat) e tërë komuniteteve të pakicave në Kosovë. Diskutimet përkatëse në lidhje me këtë çështje janë duke u zhvilluar me qëllimin e vetëm të tyre e që është përpilimi i një plani strategjik mbi krijimin e shërbimeve të transportit publik nën kujdesin (mbikëqyrjen) e UNMIK-ut, i cili do të merr gradualisht përgjegjësinë mbi çështjet e sigurimit të shërbimeve përkatëse të cilat si të tilla do t'i përmëshnin nevojat e komuniteteve të pakicave.

33. Shërbimet plotësuese të transportit publik të organizuara enkas për minoritetet përfshijnë edhe linjë e sapohapur hekurudhore në mes të Fushë Kosovës dhe Zveçanit e cila paraqet një çështje me rëndësi vitale sidomos për serbët që jetojnë në pjesën qendrore të Kosovës. Shërbimet e trenave kishin ndërprerë herë pas here punën e tyre për shkak të problemeve të lindura teknike. Në ndërprerjen e punës së këtyre shërbimeve kishin ndikuar edhe incidentet e sigurisë si p.sh ai i 8 gushtit gjatë së cilës një serb u lëndua lehtë kur në trenin që ishte duke kaluar në afërsi të Vushtrisë ishin gjuajtur gurë. Pavarësisht prej vështirësive të tilla numri i udhëtarëve ishte ngritur në një masë të caktuar ashtuqë treni si mjet udhëtimi duket se vlerësohet si mjet shumë i nevojshëm dhe i përshtatshëm për udhëtim. Ekziston gjithashtu një numër i caktuar i shërbimeve të ashtuquajtura komerciale të autobusëve me linjat e organizuara me destinim jashtë Kosovës, siç janë linjat e ndërmarrjes nish ekspres për në Graçanicë dhe linja e rregullt nga dhe për në gorazhdec. Shërbimet e tilla të autobusëve përfitojnë nga përcjelljet e organizuara nga KFOR-i, mirëpo është për të ardhur keq se ende kemi raste të gjuajtjes me gurë mbi autobusët që për udhëtarë kanë serbët e Kosovës. KFOR-i kohë pas kohe siguron përcjelljen edhe të automjeteve private varësisht prej nevojës.

34. Në fund të Qeshorit KFOR-i si përgjegje kundër dhunës së shpërthyer nga ana e komunitetit serb të shtërpsës drejtuar kundër organeve për zbatimin e ligjit, ndërpreu të gjitha përcjelljet e të organizuara deri në atë moment nga personeli i saj. Konvojet e autobusëve të cilët vazhduan me linjat e tyre të rregullta mirëpo të papërcjellura nga ana e KFOR-it ishin gjuajtur me gurë ku si rezultat i së cilës një numër i udhëtarëve serb pësuan lëndime të lehta. Tërheqja e KFOR-it prej organizimit të përcjelljeve të tilla; kishte për qëllim më tepër t'i ilustronte komunitetit serb në shtërpsë nevojën e tyre për të bashkëpunuar me bashkësinë ndërkombëtare nëse dëshirojnë të përfitojnë nga përkrahja e vazhdueshme e dhënë nga ana e KFOR-it e cila ka karakter humanitar.

Për shumë pjesëtarë të minoriteteve liria e lëvizjes nën kushtet e tanishme është e varur dukshëm nga sigurimi i përcjelljeve me karakter sigurie. Vlera e kësaj të drejteje themelore nuk bën të ulët edhe mëtej nga ana e bashkësisë ndërkombëtare si një mjet për të obliguar popullatën vendore që të kënaqin pritjet (shpresat) e tyre. Përcjelljet me karakter sigurie duhet të refuzohen vetëm nëse ka arsye për të besuar se ekziston një kërcënim i vërtetë dhe i afërt drejtuar udhëtimit gjë që bën që udhëtimi në fjalë të jetë i pakëshillueshëm. Nocioni në bazë të të cilit dënohet një komunitet i tërë për shkak të një akti të shëmtuar të kryer nga disa pjesëtarë të po atij komuniteti është një gjë e papranueshme dhe si e tillë nuk guxon të përjetësohet nga ana e bashkësisë ndërkombëtare. Më vonë u fillua përsëri me organizimin e përcjelljeve të tilla.

## **Sistemi gjyqësor**<sup>7</sup>

31. Lehtësimi i zhvillimit të një sistemi gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm është një element thelbësor për krijimin e sundimit të së drejtës dhe zgjidhjes së problemit të pandëshkueshmërisë. Kjo nuk prek vetëm minoritetet por edhe shoqërinë si një tërësi. Është detyrë (obligim) i cilitdo sistem funksional gjyqësor që të sigurojë kryerjen e procedurave efektive hetimore, duke përfshirë këtu, varësisht prej dëshmimeve që kemi në dispozicion edhe zhvillimin e ndjekjes penale kundër kryerësve të veprës dhe dënimit e atyre të cilët janë shpallur fajtor. Në rastin e Kosovës, nevoja për të garantuar një sistem gjyqësor i cili shërben në mënyrë korrekte dhe shihet se i shërben nevojave të të gjithë sektorëve të shoqërisë është me rëndësi të veçantë. Për shqiptarët e Kosovës kjo gjë është e nevojshme me qëllim që t'u ndihmojë atyre në shërtimin e plagëve të së kaluarës. Është e rëndësishme për ta që të shohin një përparim të vërtetë të bërë sa i përket çështjes së ndjekjes së personave të akuzuar për krimet e kaluara në të kaluarën. Për komunitetet e pakicave është me rëndësi që kundërshtojnë idenë e tyre se ata janë duke u sakrifikuar për krimet e të së kaluarës. Është gjithashtu me rëndësi që të mbrohen zotimet dhe morali i organeve për zbatimin e ligjit duke i siguruar ata se për shkak të rreziqeve me të cilat ata ballafaqohen gjatë hetimit të krimeve dhe në kapjen (arrestimin) e kryerësve të veprave penale atyre duhet tu kushtohet një respekt i veçantë. Në bazë të ligjit të aplikueshëm në Kosovë, gjyqtari hetues luan një rol të madh në kryerjen e procedurave hetimore. Për këtë arsye është mjaft me rëndësi që çfarëdo masash që ndërmerren në të ardhmen me qëllim të përmirësimit të gjendjes së sistemit gjyqësor të jenë të fokusuar më tepër kah judikatura (gjyqësia) dhe mbajtja e ndjekjes penale e hetimeve në fazën e paragjyqimit. Për bashkësinë ndërkombëtare si një tërësi është mjaft e rëndësishme që të krijohet një sitsem juridik i cili do të reflektojë bazat e një sistemi jo-diskriminues në të cilat është edhe i bazuar misioni i kb-së në Kosovë.
32. OSBE ka monitoruar nga afër sistemin juridik me një qëndrim të detektimit të anësive (animeve) dhe të raportimit mbi korrektesinë e sistemit. Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar rasteve në të cilat janë të përfshira edhe pjesëtarët e pakicave qoftë në cilësinë e të pahendurit qoftë në atë të vitimave. Në 6 muajt e fundit që kaluan (prej shkurtit e deri në korrik duke përfshirë këtu edhe vetë korrikun) 77 prej 160 gjykimeve të mbajtura në gjyqin e qarkut ishin monitoruar (66% e gjykimeve ishin kryer brenda kësaj periudhe të cekur kohore). 140 të pandehur ishin dënuar ndërsa 29 tjerë ishin liruar nga akuza (83% paraqet përpjestimin e dënimit). Prej numrit të përghithshëm të të pandehurve nëpër këto gjykime 9 prej tyre ishin pjesëtarë të pakicave: 4 serbë të Kosovës, 2 romë, 2 turq, dhe një sllavo-musliman (shumica e viktimave të këtyre të pandehurve ishin shqiptarë). Gjatë kësaj periudhe kohore u mbajtën edhe gjykimet që kishin të bënin me viktimat që ishin pjesëtarë të minoriteteve: te prej tyre ishin serbë, 4 romë, 2 turq (derisa shumica e të pandehurve ishin shqiptarë).
33. Megjithëse vetëm disa prej gjykimeve me pjesëtarë të minoriteteve në cilësinë e të pandehurit ishin kryer deri në fund këto gjashtë muajve të fundit, derisa ato që kanë të bëjnë me krimet me motive etnike kanë shtuar brengat që veç ekzistonin mëparë në lidhje me animet që bëheshin gjatë gjykimeve kundër serbëve. Rezultatet e aktiviteteve monitoruese poashtu tregojnë për një mosdashje (mungesë të vullnetit të mirë) për sa i

<sup>7</sup> Informatat e prezentuara këtu janë thelbësisht të kufizuara për sa i përket funksionimit të gjykatave penale. Përpjekjet për krijimin e një gjyqësie funksionuese janë pashmangshmërisht të përqëndruara kah gjykatat penale të shkallës së parë për sa i përket zhvillimit të tyre përballë mbetjes prapa të gjykatave civile.

përket ndjekjes së akteve kriminale të kryera nga shqiptarët kundër serbëve. Për më tepër, gjyqet në shumë raste ngrisin paditë kundër serbëve të Kosovës si duket pa pasur kurrfarë bazash për këtë.

34. Roli dhe funksioni i gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar nevojitet që të zhvillohet (rritet) edhe mëtej. Këta ishin rekrutuar si përkrahje sistemit gjyqësor vendor duke vijuar shpërthimin e dhunës në Mitrovicë në shkurt të vitit 2000. Ideja fillestare ishte se prezenca e një stafi ndërkombëtar në kuadër të gjyqësisë do të ketë rolin e një kundër-balance për sa i përket perceptimit të anësive dhe diskriminimit që bëhet nga ana e gjyqësisë vendore. Për shkak se gjykimet mbahen para kolegjit të gjyqtarëve, gjyqtari ndërkombëtar nuk do të ketë mundësi të jap fjalën e fundit. Roli i këtij personeli ndërkombëtar është më shumë se rol mësimi si për shembull, në kuadër të vetë sistemit gjyqësor. Me qëllim të zmadhimit të mëtejshëm të potencialin e këtij roli personeli ndërkombëtar duhet duhet të jetë më i inkuadruar në zhvillimin e sistemit juridik si një tërësi (gjyqet, ligjet e aplikueshme, etj.). Vetëm në këtë mënyrë veprimet e udhëzuara mirë mund të vazhdojnë të kryhen me qëllim që të garantohet që sistemi juridik të jetë i udhëhequr nën patronazhin e bashkësisë ndërkombëtare, është me të vërtetë duke përfitur nga përvojat e atyre të cilët janë emëruar nëpër detyra me qëllim të ofrimit të ndihmës gjyqësisë vendore. Duhet të ndërmerren hapa aktiv me qëllim të konsultimit të personelit vendor dhe sigurimit të asaj se ataqë janë duke punuar për sistemin gjyqësor e kuptojnë në tërësi rolin e bashkëpjesëmarrësve të tyre ndërkombëtar dhe që me të vërtetë janë duke mësuar nga vëzhgimet dhe përvojat e tyre.

*Një numër i çështjeve që brengosin janë paraqitur mëposhtë nëpërmjet të një shembulli të lojtit të problemeve të vëna në pah gjatë monitorimit të gjykimeve të bëra nga ana e OSBE-së. Për shkak se disa prej këtyre janë të natyrës strukturore dhe mund të rregullohen nëpërmjet të një futjeje të mjaftueshme të parave, të tjerat shkojnë dhe prekin në substancën e drejtësisë apo mënyrën se si ajo zbatohet në praktikë nga ana e gjyqësisë dhe si rezultat i gjithë kësaj që u tha mund të përfundojmë se nevojitet një përgjegje e përshtatshme me qëllim të gjetjes së mjeteve të përshtatshme dhe afatgjatetë cilat sigurojnë një sistem gjyqësor i cili u shërben të gjithë Kosovarëve në baza të barabarta.*

35. **Paanshmëria:** dëshmit për anime gjatë mbajtjes së procedurave gjyqësore kundër të pandehurve që janë pjesëtarë të minoriteteve është më rëndësi të veçantë. Dy testimet standarde të paanshmërisë – subjektiv dhe atij objektiv (atij aktual dhe atij të pranuar) – janë të monitoruara nga OSBE-ja. Është një kërkesë e paanshmërisë që vendimet duhet të mirren vetëm e vetëm në bazë të dëshmive që gjyqtari i ka në dispozicion në lidhje me rastin, si dhe që për këtë ligji i aplikueshëm duhet zbatuar. Një kërkesë tjetër është se gjyqtari duhet të mirret me rastin pa pasur ndonjë paragjykim për rastin apo të pandehurin. Rastet e monitoruara ngrisin brengën se disa gjyqe të caktuara apo gjyqtarë dështojnë që të kënaqin standardet e parapara me të dyja këto teste. Në rastet kur dëshmitë e prezentuara nuk ndikojnë në marrjen e vendimit eventual, atëherë parashtrihen pyetje për anime të mundshme gjatë mbajtjes së çfarëdo procedure gjyqësore kundër të të pandehurve në fjalë. Në fakt kjo mund t'i ngarkohet pranimit rutinor të dëshmive të natyrës thashethëmëse, të cilat shumë sisteme gjyqësore kudo në botë i përjashtojnë plotësisht si dëshmi, mirëpo të cilat dëshmi apo thashethëme janë të lejuara të mirren si dëshmi në bazë të ligjit të aplikueshëm në Kosovë. Deklaratat me plot paragjykime të dhëna nga ana e gjyqtarëve gjatë fazës së paragjykitimit por edhe gjatë gjykimit (edhe në disa raste edhe nga vetë avokati i mbrojtjes) sa i përket përfundimit (rezultatit) të gjykimit apo fajësisë apo pafajësisë së të pandehurit vëjnë në dyshim tërë mbarëvajtjen e procedurës gjyqësore dhe çështjes së paanshmërisë së tërë procesit gjyqësor. Në disa raste të cilat janë të monitoruara, duke përfshirë këtu edhe procedurat gjyqësore të mbajtura kundër të pandehurve që janë pjesëtarë të minoriteteve, gjyqtarët kishin dhënë deklarata që indikonin (tregonin) për një mungesë të paanshmërisë nga ana e tyre.
36. **Siguria për dëshmitarët që vijnë nga rradhët e pakicave:** nevojitet që të mirren masa speciale me qëllim që t'u mundësohet personave që vijnë nga rradhët e pakicave të paraqiten në gjyq në cilësinë e dëshmitarit. Duhet të ju jipet atyre një paralajmërim shtesë mbi datat dhe vendet e mbajtjes së gjykimeve në mënyrë që të kihet mundësi që të rregullohen masat e sigurisë. Në këto masa përfshihet jo vetëm nevoja për sigurimin e përcjelljes së tyre për në dhe prej gjyqit në mënyrë që ata të japin dëshminë e tyre mirëpo

edhe masat vazhduese pas fazës së gjykimeve kuptohen si masa që pengojnë mundësinë e ndodhjes së represaljeve si rrjedhojë e dhënies së dëshmimeve të tilla.

37. **Paraburgimi:** sistemit juridik në Kosovë i mungon një mjet juridik në bazë të të cilit do të mundësohej lëshimi i fletëthirjes për në gjyq në bazë të të cilit ligjshmëria e një paraburgimi ka mundësi që të testohet në mënyrë të përshtatshme. Për cilindo person i cili është privuar nga liria, ekziston nevoja që të kemi një procedurë penale të drejtë të mbajtur kundër personit në fjalë sipas të cilit do të rishqyrtohen bazat e paraburgimit të tillë. Kjo është me rëndësi të veçantë kur kemi të bëjmë me të paraburgosurin i cili e vë në dyshim vlefshmërinë e arrestimit dhe paraburgimit dhe ka mundësi që të paraqes dëshmitë e cila do të na çonte drejt nxjerrjes së përfundimit se nuk ka baza të mjaftueshme në bazë të të cilit do të mundnim të kalonim në fazën e mbajtjes së gjykimit. Një procedurë e tillë do të ishte mjaft e dobishme sidomos për të paraburgosurit që vijnë nga rradhët e pakicave të cilët pohojnë se janë të sakrifikuar për qëllime të caktuara. Disa prej të paraburgosurve që vijnë nga rradhët e pakicave janë mbajtur nën paraburgim për një kohë të gjatë pa pasur qasje ndaj procedurave përkatëse. Në të kundërtën mund të themi se nuk ekzistojnë indikacione se gjyqet në fjalë nuk janë duke urdhëruar paraburgimin, apo që nuk janë duke shtyer afatin kohor të paraburgimit, sidomos në rastet ku viktimat vjen nga rradhët e pakicave derisa i padenhuri është shqiptar. Në rastin e priftërinjve serb të vrarë në kllokot, p.sh, kur i një dyshuar shqiptar u arrestua nga policia e UNMIK-ut ishte liruar më vonë nga ana e gjyqtarir hetues. Një prokuror ndërkombëtar kishte kërkuar që i dyshuari në fjalë të ri-arrestohet, mirëpo pritet që gjyqi të vendos për këtë kërkesë.
38. **Qasja ndaj avokatit mbrojtës:** për shkak se nuk ekziston ndonjë arsye e brendshme në bazë të së cilës një person i një nacionaliteti përkatës nuk do të jetë në gjendje që t'i sigurojë një mbrojtje kompetente dhe profesionale personit të nacionalitetit tjetër, shumë prej të të pandehurve që vijnë nga rradhët e pakicave preferojnë që të angazhojnë avokatë të të njëjtit nacionalitet. Për shkak se avokatët që vijnë poashtu nga rradhët e pakicave janë të rrallë, do të jetë shumë vështirë që të respektohet e drejta e të pandehurit për të zgjedhur vetë avokatin mbrojtës i cili do ti përfaqëson në mënyrë të denjë interesat e tij në gjyq. Për shembull, ekzistojnë vetëm ca avokatë të nacionalitetit serb përderisa nuk kemi vërejtur se ekziston ndonjë i tillë nga rradha e romëve i cili është duke e ushtruar profesionin e mbrojtës diku në Kosovë, edhe pse ekziston një i tillë në pejë dhe një tjetër në Dragash.<sup>8</sup> Kualiteti i mbrojtjes mbetet mjaft i varfër në shumicën e rasteve ku kërkohet urgjentisht të mbahen trajnime dhe të mirren masa shtuese në këtë drejtim. Qasja ndaj klientit është poashtu një çështje që don vëmendje të veçantë: gjyqi i qarkut në Mitrovicë ka lëshuar 'fletëleje' për avokatët e të pandehurve që vijnë nga rradhët e pakicave, duke caktuar datën e saktë, kohën dhe kohëzgjatjen e vizitës së lejuar. Këto të ashtuquajtura fletëleje si duket nuk është e nevojshme që të lëshohen për avokatët e të pandehurve që vijnë nga rradhët e popullatës shumicë në Kosovë. Besueshmëria e takimeve avokat – klient është një çështje që me të vërtetë brengos. Në Mitrovicë, ka pasur raste kur nënpunësit e gjyqit kanë marrur pjesë gjithashtu nëpër takime të natyrës së tillë.
39. **Gjuha:** mungesa e përgjithshme e politikës së gjuhës shkakton probleme të natyrës së veçantë nëpër sistemet e gjyqeve. Të gjithë të pandehurit kanë të drejtë që procedurat gjyqësore kundër tyre të mbahen në gjuhën të cilën ata e kuptojnë. Praktika siç është lëshimi i thirrjeve për në gjyq vetëm në gjuhën shqipe, pastaj dështimi për të siguruar përkthimin adekuat gjatë tërë mbajtjes së procedurës gjyqësore, e shkel këtë të drejtë. Distribrimi i pajisjeve për përkthim nëpër gjyqe ka përmirësuar dukshëm në kualitetin e mbajtjes së procedurave penale përderisa ende kemi raste kur nuk është siguruar një përkthim i plotë dhe adekuat, prapëseprapë situata e tërësishme sa i përket këtij aspekti dukshëm është përmirësuar. Problemi për sa i përket çështjes së publikimit të dokumenteve të gjyqit vetëm në gjuhën shqipe poashtu është lehtësuar mjaft, duke vijuar pas udhëzimeve të dhëna nga PSSP të KB-së nënpunësve të gjyqit se dokumentet duhet lëshuar në qarkullim në të gjitha gjuhët zyrtare. Shembuj të veçantë kur dokumentet e lëshuara në qarkullim vetëm në gjuhën shqipe vazhduan të vërrehen edhe më vonë, sidomos në zonën e Dragashit.

<sup>8</sup> Gjyqtari me përkatësi romë në Dragas/ Dragash ishte ankuar vazhdimisht për sa i përket udhëtimit të tij për në Dragash, e pasi që ai jeton në Prizren. Gjyqtari në fjalë kishte kërkuar që të emërohet si gjyqtarë në Prizren në vend se në Dragash.

40. **Gjyqtarët dhe prokurorët që vijnë nga rradhët e minoriteteve:** përderisa përpjekjet janë të fokusuar më shumë kah ajo që të gjitha komunitetet përkatëse të përfqësohen në mënyrë të drejtë në organet e gjyqit, gjyqësia është ende e natyrë monoetnike dhe ndërmjet rezultateve të tjera, kjo ndikon në paanshmërinë e perceptuar të sistemit<sup>9</sup> që nga 22 shtatori, 4 gjyqtarë me përkatësi etnike turq, 11 boshnjakë, 2 romë; dhe 4 serbë. Rritja e numrit të gjyqtarëve që vijnë nga rradhët e minoriteteve që duhet përfshirë në sistem, edhe pse kjo gjë është mjaft e vështirë për tu realizuar për arsye të sigurisë, është vetëm një pjesë e mjetit të kërkuar juridik. Gjyqtarët punojnë në kolegje andaj nuk do të ishte as efektive e as e përshtatshme të krijohet një sistem paralel ku minoritetet do të gjykoreshin vetëm nga gjyqtarët e të njëjtës përkatësi etnike sikur të pandehurit. Gjyqtarët që vijnë nga rradhët e minoriteteve duhet që plotësisht të inkorporohen në sistemin juridik ekzistues në atë mënyrë e cila u lejon atyre që të luajnë një rol të plotë dhe aktiv në ndarjen e drejtësisë në një mënyrë korrekte dhe të paanshme.
41. Para së gjithash, sistemit ligjor i nevojitet urgjentisht një numër i ndryshimeve përkatëse. Themelimi i një sistemi i cili është i drejtë dhe i cili duket të jetë i drejtë kërkon një brez (seri) masash që duhet ndërmarrur duke përfshirë këtu; trajnimet e vazhdueshme për gjyqtarë, trajnime avansuese për avokatë të mbrojtjes, një rishikim që është duke u bërë i legjislacionit në përgjithësi, shfuqizimin (abrogimin) e ligjeve diskriminuese, dhe themelimi i një sistemi efektiv disiplinor i cili do të ndëgjojë dhe përkufizojë pohimet mbi animet (anësimet). Masat e tilla duhet të jenë pjesë e një strategjie të pastër dhe afatgjate. Rregulloret e reja (duke përfshirë këtu edhe mjetin juridik i cili do të mundësoi realizimin në praktikë të dërgimit të fletëthirrjeve për në gjyq; më shumë trajnim; përpjekje më të mëdha për tu ndihmuar të pandehurve që të angazhojnë avokatët sipas zgjedhjes së tyre; përpjekje të mëtejme për krijimin e një sistemi multi-etnik ligjor; dhe një monitorim të vazhdueshëm dhe të përaafërt të sistemit si një tërësi, janë të gjitha faktor të domosdoshëm për realizimin e një strategjie të tillë. Brengosjet për sa i përket sistemit ligjor nuk janë të kufizuara në aspektin e trajtimit të minoriteteve, edhe pse ato janë me rëndësi të veçantë për minoritetet – shumica e rekomandimeve të tanishme do të mund të ndihmojnë në përmirësimin e sistemit për sa i përket çështjes së të pandehurve, dëshmitarëve dhe viktimave të grupeve të ndryshme etnike.

## **Qasia në strukturat politike**

42. Një tregues (indikues) mjaft i rëndësishëm për aftësinë e minoriteteve për mbrojtjen e të drejtave të tyre është aftësia, dhe vullneti i mirë për t'ju qasur strukturave politike, si në nivelin e komunave ashtu edhe në atë të Kosovës. Janë bërë ndryshime mjaft të rëndësishme gjatë muajve të fundit për sa i përket kësaj çështjeje derisa ndryshimet e mëtejme që do të bëhen në të ardhmen presin rezultatet e zgjedhjeve komunale të 28 tetorit.

### **Strukturat e përbashkëta të përkohshme administrative (JIAS)**

43. Një indikues thelbësor për pjesëmarrjen e minoriteteve në strukturat politike deri më tani ka qenë pjesëmarrja e tyre në strukturat e përbashkëta të përkohshme administrative. Periudha e cila ishte e shquar me vlerësime të bëra të llojit të tillë filloi me tërheqjen e kështillit nacional serb nga pozita e saj e vëzhguesit që e kishte në kështillin e përkohshëm administrativ (KPA) më 4 qeshor, organ ky qëndror i strukturave të përbashkëta të

<sup>9</sup> Komisioni Këshilldhënës Legjislativ shpalli konkurs për pozita gjyqësore anembanë Kosovës. Duke filluar që nga Nëntori i vitit 1999, KKL-ja pranoi më se 700 aplikacione dhe mbajti afër 560 intervista individuale. Pavarësisht prej përpjekjeve të harmonizuara të UNMIK-ut që t'i gjejnë dhe rekrutojnë sa më shumë pjesëtarë të minoriteteve në sistemin ligjor, vetëm një disa prej tyre aplikuan, duke cituar dy arsye: e para është mosafesia për t'ju garantuar atyre siguri, presioni mbi ta që e ushtrojnë autoritetet në Beograd për të marrur pjesë në kuadër të këtij sistemi. Gjatë sesioneve të tyre të 11 dhe 12 Dhjetorit të vitit 1999, KKL zgjodhi më se 300 gjyqtarë profesionalë, prokurorë publik dhe gjyqtarë porotë. Rekomandimet sa i përket kësaj çështjeje i ishin përcjellur PSSP-së më 13 Dhjetor të vitit 1999. Ceremonia fillestare e dhënies së betimit ishte mbajtur në janar të vitit 2000, por vetëm ca prej gjyqtarëve të emëruar nga rradhët e minoriteteve morrën pjesë në këtë ceremoni. Vetëm 245 gjyqtarë dhe 42 prokurorë publik kishin dhënë betimin e tyre. Prej numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve profesionalë që kishin dhënë betimin, vetëm 8 prej tyre vinin nga rradhët e minoriteteve, ku prej tyre ishin me përkatësi etnike serbë. Në mesin e gjyqtarëve porotë 13 prej tyre vinin nga rradhët e minoriteteve, ku asnjë prej tyre nuk ishin me përkatësi etnike serbë. Prej numrit të përgjithshëm të prokurorëve publik, vetëm dy prej tyre vinin nga rradhët e komunitetit pakicë në Kosovë. Një prokuror publik gjithashtu dha dorëheqje. Që prej 31 Korrikut 2000, ekziston shifra e përgjithshme prej 230 gjyqtarëve, 235 gjyqtarëve porotë dhe 41 prokurorëve publik.



përkohshme administrative. Kjo tërheqje ishte një shenjë e protestës kundër paaftësisë së perceptuar të bashkësisë ndërkombëtare për të mbrojtur komunitetin serb të Kosovës, që erdhi pas një mori të sulmesh të ashpra që ndodhën kundër tyre javëve që shkuan. Pas negociatave ekstensive (zgjatura), kës përsëri u kthye për të marrur pjesë në punën e strukturave administrative mirëpo me një kusht të cilën edhe e bënë të ditur gjatë nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit të cilën e nënshkruan peshkopi Artemije KNS (Graçanicë) dhe Dr. Kouchner PSSP të KB-ve. Ky memorandum i mirëkuptimit, i nënshkruar më 29 qeshor 2000, e detyroi UNMIK-un që të ndërmarrë hapa të mëtejme në lëmin e sigurisë; gjyqësisë; kthimit të refugjatëve, personave të zhdukur, emërimit e nënpunësve që do të punojnë me komunitetet vendore; dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe në Kosovë.

44. Pjesëmarrja e minoriteteve në strukturat e përbashkëta të përkohshme administrative përfshin këtu: pjesëmarrjen e kës në cilësinë e vëzhguesit në KPA, së bashku më 4 përfaqësuesit e tyre që marrin pjesë në këshillin tranzitor të Kosovës. Minoritetet e tjera nuk janë të përfaqësuara në KPA mirëpo ato marrin pjesë në punën e KTK-së duke përfshirë këtu: 2 sllavo-musliman (boshnjakë), dy turq, dhe një rom. Një vend mbetet i hapur për përfaqësuesit e hashkalinjëve dhe egjiptianëve mirëpo pritet që ata të mirren vesh në mes veti rreth përfaqësuesit të përbashkët i cili do t'i përfaqësojë të dyja këto komuniteteve në strukturat në fjalë, duke arsyetuar faktin se ato janë dy komunitete që dallojnë në mes veti dhe për këtë arsye nuk janë të obliguar që të ndajnë vendin e përbashkët në KTK. Pjesëtarët e minoriteteve janë emëruar gjithashtu në pozita përkatëse në departamentet e JIAS-it. Për bashkëkryesues të departamentit për transport dhe infrastrukturë është zgjedhur një pjesëtar i komunitetit turk, ndërsa për departamentin për mbrojtje të ambientit është zgjedhur një pjesëtar i komunitetit boshnjak derisa pozitat e bashkëkryesuesve të departamenteve të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit të zonave rurale, punës dhe për punësim janë të zëna nga pjesëtarët e komunitetit serb. Nuk kemi ndonjë të emëruar nëpër pozitat e bashkëkryesuesve të departamenteve përkatëse që vijnë nga rradhët e komunitetit të romëve, hashkalinjëve, apo egjiptasve.
45. Në nivelin komunal kemi lloje të ndryshme të strukturave, duke përfshirë këtu edhe këshillat komunalë dhe bordet administrative, në cilëndo prej komunave përkatëse të cilat struktura janë të ngarkuara me punët e përditshme për sa i përket udhëheqjes së çështjeve komunale. Këto struktura do të fitojnë fuqi (pushtet) më të madhe pasi që këto të jenë transformuar në organe të reja të dala nga zgjedhjet komunale të 28 tetorit. Pjesëmarrja e minoriteteve në këto organe ndryshon prej vendit në vend. Në rastin e serbëve të Kosovës, ky ndryshim i numrit të pjesëmarrësve në strukturat komunale që vijnë nga rradhët e komunitetit serb ngjan për shkak të bojkotit që serbët ua bëjnë këtyre organeve. Sidoqoftë në disa komuna, p.sh në Novo Bërdë serbët e Kosovës kishin marrur pjesë në punën e këtyre strukturave pa pasur ndonjë incident. Pjesëtarët e nacionalitetit rom, ashkalinjë dhe atij egjiptian janë të përfaqësuar si nëpër këshilla komunalë ashtu edhe nëpër bordet administrative të shumë komunave anembanë Kosovës, varësisht prej fuqisë së tyre numerike që ata e kanë në rajonin përkatës. Kjo gjendje nëpër organet e komunave natyrisht se do të ndërrojë pas mbajtjes së zgjedhjeve komunale.
46. Në rajonet ku pakicat jetojnë në një numër më të madh krahasuar me numrin e përgjithshëm të popullatës së atij rajoni, ishin emëruar edhe të ashtuquajturit nënpunës të UNMIK-ut për punë me komunitetet vendore, ku qëllimi kryesor i tyre është dhënia e ndihmës minoriteteve në mënyrë që ata të kenë qasje ndaj shërbimeve të ndryshme publike. Të ashtuquajturit nënpunës të komuniteteve vendore janë emëruar në 23 komuna prej 30 sosh sa ekzistojnë në këtë moment në Kosovë, ku në të ardhmen do të angazhohen (punësohen) edhe nëpër komunat e tjera. Në bazë të rregullores 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë nënpunësit do të jenë pjesë e strukturave komunale (shiko mëposhtë nën strukturat e reja komunale).
47. Çështja thelbësore politike që mbizotëroi në muajt e fundit në Kosovë ishte regjistrimi i popullsisë (si për regjistrin votues ashtu edhe për atë civil). Faza e parë e regjistrimit u mbyll me 19 korrik 2000. Përgjegjja që erdhi nga komunitetet e pakicave ndaj procesit të regjistrimit ishte e ndryshme. Pavarësisht prej përpjekjeve mjaft intenzive të bëra për të përfshirë sa më shumë pjesëtarë të pakicave në procesin e regjistrimit, në fund doli që vetëm disa pjesëtarë të nacionalitetit serb ishin regjistruar (shënimet sa i përket numrit të

personave të regjistruar që vijnë nga rradhët e pakicave nuk ishin mbajtur nadaj është e pamundshme që të dijmë numrin e saktë të tyre). Njëra prej arsyeve se pse ata nuk morrën pjesë në regjistrim ishte kërcënimi që iu bëhej si nga ana e komunitetit të tyre ashtu edhe nga jashtë. Kah fundi i periudhë së regjistrimit udhëheqësi i kns-së së Leposaviqit deklaroi se ai e kishte përkrahur procesin e regjistrimit mjirëpo shumë pak serbë iu përgjigjën thirrjes së tij për tu regjistruar. Një qendër e regjistrimit për atë zonë ishte e mbajtur e hapur edhe pas përfundimit të fazës së parë të regjistrimit me shpresë se mos do të kemi një kthesë sa i përket numrit të serbëve të interesuar për tu regjistruar, kërkonte siguri të shtuar për shkak të kërcënimeve me dhunë që vinte nga disa sektorë tjerë të banuar me serbë. Asnjë parti e cila do ti përfaqësonte interesat e serbëve nuk ishte regjistruar për të marrur pjesë në zgjedhje. Pjesëtarët e nacionalitetit turk poashtu e bojkotuan procesin e zgjedhjeve për shkak të mosnjohjes së gjuhës së turke si gjuhë zyrtare. Megjithatë, dy parti turke, TDB dhe KTHP, sikurse edhe Aleanca Qytetare Turke në Mitrovicë ishin regjistruar për të marrur pjesë (garuar) në zgjedhje. Për sa i përket regjistrimit të sllavo-muslimanëve (boshnjakëve) mund të themi se numri i të regjistruarve të këtij nacionaliteti ndryshonte prej vendit në vend, derisa tre parti boshnjake (SDA: BSDAK dhe DRSM), një iniciativë qytetare e goranëve ishin regjistruar për të marrur pjesë (garuar) në zgjedhje. Kishte edhe pjesëtarë të nacionalitetit rom, ashkalinjë dhe atij egjiptianë që ishin regjistruar. Numri i ashkalinjve dhe egjiptianëve të regjistruar duket të kishte qenë më i madh se ai romëve. Një parti e ashkalinjve ishte regjistruar për të marrur pjesë në zgjedhje sikur që kishte edhe kandidatë të pavarur nga rradhët e egjiptianëve që konkurronin në gjakovë.

48. Komisionet komunale zgjedhore (KKZ) ishin formuar me qëllim të mbikëqyrjes së aktiviteteve që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Edhe pjesëtarët e pakicave të ndryshme ishin të përfaqësuar nëpër këto komisione me përjashtim të atyre të nacionalitetit serb të cilët mungonin për të marrur pjesë nëpër këto komisione për shkak vetë kishin zgjedhur kështu.

#### Strukturat e reja komunale

49. Pas mbajtjes së zgjedhjeve komunale pritet që përbërja e tanishme e këshillave komunalë do të pësojë ndryshime drastike. Duke e ditur se kemi një numër të kufizuar të regjistruarve që vijnë nga rradhët e pakicave (dhe për këtë arsye pritet të kemi një pjesëmarrje të kufizuar këtyre grupeve etnike në këto zgjedhje) është vështirë të ngjasë që të kemi pjesëtarë të minoritetëve të përfaqësuar nëpër asambletë komunale. Edhe për ato minoritetet që janë regjistruar dhe dëshirojnë të marrin pjesë në zgjedhje, dobësia e tyre në numër që e kanë në krahasim me popullatën shumicë, e bashkuar me faktin se ekziston një numër i kufizuar të kandidatëve që vijnë nga rradhët e pakicave që konkurrojnë në këto zgjedhje, mund të rezultoi në dështim të përpjekjes për të arritur që të kemi kandidatë të zgjedhur që do ti përfaqësojnë interesat e komuniteteve pjesëtarë të të cilëve janë. Duke të qenë të vetëdijshëm për faktin se çfarë autorizime do t'u jipen organeve të zgjedhura, për sa i përket çështjeve siç janë shërbimet banesore dhe ato sociale, roli monitorues që do ta ketë UNMIK-u do të jetë crucial për sa i përket mbrojtjes së drejtë të interesave të pakicave nëpër këto organe. PSSP i KB-ve ka fuqi që në bazë të Rregullores 2000/45 që të kooptoj anëtarët shtesë nëpër asambletë komunale nëse konsideron se është e nevojshme që të bëhet një gjë e tillë në mënyrë që të kemi një përfaqësim të të gjitha komuniteteve sipas rezolutës 1244 të këshillit të sigurimit. Një komponentë esenciale këtu e çfarëdo lloj emërimi të tillë duhet të jektë fakti se duhet të sigurohet një përfaqësim i drejtë i minoritetëve sidomos në zonat ku ata përbëjnë një përqindje me rëndësi në numrin e përgjithshëm të popullatës.

50. Me rëndësi të njëjtë cruciale në strukturat e reja komunale do të jenë edhe sistemet e vendosura (formuara) të dedikuara për mbrojtjen e pakicave. Rregullorja 2000/45 kërkon themelimin e komitetit të komuniteteve dhe komitetit për ndërmjetësim në secilën komunë të cilat komitete kanë për detyrë që të sigurojnë që të drejtat e minoritetëve të mbrohen në mënyrë të përshtatshme dhe që personat që marrin përsipër kryerjen e detyrave në shërbimet publike apo ata që janë të emëruar nëpër postet e tyre zyrtare të mos veprojnë në mënyrë diskriminuese. Në vazhdim për ato komuna ku komuniteti përkatës nuk është shumicë mirëpo ai formon një pjesë substanciale të popullatës duhet të formohet një zyrë e komunitetit. Këto zyra do të jenë të hapura vetëm përkohësisht, duke ekzistuar për aq kohë përderisa autoriteti qendror konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme. Roli i

kësaj zyreje është që të rris rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve përkatëse dhe sigurimi që këta njerëz të kenë të drejta të barabarta kur është në pyetje qasja e tyre në shërbimet publike në nivel komunal. Mbetet të shihet se sa efektive do të jenë këto institucione dhe çfarë të drejta do të kenë ato. Megjithatë është për të shpresuar se ato do të mund të luajnë një rol pozitiv në mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve.

#### OJQ-të

51. Përderisa nuk është korrekt konsiderimi i punës së OJQ-ve si aktivitet politik, fakti se minoritetet kanë qenë aktive në formimin e OJQ-ve paraqet një tregues të rëndësishëm të pjesëmarrjes së përgjithshme në shoqërinë civile. Shfaqja e OJQ-ve aktive është një akt i legjitimitetit të komuniteteve minoritare. Këto u ofrojnë atyre mekanizma të duhur nëpërmjet të cilëve ata i mbrojnë të drejtat e komuniteteve të tyre dhe zhvillojnë projekte dhe aktivitete të cilat u përgjigjen nevojave të tyre. OJQ-të luajnë një rol të rëndësishëm në mbajtjen e strukturave politike si përgjegjëse ndaj popullatës të cilës ata i shërbejnë. Për më tepër, bashkëveprimi ndërmjet OJQ-ve ndërkombëtare dhe atyre vendore mundëson ndërtimin e institucioneve dhe kontribuon në procesin mësimor të bazuar në përvojat dhe veprimet e shkëmbyera. Kjo u mundëson komuniteteve minoritare që përmes OJQ-ve të tyre të veprojnë si katalizatorë pozitiv të ndryshimeve. OSBE-ja ka ndihmuar në ngritjen e disa OJQ-ve të minoriteteve e në veqanti në mesin e komunitet të romëve në Kosovë. OJQ-të e tilla momentalisht egzistojnë apo janë në procedurë të regjistrimit, në prizeren, Gjilan (komuniteti i romëve tanimë e ka formuar një OJQ dhe ka kërkuar mbështetje në formimin e të dytës me radhë e cila do të fokusohet në nevojat e grave romë), Kamenicë, Rahovec (OJQ e grave), graçanicë, shtërpçë dhe Mitrovicë. Këto OJQ kanë nevojë për një mbështetje të vazhdueshme në fonde dhe ndërtim të institucioneve për të realizuar shërbim të kapacitetit të plotë për nevojat e komunitetit të tyre. Në fuqizimin e lidhjeve në mes të OJQ-ve ndërkombëtare dhe në veqanti OJQ-ve vendore sapo të shfaqura, OJQ-të minoritare do të jenë faktor i rëndësishëm në përqëndrimin e burimeve të arritshme drejt nevojave të komuniteteve minoritare.

#### Iniciativat drejt tolerancës

52. Gjatë periudhës së raportimit kishte mjaft zhvillime me respekt në një numër të iniciativave të drejtuara kah një tolerancë dhe mirëkuptim i rritur dhe i nxitur ndëretnik. Në kuadër të këtyre iniciativave përfshiheshin edhe platforma për një aksion të përbashkët e cila ishte nën mbikëqyrjen e UNHCR-së, pakti i Kosovës si dhe iniciativa të tjera të filluara nga pjesëtarë të minoriteteve dhe të vazhduara pastaj nga ana e UNMIK-ut, dhe konferenca e arlie house-it e mbajtur në shba e përkrahur nga instituti për paqe i shteteve të bashkuara. Të gjitha këto iniciativa paraqesin përpjekje të përbashkëta dhe të bashkërenditura për të siguruar që nevojat e komuniteteve të minoriteteve dhe marrëdhëniet e tyre me shumicën e shqiptarëve në Kosovë të përkrahen zhvillimet që janë duke ndodhur për një shoqëri demokratike. Përderisa këto zhvillime nuk mund të ofrojnë zgjidhje perfekte për të gjitha problemet apo sëmundjet që e mundojnë Kosovën në këtë moment, cilado prej këtyre iniciativave në mënyrën e vet paraqesin një hap të ndërmarrë në drejtim të drejtë. Këto zhvillime apo iniciativa paraqesin një prej shumë hapave që duhet ndërmarrur në rrugën e gjatë drejt pajtimit dhe ko-ekzistencës paqësore ndërmjet të gjitha komuniteteve në Kosovë.

53. **Platforma për aksion të përbashkët** (e cila mbërthen në vete komunitetet siç janë ai i romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve) është një dokument bazë që rezultoi pas një serie të takimeve nëpër tryeza të rrumbullakëta të udhëhequra këto nga ana e UNHCR-së në çerekun e parë të këtij. Nga këto takime të llojit të tillë gjithsej u mbajtën tre prej tyre ku në dy të parat morrën pjesë pjesëtarët e komunitetit rom, ashkalinjë dhe atij egjiptian, derisa në të tretin me radhë merrnin pjesë edhe liderët e shqiptarëve të Kosovës. Në takimin e tretë me radhë ishte miratuar një deklaratë e përbashkët e cila dënonte ashpër të gjitha aktet e dhunës dhe keqtrajtimit të cilat vetëm shkaktojnë ndarje ndërmjet komuniteteve në Kosovë dhe shtojnë fillimin enjë procesi të pajtimit dhe shërimit të plagëve ndërmjet komuniteteve në Kosovë. Kjo deklaratë nisi rrugën drejt një përpilimi të një dokumenti edhe më të detajuar i cili përcaktonte fushat kryesore të brengosjes sikurse që ishin identifikuar nga ana e pjesëmarrësve të këtyre tryezave të

- rrumbullakëta, duke përfshirë këtu edhe hapat e ndërmarrë drejt një mirëmkuptimi më të madh ndërmjet komuniteteve në Kosovë, kthimi i refugjatëve personave të zhvendosur, influencën të cilën e kanë mediat si dhe qasjen ndaj shërbimeve publike. Dokumenti final që kishte formën e një platformeje për aksion të përbashkët u pranua nga ana e të gjithë pjesëmarrësve e cila gjë ndihmoi në miratimin zyrtar të këtij dokumenti në sesionin e përbashkët të KTK-së dhe KPA-së më 28 prill gjatë vizitës së ambasadorëve të vendeve anëtare të keshillit të sigurimit që ata ia bënë Kosovës. Sidoqoftë kjo platformë përcakton objektivat (qëllimet) që duhet përmbushur në bashkëpunim me liderët Kosovarë që vijnë nga rradhët e të gjitha komuniteteve dhe në bashkëpunim me plotë edhe me bashkësinë ndërkombëtare.
54. Duke iu përmbajtur premtimeve të dhëna dhe detyrimeve të përcaktuara në bazë të platformës në fjalë, anëtarët shqiptarë të KPA-së ndërmorrën një seri vizitash ndaj familjeve romë, ashkalinjëve dhe atyre të komunitetit egjiptian; duke vizituar Prizrenin dhe Ferizajin më & qeshor dhe pejën më 4 shtator. Këto vizita të bëra nga përfaqësues të lartë të KPA-së iu dha një mundësi liderëve të shqiptarëve të Kosovës që të mësojnë nga dora e parë për llojet e problemeve me të cilat pjesëtarët e minoriteteve janë duke u ballafaquar. Në vazhdim, ata siguruan një mundësi që edhe akterët e tjerë të dënojnë dhunën dhe që edhe njëherë të përsërisin faktin se komunitetet e minoriteteve duhet të luajnë një rol aktiv dhe pozitiv në zhvillimin e ardhshëm të shoqërisë Kosovare, duke punuar krahpërkrah me akterët e tjerë me qëllim të sigurimit që e gjithë kjo ide të arrihet në bazë të përfshirjes së minoriteteve në këtë proces dhe jo-diskriminimit të tyre. Deklaratat e tilla luajnë një rol të rëndësishëm në kundërshtimin që duhet bërë dhunës dhe posedimit të imunitetit.
55. Në kuadër të procesit të çuarjes mëtej të platformës u mbajt edhe takimi konsultativo-tekniq më 25 shtator që zgjati vetëm një ditë dhe i cili përkrahej edhe nga ana e UNMIK-ut sa i përket kësaj çështjeje. Kjo siguroi një mundësi për zhvillimin e diskutimeve të përbashkëta dhe direkte të përfaqësuesve të komunitetit rom , ashkalinjë dhe atij egjiptian me zyrtarët e departamenteve përkatëse të strukturave të administratë së përkohshme të përbashkët. Në këtë mënyrë çështjet më rëndësi të parashtruara me platformë mund të shtjelloheshin edhe mëtej në detaje, duke i lejuar përfaqësuesve të komuniteteve në fjalë dhe zyrtarëve të UNMIK-ut që t'i përcaktojnë se cilat janë problemet e tyre specifike që mëpastaj të fillojnë për të diskutuar mbi zgjidhjen e mundshme të këtyre problemeve. Ky takim ishte i mirëseardhur nga të dy palët si një mjet praktik për të ecur përpara dhe pritet që të kemi një seri të këtyre takimeve të tilla në të ardhmen me qëllim që të sigurojnë që të arrihet një përparim real në këtë drejtim.
56. UNMIK-u ka për qëllim që të ndjek një qasje të ngjashme ndaj komuniteteve të tjera minoritare. Më 16 tetor u mbajt edhe një takim në të cilin merrnin pjesë edhe përfaqësuesit e komunitetit boshnjak dhe atij goran përderisa pritët që të kemui takime me përfaqësuesit e komunitetit turk në të ardhmen e afërt. Takimet e këtij lloji formojnë në pjesë të përpjekjeve më të gjera të bëra nga ana e UNMIK-ut me qëllim të promovimit të idesë për paktin e Kosovës dhe iniciativave të veçanta të filluara për çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me pakicat. Qëllimi i paktit të Kosovës është që të përfshijë sa më shumë Kosovarë në zhvillimin e një debati të hapur dhe transparent mbi rolin që e kanë ata në krijimin e një shoqërie pa dhunë dhe të ushqyer me idenë e respektimit të të drejtave të njeriut. PSSP-ja, dr. Kouchner është kyçur në një program për t'iu qasur publikut duke marrur pjesë nëpër shumë takime të mbajtura nëpër salla të sporteve të qyteteve të ndryshme anembanë Kosovës me qëllim të promovimit të idesë mbi mbajtjen e këtij debati, dhe duke e pruar atë në nivel të komunave, duke iu thënë të gjithë qytetarëve të Kosovës të të gjitha nacionaliteteve , se politikat dhe programet e dizajnuara për të pasur një përfitim (dobi) të dyanshme mund të implementohen vetëm nëpërmjet të pjesëmarrjes dhe përkrahjes së tyre të plotë. Në kuadër të këtij konteksti iniciativa për minoritetet jo-serbe është e dizajnuar që të sigurojë që të nevojat e veçanta të komuniteteve në fjalë të mos bien dhe shumë në sy. Ekzistonte edhe një kritikizëm i dhënë nga ana e anëtarëve që vijnë nga rradhët e minoriteteve në KTK për debatin, për shkak se ky debat ishte më shumë i koncentruar në nevojat e komunitetit serb në Kosovë duke i përjashtuar më shumë nga ky proces komunitetet më të vogla minoritare. Si rrjedhojë e kësaj UNMIK-u vendosi që t'i përgjigjet këtij kritikizmi me një paketë të iniciativave që duhet ndërmarrë për grupet e tjera etnike që nuk janë serbë. Kjo nuk do të thotë se serbët e Kosovës janë lënë jashtë këtij programi. Pakti i Kosovës iu drejtohet të gjithë Kosovarëve. Sidoqoftë, duke pasur parrassysh faktin se secili komunitet ka nevojat

e saja të veçanta, dhe se ato të komuniteteve të tjera më të vogla nuk janë shqyrtuar si duhet, sikurse ato të komunitetit të serbëve të Kosovës, UNMIK-u është duke u munduar të marr masa të ndryshme sa i përket njohjes nga afër të këtyre problemeve, ku disa prej këtyre masave i adresohen vetëm disa prej minoriteteve përderisa disa prej tyre i adresohen tërë. Dihet se duhet të punohet në përpilimin e mëtutjeshëm të detajeve të iniciativës për minoritetet jo-serbe. Faza e tanishme e këtij procesi koncentrohet në lehtësimin e një komunikimi interaktiv ndërmjet të përfaqësuesve të secilit komunitet dhe zyrtarëve të UNMIK-ut me qëllim të identifikimit të prioriteteve. Kjo mënyrë e komunikimit ka për qëllim që të sigurojë një sasi të caktuar të informatave për UNMIK-un në mënyrë që ata të vijnë me përgjegje të dizajnuara për sa i përket secilës prej nevojave të komuniteteve në fjalë. Çështjet thelbësore janë ato të sigurisë të cilat tejkalojnë çdo kufi përderisa problemet e tjera mund të kërkojnë përgjegje të ndryshme për sa i përket problemeve me të cilat ballafaqohen komunitetet në fjalë.

57. Konferenca e arlie house-it ishte mbajtur në shba në periudhën prej 21 deri më 23 korrik të vitit 2000. Në këtë konferencë morrën pjesë edhe delegacionet e shqiptarëve të Kosovës si dhe atyre të serbëve të Kosovës duke siguruar një forum përkatës në kuadër të të cilit ata kishin mundësi ti shkëmbejnë pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre në mënyrë të sqartuar dhe të fillonin bashkisht në gjurmimin e qasjeve dhe rrugëve përkatëse që do të na shpënin drejt përmirësimit të marrëdhënieve ndëretnike ndërmjet këtyre dy komuniteteve. Qëllimi i konferencës ishte që t'i inkurajojë të dyja palët në mënyrë që ata të mësojnë se cilat janë qëllimet e tyre të përbashkëta dhe përfitimet (dobitë) e dyanshme që mund të fitohen nga nxitja apo ushqimi i idesë për një Kosovë tolerante dhe pa dhunë. Në konferencë u arrit të mësohet për faktin se ky proces përmban në veti një rrugë të gjatë në të cilën të dyja komunitetet duhet kyçur bashkisht në frymën e gjurmimit të hapave pozitiv të cilët mund të ndërmerren e që shpiejnë drejt ndërtimit të një ambienti paqësor, pavarësisht prej dhimbjeve/plagëve dhe vuajtjeve nëpër të cilat këto komunitete kaluan gjatë të kaluarës. Për serbët kjo do të thotë se ata duhet ta pranojnë faktin se ata duhet të punojnë së bashku me shqiptarët dhe komunitetet e tjera për të ndërtuar institucionet demokratike dhe një shoqëri të lirë në Kosovë. Ndërsa për shqiptarët kjo nënkupton se ata duhet të pranojnë faktin se serbët dhe komunitetet e tjera në Kosovë duhet të gëzojnë të drejta të barabarta dhe një mbrojtje adekuate sikur edhe shqiptarët. Përfundimi (rezultati) më i rëndësishëm dhe më praktik i kësaj konference ishte miratimi i një deklaratë e cila i detyron të dyja komunitetet që ti përmbahen këtyre objektivave. Pasi që u kthyen në Kosovë delegatët e kësaj konference ishin të inkurajuar dhe të përkrahur nga zyra e SHBA-ve në Prishtinë që t'i demonstrojnë zotimet e tyre me veprime konkrete. Si rezultat i këtyre përpjekjeve 9 shtatori u caktua si një ditë kundër dhunës, rast i cili u shënua me demonstrata publike kundër jotolerancës dhe diskriminimit të mbajtura anembanë Kosovës. Fatkeqësisht nuk ishte e mundur për të dyja delegacionet që të marrin pjesë në një ngjarje të tillë mjaft inkluzive për shkak të tensioneve të rritura në vend si rezultat i një rrebesh sulmesh të dhunshme kundër pjesëtarëve të komunitetit serb. Megjithatë një ditë e tillë u shënua me një seri ngjarjesh që vinin nga rradhët e të gjitha komuniteteve në Kosovë. Në një marsh publik në Prishtinë, PSSP-ja ftoi të gjithë qytetarët e Kosovës që ta hedhin poshtë dhunën si opcion për zgjedhjen e problemeve dhe që më mirë të drejtojnë energjinë e tyre në një rrjedhë drejt ndërmarrjes së një numri të detyrave me qëllim të sigurimit të një të ardhmeje stabile dhe paqësore për të gjitha komunitetet. Fakti se dr kouchner u detyrua që ti thotë ca fjalë në gjuhën serbe të drejtuara publikut e cila rezultoi me fishkëllima tregon se ende ekziston një zemërim në mesin e njerëzve anasjelltas nevojitet shumë për tu bërë me qëllim që të situata të përmirësohet e të përparojë në këtë aspekt. Kjo, megjithatë nuk bën që të përdoret si një pretekst për mosveprim apo indiferencë.

58. Duke coinciduar me ditën kundër dhunës, OJQ-të e ndryshme lëshuan një deklaratë të përbashkët për publik, e cila deklaratë u nënshkrua edhe nga 78 OJQ të tjera ndërkombëtare që gjenden në Kosovë. Deklarata në fjalë potenconte (theksonte) faktin se përpjekjet e kombinuara të OJQ-ve do të kenë efekt të vogël përderisa të drejtat themelore të njeriut mohohen dhe shkelen gati për çdo ditë. Ky dënim i unifikuar i dhunës nga ana e OJQ-ve ishte një gjest i mirëseardhur dhe një deklaratë e përpiluar në një kohë mjaft të përshtatshme. OJQ-të, si ato ndërkombëtare ashtu edhe ato vendore, në plan të parë kanë përmbushjen e nevojave humanitare të qytetarëve të Kosovës dhe përcaktimit të tyre për të vepruar njësoj në një mënyrë fer dhe të drejtë, duke u shëndruar në një faktor mjaft të rëndësishëm në ushqimin dhe nxitjen e idesë për krijimin e një shoqërie më tolerante. Një numër OJQ-ësh që punojnë në terren janë të përfshirë në lokalizimin e iniciativave e cila dëshmon për një bashkëpunim ndëretnik. Temelet të cilat po ndërtohen

tani nëpërmjet të projekteve konkrete të implementuara në terren nga ana e këtyre OJQ-ve do të shërbejnë si shembuj se çka mund të arrihet në fushën e tolerancës ndëretnike duke e kundërshtuar perceptimin e qëndrimit se komunitetet në Kosovë kanë hyrë në një proces të pakthyeshëm të luftimit të njëri tjetrit në baza etnike.

## **Language**

59. Vlerësimi i pestë me rradhë i bërë nga ana e OSBE/UNHCR-së potenconte për një numër të problemeve të shkaktuara (krijuara) për shkak të mungesës së njëllojshmërisë së policisë së UNMIK-ut për sa i përket përdorimit të gjuhës zyrtare të cilën ata e përdorin. Pavarësisht prej përparimit të kufizuar në zhvillimin e dhe publikimin e udhëzimeve mbi përdorimin e gjuhës për qëllime speciale, mungesa e një politike të qartë dhe të kuptueshme e cila do të aplikohet anëmbanë Kosovës vazhdon t'u shkon në dëm interesave dhe nevojave të minoriteteve të cilët nuk e kanë gjuhë amtare gjuhën shqipe.
60. Përdorimi mbizotërues i gjuhës shqipe duke përjashtuar përdorimin e gjuhëve të tjera , shpeshherë ishte në kundërshtim me udhëzimet e lëshuara nga ana e UNMIK-ut në lidhje me atë se disa dokumente duhet të publikohen në të tre gjuhët zyrtare (gjuhën angleze, shqipe dhe atë serbe) vazhdon të jetë një mesazh kuptimplotë drejtuar komuniteteve të minoriteteve se është shumë më mirë që ata të adaptohen në system se sa të presin që sistemi të jetë i adaptueshëm ndaj nevojave të tyre. Si rezultat i gjithë kësaj personat të cilët flasin në gjuhët më pak të përdorura kishin zgjedhur që ose të jenë të qetë ose përndryshe të influencojnë energjikisht në publikun për sa i përket njohjes së gjuhës së tyre si gjuhë zyrtare. Kjo qasje e kohëve të fundit mund të dëshmohej edhe me faktin se shumica e komunitetit turk refuzuan që të merrnin pjesë në procesin e regjistrimit, duke argumentuar se ligji i aplikueshëm i cili parasheh përdorimin e gjuhës turke si gjuhë zyrtare në masë të barabartë krahas përdorimit të gjuhës shqipe dhe asaj serbe sidomos në zonat e populluara me pjesëtarë të nacionalitetit turk, nuk është duke u zbatuar si duhet sa i përket kësaj çështjeje. Pas zhvillimit të negociatave mjaft të thukta u arrit një kompromis ndërmjet të përfaqësuesve të komunitetit turk dhe atyre të UNMIK-ut, për sa i përket përdorimit të gjuhës turke për qëllime komunale si p.sh lëshimi i dokumenteve zyrtare si p.sh siç janë çertifikata e lindjes, vdekjes dhe ajo e martesës në gjuhën turke dhe alfabetin turk, shenjave zyrtare në gjuhën turke si dhe përdorimin e alfabetit turk sidomos nëpër ato komuna ku turqit janë shumicë. Ky kompromis konsiderohet nga ana e par tive politike turke si një kornizë të pranueshme dhe të përkohshme duke pritur për një marrëveshje më definitive për sa i përket kësaj çështjeje. Në ndërkohë, një përparim mjaft i dukshëm ishte arritur mbi mbrojtjen e gjuhëve të minoriteteve nëpërmjet të kyçjes në rregulloren 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, të një modeli të ngjashëm me atë të arritur me pjesëtarët e komunitetit turk, duke i pranuar këto të drejta në zonat ku minoriteti në fjalë "formon një pjesë substanciale të popullsisë".
61. Në një zhvillim të kufizuar mirëpo të mirëseardhur, më 26 korrik 2000 PSSP-ja ua dërgoi një memorandum bashkëkryesuesve të Departamentit të Shërbimeve Komunale, Departamentit Për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si dhe atij të Drejtësisë, duke theksuar në atë memorandum se të gjitha dokumentet zyrtare (duke përfshirë këtu edhe llogaritë) të cilat i lëshohen në qarkullim publikut duhet detajisht të shtypen në gjuhën angleze, shqipe dhe atë serbe, me të tre këto gjuhë "zyrtare" të cilat paraqiten së bashku në document. Është e qartë se problemi i gjuhës së përdorur në dokumentet zyrtare nuk është edhe aq i shprehur. Megjithatë, mbetet problemi, sidomos në komunën e Dragashit/Gorës, i dokumenteve të lëshuara vetëm në gjuhën shqipe apo ato të lëshuara në gjuhën angleze dhe atë shqipe. Publikimi i udhëzimeve të 26 korrikut për departamentet e JIAS-it, një përsëritje e politikës së tillë të UNMIK-ut, dhe përhapja/shpërndarja e kërkesave të sakta të rregullores 2000/45 do të jenë mjaft të rëndësishme sidomos për të sqaruar qëndrimin e UNMIK-ut për sa i përket politikës mbi përdorimin e gjuhës.
62. Një politikë e qartë mbi çështjet e tjera që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhës është mëse e nevojshme nën kushtet e sotshme. Për shembull, për organet që kanë për detyrë që t'i shërbejnë tërë qytetarëve, si p.sh siç është shërbimi policor i Kosovës, rekrutimi i policisë sot fokusohet në të pasur it e policëve shqiptar në zonat e banuara me shqiptar dhe ata serbë në ato të banuara me serbë, etj. Në planin afatgjatë nëse shërbimi policor i Kosovës ka për qëllim që të punojë për të mirën e gjithë qytetarëve që jetojnë në Kosovë, atëherë çështja e shkathtësisë gjuhësore të një polici luan një rol mjaft me rëndësi gjatë

selektimit të tij. Polici serb i cili operon në një zonë të banuar kryesisht nga popullata shumicë shqiptare, p.sh, nuk do të ketë mundësi të flas në gjuhën e viktimës apo të dëshmitarit të gjetur në vendin e ngjarjes. Duke përfshirë këtu edhe trajnimet gjuhësore për rekrutë, si dhe duke vazhduar me atë lloj të trajnimit përgjatë tërë periudhës kohore të dedikuar për trajnim në terren e edhe mëtej, atëherë policët me përkatësi të ndryshme etnike do të kenë mundësi të fitojnë njohuri adekuate mbi gjuhën shqipe dhe atë serbe (e ndoshta edhe të gjuhës turke në ato rajone të banuara me popullatë turke shumicë) e cila gjë do të ju mundësonte atyre që të operojnë dhe ti kryejnë detyrat e tyre në mënyrë sa më efektive. Kur të jetë përpiluar politika gjuhësore në Kosovë, krijimi i një shërbimi policor të Kosovës me karakteristikë dy-gjuhësore-dhe trajnimi gjuhësor i nënpunësve të shërbimeve publike-duhet të ketë prioritet.

## **Edukimi**

63. Pas ndërprerjeve të vazhdueshme të punës përgjatë tërë muajve të dimrit, për shkak të furnizimit (pajisjeve) të çrregulluar me rrymë, shërbimet edukativo-arsimore filluan përsëri me punën e tyre rutinore në pranverën e hershme. Cikli i parë shkollor përfundoi verës me një shumicë absolute të fëmijëve Kosovar të cilët i kishin ndjekur mësimet e tyre nëpër shkolla. Shifrat e fëmijëve që vijnë nga rradhët e minoriteteve tregojnë për njëfarë disproporcionaliteti të këtyre fëmijëve që nuk i ndjekin mësimet e tyre nëpër shkolla me ata që i ndjekin ato rregullisht. Duke ecur përpara drejt një sfide shumë të rëndësishme e thjeshtë për ti bindur fëmijët që të kthehen nëpër shkolla, si dhe mbylljen e zbrastësirave të cilat ishin shkaktuar nga ndërprerjet e procesit mësimor për shumë nxënës sidomos gjatë fushatës ajrore bombarduese, UNMIK-u tani është duke u ballafaquar me sfida që si të them janë të natyrës më afatgjate. Përcaktimi i çështjeve të tilla siç janë gjuhët e udhëzimeve, tekstet shkollore dhe përmbajtjet e plan-programeve mësimore do të jenë faktorët kryesorë të cilët do të karakterizojnë kualitetin e procesit edukativo-arsimor që i ofrohet nga ana e UNMIK-ut fëmijëve dhe rinisë Kosovare. Kjo, përkundrazi do të ketë pasojë të shumta për sa i përket formimit të shoqërisë në të ardhmen.
64. Momentalisht fëmijët e të gjitha përkatësive të ndryshme etnike janë duke i përdorur tekstet shkollore që janë të ndryshme jo vetëm sa i përket gjuhës së përdorur në to por edhe për nga përmbajtja. U detyrua të bëhet një recenzion fillestar i më shumë se 300 librave nga Kosova, Serbia dhe bosnja an initial review of up to 300 available text books from kosovo, Serbia, bosnia dhe vendet e tjera për shkak të nevojës së parashtruar urgjente për furnizim me libra nëpër shkolla. Toleranca dhe respekti për kulturat e tjera ishte marrur parrasysh gjatë ushtrimit të recenzionit të këtyre librave përpos disa prej lëndëve mësimore siç është p.sh ajo e historisë e cila ndryshor si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga vëllimi varësisht prej prejardhjes së librit. Kishte edhe ankesa të tilla si p.sh se përmbajtja e disa librave shkollor ishte ofenduese për kulturën turke. Qëllimi afatgjatë për të përpiluar libra shkollor standard të pranueshëm për të gjithë sektorët e popullsisë, është një sfidë mjaft e madhe për të cilën nevojitet edhe kohë. Është e rëndësishme që të sigurohet se kjo detyrë e rëndësishme dhe mjaft sensitive është ndërmarrur duke pasur një përfshirje të plotë të përfaqësuesve të përshtatshëm të të gjitha grupeve etnike të cilët ishin duke punuar në një bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtar.
65. **Zhvillimi i plan-programeve mësimore** është një sfidë gjithashtu e rëndësishme dhe e cila duhet të ndërmerret në një mënyrë mjaft sensitive. Gjatë përcaktimit të **gjuhëve të udhëzimit** duhet të mirret parrasysh edhe fakti se veç janë marrur vendimet përkatëse për sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare në Kosovë. Sistemi edukativo-arsimor duhet të nxit (ushqejë) dhe promovojë konceptin e për një shoqëri shumë-gjuhësore. Pasi të jenë përcaktuar të ashtuquajturat gjuhë të udhëzimeve, duhet të mirren masa mbrojtëse të cilat do të mbrojnë një pjesën të plan-programit mësimor nëpërmjet të cilit sigurohet që gjuhëve më pak të përdorura tu jipet një vëmendje dhe rëndësi e veçantë. Është arritur një përparim i dukshëm për sa i përket inkorporimit të tëmës për të drejtat e njeriut e cila duhet të jetë temë me rëndësi gjatë përpilimit të plan-programeve mësimore. Kjo çështje është duke u rregulluar nëpër shumë shkolla të Kosovës dhe ka për qëllim që të koncentrohet jo vetëm në çështjen e të drejtave të njeriut e cila duhet të jetë e dedikuar për nxënës nëpër shkolla por edhe në metodat e udhëzimeve të cilat duhet të aplikohen nga ana e mësuesve dhe arsimtarëve.

66. Shikuar nga këndvështrimi praktik çështja e shfrytëzimit të objekteve shkollore mbetet si një çështje ende e pazgjidhur nëpër shumë vende. Ende ka mjaft për tu bërë për sa i përket zgjidhjes së problemit të shfrytëzimit të objekteve shkollore me zgjidhjen e së cilës do të sigurohet një shfrytëzim i barabartë i objekteve shkollore që i kemi në dispozicion. Koncepti i shqiptarëve të Kosovës të cilët janë kundër themelimit të shkollave të veçanta serbe është një koncept që ndan komunitetet në Kosovë dhe për këtë arsye duhet larguar nga ky koncept kurdo që është e mundshme. Një klasifikim i tillë prin që ti lërë grupet e tjera minoritare si çështje të klasës së dytë duke i lënë ata që vetë të përcaktojnë se cili është opcioni i cili më së miri i përshtatet nevojave të fëmijëve të tyre. Disa shkolla në Kosovë në mënyrë të pashmangshme do të jenë kryesisht apo ekskluzivisht do të jenë të ndjekura nga nxënësit shqiptarë derisa disa të tjera vetëm nga nxënës serbë për shkak të faktit se kemi një ndarje dhe shpërndarje të popullatës nëpër zona të ndryshme. Kjo megjithatë nuk duhet pranuar si normë në të gjitha vendet. Ka shumë vende ku popullata vazhdon të jetë e përzier apo së paku kemi komunitetet e ndryshme që jetojnë në afërsi të njëri tjetrit. Duhet të bëhen përpjekje të mëdha në mënyrë që të sigurohet që objektet shkollore të ndahen, në bazë të sistemit të turneve për të pasur mundësi që të strehojë rryma të ndryshme të nxënësve që dallojnë në mes veti për sa i përket gjuhës të cilën ato e flasin. Kufizimet në buxhet në departamentin e arsimit flasin për atë se numri i arsimtarëve duhet të përshtatet në proporcion me numrin e nxënësve nëpër disa lokacione përkatëse derisa hapësirat shkollorë duhet konsoliduar në mënyrë sa më të përshtatshme. Përderisa vendimet e tilla do të vazhdojnë të mirren në nivel të komunave do të jetë mjaft e rëndësishme që të sigurohet që shkollat që janë në shërbim të nxënësve që vijnë nga rradhët e minoriteteve të mos jenë ato që do të preken më së shumti (disproporcionalisht) nga marrja e këtyre vendimeve.
67. Një prej temave kryesore të shtjelluara gjatë debatit të mbajtur mbi arsimin ishte e fokusuar më shumë kah arsimi fillor duke e përjashtuar atë sekondar dhe atë superior. Qëndrueshmëria e komuniteteve minoritare në Kosovë në planin afatgjatë sigurisht se do të jetë e prekur nga mundësia e tyre për t'iu qasur arsimimit superior.
68. Brezi i ndikimit që çështjet e sigurisë e prekin nuk bën të parashihet. Është për të të ardhur keq fakti se disa prindër ende vazhdojnë ti mbajnë fëmijët e tyre të mbyllur nëpër shtëpi për shkaqe sigurie. Kjo veçanërisht vlen për fëmijët më përkatësi romë, ashkalike dhe ato egjiptase të cilët jetojnë nëpër lagje etnikisht të përziera. Përderisa në teori ata kanë qasje në disa shkolla vendore prapëprapë prindërit e tyre mbeten ende të brengosur për mundësinë e kërcënimit/frikësimit dhe keqtrajtimit të fëmijëve të tyre nga ana e nxënësve shqiptarë. Nëpërmjet të një shembulli OSBE-ja në pejë ka tentuar që ta adresojë këtë çështje nëpërmjet të përfshirjes së të gjitha palëve me rëndësi për këtë proces duke filluar prej arsimtarëve, prindërve, organeve edukativo-arsimore dhe forcave të sigurisë në një proces të kërkimit të një zgjidhjeje të përshtatshme për këtë problem. Një zgjidhje e përkohshme do të duhej të jetë ajo e sigurimit të përcjelljeve nga ana e forcave të sigurisë shkuarjen e fëmijëve në shkollë. Ky është një çmim i lartë që fëmijët duhet ta paguajnë në mënyrë që të kenë mundësi të arsimohen përderisa këto nevoja fatkeq mund t'i shërbejnë vetëm përforsimit të asaj që quhet ndarje edhe e mëtejme ndërmjet komuniteteve etnike.
69. Një shembull i përpjekjes për të vlerësuar nevojat arsimore të një komuniteti minoritar dhe sfidave të zbuluara si një pasojë, është ajo e bërë nga ana e OSBE-së në komunitetet e ashkalinjve dhe egjiptasëve në Ferizaj. OSBE-ja, me një përkrahje të akterëve të tjerë, mbajti një anketë mbi nevojat arsimore të të dyja komuniteteve, duke u fokusuar veçanërisht në atë çështje e cila edhe i pengon fëmijët për t'i ndjekur mësimet e tyre nëpër shkolla. U dhanë përgjegje mjaft të cekëta nga ana e pjesëtarëve të komunitetit rom. Ashkalinjtë, megjithatë, dhanë përgjegjet e tyre për sa i përket mbajtjes së anketës në fjalë dhe informatat e mbledhura nga ana e OSBE-së në lidhje me nevojat arsimore të fëmijëve të moshës për arsimim fillor zbuluan shifrat e paraqitura si mëposhtë: nga 398 fëmijë të intervistuar, 237 (60%) prej tyre nuk ishin dike i ndjekur mësimet nëpër shkolla, 133 (56%) prej të anketuarve ishin analfabet dhe ishin të gjinisë femërore si dhe 142 (60%) e kësaj kategorie ishin fëmijë të moshë prej 7 deri në 9 vjeç dhe kandidatë të mundshëm për t'i ndjekur mësimet në ciklin shkollor 2000-2001. Rezultatet e kësaj ankete shërbejnë për të theksuar (potencuar) llojin e përpjekjeve intenzive që duhet bërë me qëllim të adresimit të nevojave arsimore të komuniteteve arsimore. Si vazhdim i gjithë kësaj OSBE-ja kishte angazhuar përfaqësues të komuniteteve dhe organet edukativo-arsimore në mënyrë që të promovohet ndjekja e mësimëve nga këta fëmijë, sidomos të



atyre të moshës prej 7 deri në 9 vjeç. Më 23 shtator këshilli i mahallës së romëve/ashkalinjve deklaroi se 324 fëmijë të nacionalitetit ashkali janë duke i ndjekur mësimet e tyre nëpër shkolla fillore (prej klasës së parë deri në atë të tetën) në komunën e Ferizajit. Vetëm 8 fëmijë rom ndjekin mësimet e tyre nëpër shkolla fillore. Megjithatë, 56 prej 139 fëmijëve analfabet (40%) janë regjistruar me sukses për t'i ndjekur mësimet e tyre në vitin shkollor 2000-2001. Afro 35% të fëmijëve të nacionalitetit ashkali nuk patën mundësi që të regjistrohen.

### **Shërbimet shëndetësore**

70. Në raportin e pestë me rradhë të shkruar nga ana e UNHCR/OSBE-së mbi gjendjen e pakicave kombëtare në Kosovë, në periudhën kohore shkurt-maj 2000, ishte deklaruar se **“qasja ndaj shërbimeve përkatëse shëndetësore mbetet preokupim kryesor për popullatën pakicë”**. Gjatë muajve intervenues, fatkeqësisht pak ka ndryshuar në këtë drejtim. Ky problem prek në mënyrën më akute serbët e Kosovës, e në një masë më të vogël edhe komunitetin rom në disa rajone.
71. Shërbimet primare të kujdesit shëndetësor funksionojnë kryesisht nëpërmjet të një rrjete mjaft të gjerë të ambulantave (klinikave) në nivelin lokal. Në disa vende pa ndonjë vështirësi të dukshme pjesëtarët e minoriteteve të ndryshme kanë mundësi t'i qasen këtyre shërbimeve. Në disa vende të tjera është vërejtur një shkallë e ndryshueshme për sa i përket qasjes duke filluar prej pengesave për shkak të barrierave gjuhësore, e deri te nevoja për hapjen e ambulantave të ndara nëpër enklava ku jetojnë komunitetet minoritare. Serbët e Kosovës janë përfituesit kryesor të masave të marra në këtë drejtim kohëve të fundit. Ky opcion është një opcion që kushton, dhe çdokush që zgjat ndarjet e tilla mirëpo nën kushtet e sotme mund të themi se është një opcion mjaft praktik për sa i përket sigurimit të të drejtës në kujdes adekuat e të nevojshëm shëndetësor. Disa OJQ kanë ofruar deri më tani shërbime shëndetësore për pjesëtarët e minoriteteve nëpërmjet të shfrytëzimit të klinikave të tyre mobile. Këto shërbime janë mjaft esenciale të cilat nevojiten që të mirëmbahen për një kohë të caktuar derisa të jenë gjetur zgjidhje më afatgjate në kuadër të kornizave të kujdesit shëndetësor të siguruar dhe paraparë nga departamenti për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.
72. Vështirësi edhe më të mëdha paraqiten sidomos në aspektin e qasjes ndaj shërbimeve sekondare dhe atyre terciare shëndetësore. Brengosjet për shkaqe të sigurisë dukshëm zvogëlojnë apo kufizojnë qasjen e minoriteteve ndaj spitaleve. Ky është një problem me të cilën ballafaqohen komunitetet minoritare në shumicën e rajoneve ku ata jetojnë si edhe shqiptarët e Kosovës të cilët kanë probleme në aspektin e qasjes ndaj spitalit kryesor në Mitrovicë. Është një problem që tejkalon brezin e autorizimeve të departamentit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale për sa i përket zgjidhjes së saj. Incidentet e ndërlydhura me problemin e qasjes së shërbimeve shëndetësore nuk arrijnë atë më të keqën që kishte ndodhur në verën e kaluar kur pacientët të cilët vinin nga rradhët e minoriteteve thjeshtë zhdukeshin nga spitali i Prishtinës. Brengosjet për shkaqe sigurie kanë filluar të ndalen ngadalë mirëpo prapëseprapë nuk kemi një vullnet të mirë nga ana e minoriteteve madje edhe të tentojnë për të kërkuar kurimin e tyre nëpër spitalet qendrore. Kjo frikë manifestohet vetvetiu në mënyra të ndryshme; p.sh në Gjilan pacientët serbë vizitojnë spitalin rregullisht me qëllim të trajtimit të sëmundjes së dializës dhe prapëseprapë janë të frikësuar madje edhe nëse janë të shoqëruar nga forcat e sigurisë. Megjithatë ata janë të frikësuar që të pranohen në spital për nevoja të intervenimeve kirurgjike kundër sëmundjeve akute, duke preferuar më shumë që të mbështeten në shërbimet mjekësore në vetë Serbinë. Kjo përkundrazi kërkon një organizim të përcjelljeve/shoqërimeve me forca të sigurisë deri në kufi me qëllim që të kenë mundësi që ta lëshojnë Kosovën të sigurtë. Në Prizren janë bërë përpjekje të përbashkëta (bashkërenditura) me qëllim të mbajtjes së takimeve të rregullta të Zyrtarit Regjional për Shëndetësi të UNMIK-ut, KFOR-it dhe policisë së UNMIK-ut dhe personelit të ambulantave të cilën pacientët serbë e vizitojnë pikësepari. Në këtë mënyrë ishte e mundshme që të sigurojmë një qasje në spitalet qendrore në vend për pacientët minoritar që kanë nevojë për tu operuar apo nënshtruar një trajtimi mjekësor të cilën vetëm spitali mund ta sigurojë. Përpjekjet e tilla janë të për tu lavdëruar mirëpo ekziston ende fakti se disa pacientë në Prizren e gjetiu vazhdojnë të mbështeten në shërbimet që ua ofrojnë spitalet e KFOR-it dhe përkrahjen e OJQ-ve që të kenë mundësi për të udhëtuar deri te objektet shëndetësore.

73. Shpenzimet dhe degëzimet për sa i përket politikës së themelimit të shërbimeve të ndara të nivelit sekondar dhe atij terciar nuk janë inkurajuese mirëpo, sikurse që është rasti me shërbime të ambulantave, ekziston një nevojë e qartë për të siguruar shërbime të përshtatshme brendë përbrendë Kosovës të cilat përbushin nevojat e popullatës. Objekti shëndetësor në Graçanicë/Ulpianë momentalisht është i pajisur me pajisje përkatëse për gjinekologji dhe nevoja të tjera kirurgjike. Zhvillimi i shërbimeve të tilla zbulon një faktor shtesë dhe mjaft të komplikuar i cili pengon planet dhe prospektet që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor kuptimplotë në Kosovë, i gatshëm për t'iu përgjegjur nevojave të lindura të tërë popullatës; ku punëtorët shëndetësor serbë nuk janë plotësisht të integruar brenda suazave të sistemit shëndetësor të udhëhequr nga UNMIK-u. Përderisa ata ende vazhdojnë të furnizohen me barna dhe pajisje medicinale nga shërbimet ndihmëse të UNMIK-ut në anën tjetër ata ende vazhdojnë t'i pranojnë pagat e tyre nga autoritetet qendrore në Beograd. Kjo paraqet një vështirësi të dukshme për sa i përket menagjimit të plotë të sistemit shëndetësor.

### **Ndihma humanitare /ndihma sociale**

74. Më parë, nevojat humanitare të përmasave të gjerë ishin përbushur nëpërmjet të distribuimit masiv të ndihmës humanitare (ushqim, batanije, dyshekë, dru për ndezje, dhe strehim emergjent, etj...) të cilat janë nën mbikëqyrjen/kujdesin e shtyllës I, elementit për çështje humanitare në kuadër të strukturave të UNMIK-ut. Duke i ndarë nëpër faza kryerjen e aktiviteteve të tilla me kalimin e kohës dhe me eliminimin e shtyllës I që prej 1 korrikut 2000, është vërejtur një lëvizje e rritur drejt përbushjes së nevojave humanitare nëpërmjet të formimit të mekanizmave afatgjatë për ndihmë sociale. Kalimi prej një ndihme humanitare të përmasave të gjera në një ndihmë sociale me dedikim më të shënjestruar si të themi, është një proces i cili është në zhvillim e sipër. Është mjaft e rëndësishme që të monitorohet përparimi i arritur me qëllim që të sigurohet që nevojat e veçanta të komuniteteve minoritare u jipet një konsideratë e veçantë.

75. Projekti për ndihmë sociale i cili funksionon në kuadër të mekanizmave të departamentit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale dhe është e implementuar në nivel lokal nga qendra për punë sociale është pasardhëse e projektit për ndihmë emergjente financiare. Ky projekt funksionoi prej Nëntorit 1999 deri në Prill 2000. Qëllimi themelor i një projekti të ri për ndihmë sociale është që të sigurohet një përkrahje financiare dhe me ushqim sidomos pjesëtarëve që janë më të prekurit në këtë aspekt të tërë shoqërisë. Përfituesit janë të klasifikuar mënyrë përkatëse për sa i përket prekshmërisë së tyre në këtë aspekt-kategoria I; konsiderohen ata që janë të paaftë për të punuar siç janë personat e moshuar dhe ata të paaftë; dhe kategoria II: janë ata që janë të aftë për të punuar mirëpo momentalisht janë të papunë. Kategoria I e përfituesve pranojnë një kombinim të pagesave me të holla dhe ndihmës ushqimore përderisa kategoria e II do të pranojnë vetëm pagesa me të holla. Zotësia për të punuar përcaktohet në bazë të një vlerësimi të bërë ndaj tërë anëtarëve të familjes që jetojnë së bashku në të njëjtin vendbanim.

76. Pagesat e deikuara për kategorinë e i-rë të përfituesve filloi të bëhet prej gushtit 2000 dhe ky numër i pëersonave të tillë arrin shifrën deri në 37,000 prej tyre. Për shkaqe të sigurisë dhe mbrojtjes së shënimeve dshms vendosi që të mos i regjistrojë vetëm përfituesit që vijnë nga rradhët e minoriteteve ndaras prej atyre të tjerë andaj është vështirë që të thuhet në këtë moment se sa prej këtyre personave janë nga ana e minoriteteve të ndryshme. Megjithatë, u bënë përpjekje të përbashkëta gjatë procesit të aplikimit për këtë kategori të përfituesve me qëllim të sigurimit që komunitetet minoritare të kenë qasje ndaj informatave për sa i përket mbarëvajtjes dhe përmbajtjes së këtij projekti, të cilët arritën që ti tejkalojnë vështirësitë e lindura për shkak të lirisë së kufizuar të lëvizjes në mënyrë që të kenë mundësi të aplikojnë për këtë privilegje. Ekziston një proces shqyrtues i cili është në zhvillim e sipër i cili ka për detyrë që të vërtetojë identitetin e përfituesve në mënyrë që t'i përjashtojë të gjitha pohimet mashtruese dhe të pabaza. Vërtetimi i vlefshmërisë së pohimeve të dhëna nga ana e përfituesve që vijnë nga rradhët e përfituesve është një proces mjaft i komplikuar për shkak të faktit se personeli i CSW-së është kryesisht i përbërë nga shqiptarët dhe për shkak se ky staf nuk ka mundësi apo/ose nuk kanë vullnet të mirë që të vizitojnë rajonet të cilat janë të banuara me pjesëtarë të komuniteteve të minoriteteve.

77. Për shkak të mungesës së burimeve në kuadër të CSW-së prapsepapë ekzistonte një mbështetje në shërbimet për qasje ndaj publikut të OJQ-ve të ndryshme në mënyrë që të sigurohet që përfituesit e mundshëm që vijnë nga rradhët e minoriteteve të kenë mundësi ti pranojnë dhe mbushin formularët për aplikim e pas kësaj t'i dorëzojnë ato CSW –së për vlerësim. Sidoqoftë disa prej komuniteteve minoritare përjashtuan vetë vetveten nga ky projekt si rezultat i qasjes krejt-ose-asgjë që e kishin në atë moment liderët e këtyre komuniteteve. Këta hodhën poshtë mënyrën se si bëhej testimi në këtë drejtim dhe vendosën që të bojkotojnë projektin në fjalë nëse të gjithë pjesëtarët e komuniteteve të tyre nuk përfshihen automatikisht në këtë projekt. CSW-ja me një përkrahje mjaft aktive nga ana e OJQ-ve, ishin munduar që të tejkalojnë këtë problem duke shkuar tek të gjithë aplikantët e mundshëm të cilët përndryshe do të kishin mundur të jenë të penguar për të bërë një gjë të tillë për shkak të presioneve të bëra nga ana e komuniteteve të cilave ata u takojnë. Ky ishte një veprim mjaft delikat për shkak se printe që të mos rrezikojë sigurinë e individëve në fjalë. Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kishte shprehur një kënaqësi për faktin se procesi i aplikimit kishte qenë i drejtë aq sa ishte e mundshme të bëhej një gjë e tillë nën kushtet dhe raportoi se numri i fshatrave të banuara nga pjesëtarët e minoriteteve kryesisht ato të banuara me serbë të Kosovës të cilët janë duke bojkotuar projektin janë vetëm disa sosh.
78. Përfituesit minoritar të kategorisë së I-rë ende ballafaqohen me vështirësi praktike: për shkak se pagesat e gatshme me të holla bëhen nëpërmjet të autoritetit bankar dhe të pagesave edhe pse degët e abp-së ndodhen gati në çdo komunë prapsepapë këto nuk janë të qasshme për disa pjesëtarë të nacionalitetit serb dhe atij rom, të cilët nuk kanë mundësi që të udhëtojnë edhe aq lehtë. Si alternativë përfituesit minoritar mund t'i pranojnë pagesat e tyre nëpërmjet të zyreve në administratën komunale e në disa raste pagesat bëhen edhe drejtëpërdrejtë personave në fjalë nga ana e stafit të UNMIK-ut.
79. Kriteri i zotësisë për kategorinë e II-të të përfituesve sapo është finalizuar dhe pritet që procesi i aplikimit nuk do të fillojë para nëntorit. Kategoria II është mjaft e rëndësishme për komunitetet minoritare, dhe një grusht i rëndë nga shkalla e lartë e papunësisë me të cilën ballafaqohen të gjithë Kosovarët. Disa prej çështjeve me rëndësi të cilat e përcaktojnë të ashtuquajturën zotësi për punë kanë të bëjnë me gjendjen e minoriteteve. Disa prej minoriteteve, e më së shumti serbët dhe romët, ballafaqohen me një pengesë e cila i pengon ata për të pasur vullnet për të punuar mirëpo të paaftë që ta gjenë atë për shkak se disa prej kufizimeve mjaft serioze të lirisë së lëvizjes së tyre kufizojnë lëvizshmërinë së tyre në disa prej zonave të kufizuara gjeografike ku ata nuk kanë rast që të gjejnë ndonjë punë e cila u ofrohet atyre. Grupet minoritare gjithashtu ballafaqohen me pengesa për sa i përket barrierave gjuhësore dhe diskriminimit të përgjithshëm që i pengon ata të konkurojnë në mënyrë të barabartë për vende të punës në tregun e punës. Procedura për përcaktimin e zotësisë për punë kërkon që ata persona të cilët janë të aftë për punë duhet të regjistrohen dhe për këtë të marrin një certifikatë nga zyra për punësim të cilat vërtetojnë se ai/ajo është e aftë dhe kërkon punë (një deklaratë e vulosur nga UNMIK-u mund të jetë një mundësi/alternativë e pranueshme). Për shkak se zyret për punësim nuk janë themeluar ende nëpër disa komuna përkatëse e edhe në ato ku janë themeluar, qasshmëria e tyre ndaj minoriteteve me liri të kufizuar të lëvizjes mbetet mbetet një çështje që kërkon zgjidhje. Ekziston një barrë e rëndë që bie në këto zyre ashtu që ato të sigurojnë një shërbim për qasjen ndaj minoriteteve që janë të mbyllur nëpër shtëpitë e tyre. Kriteret e përjashtimit siç është edhe pronësia e më shumë se gjysmë hektari të tokës janë formuluar me përpikëri që shkon në dobi të minoriteteve në zonat rurale pasi që ky përjashtim është bie në ujë nëse kësaj parcele të tokës nuk mund ti qasemi për shkak të minave tokësore (një problem me të cilën është duke u ballafaquar e tërë popullata e disa rajoneve përkatëse) ose për shkak të brengave të cilat janë si rezultat i gjendjes së sigurisë (një problem i cili është duke ndikuar më shumë në ato pjesëtarë të minoriteteve të cilët kishin qenë të sulmuar derisa ishin duke e punuar tokën ose toka e të cilëve ishte uzurpuar nga të tjerët. Në të dyja rastet duhet prezentuar dokumentacioni përkatës nga ana e personit i cili pohon për pamundësi të qasjes në tokën e tij. Mbetet e paqartë se si pritet nga një pjesëtar i minoriteteve që të vërtetojë faktin se ai ka frikë dhe është në rrezik në të cilin rrezik edhe çdo gjë është e bazuar këtu. Një kriter shtojcë i përjashtimit me të cilin theksohet se një familje e tillë e cila aplikon për një të drejtë të tillë mund të shkojë në dëm të aplikantit që vjen nga rradhët e minoriteteve i cili mund të jetë pronar i automjetit të motorizuar mirëpo që do të jetë në pamundësi që ta shfrytëzojë atë për shkaqe sigurie.

80. Është shtuar brenga gjithashtu për sa i përket vonesave kohore në implementimin e projektit për ndihmë sociale për kategorinë II të personave. Këto përfitime të tilla nuk janë të natyrës së pagesave me të holla dhe si të këtilla do të vazhdojnë që të jipen deri në fund të vjeshtës apo fillim të dimrit, ku këta përfitues që vijnë nga rradhët e minoriteteve nuk do të kenë mundësi që të shkojnë nëpër tregje me kohë në mënyrë që të furnizohen me të mira ta mjaftueshme e cila do të ju mundësojë atyre që ta kalojnë dimrin disi. Kjo brengë është e lidhur ngushtë me një çështje më të gjerë që është ndihma me ushqim e cila u jepet vetëm atyre pjesëtarëve të minoriteteve, që nuk janë pjesë e projektit për ndihmë sociale. Sasia e ndihmës ushqimore e cila ka qenë e dhënë nën përkujdesin e programit botëror për ushqim është reduktuar mjaft e cila shkon deri në një ndihmë të tërësishme të dhënë më pak. Përfitimet në fjalë ishin zvogëluar deri në 35% në secilën komunë në korrik të këtij viti, përderisa pritej që prodhimet e të lashtave sivjet të mbulonin të gjitha nevojat në një masë të mjaftueshme. Në rastin e minoriteteve, për shkak të problemeve të cilat i cekëm mëparë, u ndërmorr një mision i përbashkët i WFP/FAO/UNHCR i vlerësimit në shtator të vitit 2000 me qëllim të sigurimit të bazave reale për përcaktimin e prioriteteve që kanë të bëjnë me sasinë e ndihmës ushqimore që u dedikohet minoriteteve. Është e qartë se duhet rritur sasinë e ndihmës ushqimore që duhet shpërndarë vetëm nëse paraqitet nevoja për një gjë të tillë dhe për shkak se nuk ka nevojë që tu sigurohen batanije të gjithë personave të komuniteteve minoritare. Megjithatë mbetet si sfidë fakti se duhet marrur parrasysht të gjitha nevojat e komuniteteve minoritare gjatë marrjes së vendimeve të ndryshme që kanë të bëjnë me politikën e dhënies së ndihmave. UNHCR vazhdon të financojë edhe mëtej programin e ndihmave me ushqim të freskët dhe ushqim shtesë të dedikuar për pjesëtarët e minoriteteve që jetojnë nëpër zonat urbane. Këtu paraqiten probleme mjaft akute gjatë qasjes tregjeve dhe nuk gëzojnë të mirat të cilët bashkëkombasit e tyre që jetojnë nëpër zonat rurale i gëzojnë të cilët së paku kanë pasur mundësi të mbjellin dhe të mbledhin prodhimet e perimeve të freskëta nga parcelat e tokës të mjellura me këto zarzavate, edhe pse ata nuk kanë qasje të plotë në tokat e tyre.
81. Është paraqitur një brengë tejet e madhe për sa i përket kufizimeve në buxhetin e projektit për ndihmë sociale. Janë përcaktuar edhe tarifa e pagesave që është një sasi modeste e të hollave për shkak të kufizimeve buxhetore dhe me qëllim të mbajtjes së një koherence me nivelin e pagave të UNMIK-ut. Planifikimi i projektit ishte bërë në bazë të vlerësimeve për numrin e popullatës i cili është shtuar për shkak të ardhjes në vend të një numri të madh të personave të kthyer. Këto gjëra mjaft me rëndësi nuk ishin marrur parrasysht gjatë fazës së planifikimit. Pagesat momentale që iu bëhen deri më 37,000 personave, anëtarë të familjeve të ndryshme ndryshojnë në krahasim me shifrat e planifikuara në fillim e që ishin 20,000. Me një maksimum të kapacitetit buxhetor me qëllim të përgjegjes së nevojave të 50,000 deri në 60,000 anëtarëve të familjeve të ndryshme në përgjithësi, një shkallë e papritur e madhe e përfituesve nga kategoria I mund të shkaktojë komplikime serioze për përfituesit e mindshëm të kategorisë II; një kategori të cilës i ishin bashkangjitur shumë anëtarë të familjeve të minoriteteve. Si përfitues të kategorisë I ata gjithmonë do të kenë precedent ndaj kategorisë II, ku UNMIK-u kishte dëftuar në faktin se ata duhet të jenë më të kufizuar kur është fjala për kriterin e shfrytëzimit të kësaj të drejte për përfituesit e kategorisë II me qëllim që të vihet deri të një balancim i buxhetit, duke e pasur parrasysht faktin se ekziston një numër i madh i përfituesve të kategorisë I. Kjo mund ta lërë popullatën e minoriteteve në kushte mjaft të vështira pa ndonjë përkrahje adekuate, duke bërë presion të mëtutjeshëm në ta me qëllim që ta lëshojnë provincën. Implikimet përkatëse për shkak të qëndrueshmërisë së vazhdueshme të pjesëtarëve të minoriteteve në vend duhet të mirëseardhen dhe të mirren parrasysht nga ana e UNMIK-ut, shtetet donatorë dhe bashkësia ndërkombëtare në tërësi. Destabilizimi i mëtejshëm i komuniteteve minoritare dhe ajo që mund të jetë si skenari më i keq i lëshimit të mëtejshëm të vendit për shkak të qasjes jo-adekuate ndaj një ndihme themelore që u jipet atyre ka gjasa të mëdha që ky problem të bëhet një problem humanitar me implikime mjaft serioze. Ekziston një barrë e cila bie mbi komunitetin ndërkombëtar me qëllim të veprimit në atë drejtim i cili do të parandalonte këtë mundësi.
82. Pas ndihmës sociale e cila jipet nga ana e UNMIK-ut dhe ndihmës humanitare e cila edhe sot e kësaj dite jipet nga ana e UNHCR-së, pjesa tjetër e ndihmës humanitare jipet nga ana e OJQ-ve. Këtu ne i referohemi iniciativave të shkallës së ultë dhe të lokalizuara për distribuimin e burimeve përkatëse që janë siguruar nga ana e donatorëve të ndryshëm. Shembujt e tillë të këtyre iniciativave përfshijnë donacionet e dhëna herë pas here në formë të rrobave, mbathjeve, lojërave të fëmijëve, etj. Në vazhdim disa organizata

ndërkombëtare dhe OJQ të tjera kanë siguruar fonde për përkrahjen e projekteve vendore të cilat për qëllim kryesor kanë në dhënien e ndihmës për stabilizimin e gjendjes në të cilën jeton popullata pakicë (shembujt e tillë përfshijnë edhe fondet bprn të kanalizuar nëpërmjet të UNICEF-it , OJQ-ve të tjera si dhe fondeve të iniciativës së grave të Kosovës të kanalizuar nëpërmjet të UNHCR-së dhe të dedikuar për ndihmë popullatës shumicë si dhe asaj pakicë). Hapat e tilla janë më se të nevojshëm për parandalimin e rrezikut të shëndrimit të popullatës pakicë në pranues pasiv të ndihmës, që në planin afatgjatë shërben për mbajtjen e një status quo jo të shëndoshë dhe të përforcojnë përjashtimin e tyre prej rrjedhave të shoqërisë. Në planin afatmesëm dhe atë afatgjatë ekziston nevoja që në mënyra graduale të largohemi prej dhënies së ndihmave humanitare dhe të përqëndrohemi më shumë kah zhvillimi i iniciativave të qëndrueshme.

## **Shërbimet komunale**

83. Në raportet paraprake ishin shtuar brengat rreth faktit se popullata pakicë është duke e bartur mbi vete tërë barrën e çkyqjes së furnizimit me energji elektrike, errësimit të qytetit për shkak të mungesës së rrymës, dhe çkyqjes së telefonave. Punonjësit që punonin në terren pranonin mjaft shpesh ankesa të ndryshme për sa i përket kësaj dukurie mirëpo shpeshherë ishte mjaft vështirë që të gjindet shkaku i vërtetë i problemit. Përderisa shumë pjesëtarë të komuniteteve minoritare besonin se ishin duke u sulmuar me qëllim, shpeshherë ato ballafaqoheshin me vështirësitë që paraqiteshin si rrjedhojë e furnizimeve jo të rregullta me të mira e cila kishte ndikim në tërë popullatën. Sidoqoftë në shumicën e rasteve kjo përbëhej nga aktet e qëllimshme të sabotimit të cilat akte rezultonin me çkyqje të përkohshme të shërbimeve të ndryshme. Gjatë verës sigurimi i këtyre shërbimeve themelore ishte përmirësuar në masë mjaft të madhe dhe tani debatimet përqëndroheshin më shumë në një çështje më esenciale siç është pagesa e shërbimeve të pranuar.
84. Një projekt special për përjashtim të përkohshëm nga pagesa e llogarive të rrymës elektrike dhe ujit ishte bërë me dije nga ana e shtyllës IV (BE/rindërtimi ekonomik dhe zhvillimi) si përgjegje ndaj brengave të dalura si rrjedhojë e faktit se shumica e popullsisë si konsumuesit që vijnë nga rradhët e popullatës shumicë si ata që vijnë nga pakicat nuk do të jetë në gjendje që ti paguajë llogaritë e tyre. Ky projekt i përjashtimit mbulonte periudhën kohore prej tetorit 1999 deri në mars 2000, me një afat të fundit për të dorëzuar aplikimet e tyre të përcaktuar më 1 qeshor. Formularët e aplikimit ishin lëshuar në qarkullim si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë serbe. CSW-ja ishte e përfshirë poashtu në procesin e përkrahjes së këtij projekti përderisa formularët për aplikim mund të merreshin nëpër qendra të ndryshme përkatëse ku pastaj duhej të kthehej në zyret e departamentit për shërbime komunale për ti rishqyrtuar ato dhe për të bërë përcaktimin e fundit se kush do të fitojë atë të drejtë apo jo. Kishte një mbështetje të fuqishme në OJQ-të e ndryshme opër shkak të përkrahjes së dhënë në aspektin e arritjes deri të aplikantët minoritar, sidomos serbët e Kosovës dhe romët të cilët nuk kishin liri të mjaftueshme të lëvizjes dhe ishin në pamundësi për të shkuar në zyret e CSW-së. Në fund të qeshorit, departamenti në fjalë, bëri me dije për 50,000 aplikacione ishin kthyer për tu rishqyrtuar përsëri. Siç u jipej më shumë rëndësi aplikacioneve për ndihmë sociale, ku aplikacioneve për persona minoritar nuk u jipej edhe aq shumë rëndësi. Sidoqoftë shënimet e rezultateve që vijnë nga terreni vëjnë në pah faktin se komunitetet minoritare kishin qasje në projektin (edhe pse jo në masën në të cilën shqiptarët e kishin) dhe se disa pjesëtarë të ndryshëm të minoriteteve kishin aplikuar për këtë të drejtë. Në kohën kur është përpiluar ky raport nuk ishte i ditur numri i aplikacioneve të vlersuara si të persona që kanë të drejtë ti qasen këtyre shërbimeve, përderisa aplikantët minoritar (si dhe ata shqiptarë) janë ende duke pritur për një njoftim formal për sa i përket çështjes se a u është pranuar atyre kërkesa për ndonjë lehtësim në aspektin e pagesave të llogarive të papaguara. Një gjë është e qartë këtu, se departamenti i shërbimeve komunale nuk do të përsëris projektin në fjalë dhe llogaritë e mbledhura prej prillit 2000 do të duhet të paguhen deri në llogarinë e fundit. Siç jemi duke hyrë në një dimër të ashpër, pamundësia për ti paguar këto llogari do të jetë një problem i cili do të paraqitet përsëri. Kjo do të paraqet problem veçanërisht për popullatën pakicë për shkak të kufizimeve në lirinë e tyre të lëvizjes, e cila do ti pengojë ata që të gjejnë punë, ose në rast se kanë të ardhura që i kanë në dispozicion, do ti pengojë ato që të shkojnë sigurtë ke ato zyre ku bëhen pagesat me qëllim të shlyerjes së borjeve të grumbulluara për shkak të llogarive të papaguara. Përderisa të jetë e qartë se realiteti ekonomik dhe kufizimet në buxhet

penjojnë departamentin për shërbime komunale prej mirëmbajtjes së subvencioneve të hapura, duhet gjithashtu të jetë e qartë se ato duhet të mbajnë përgjegjësinë e asaj që paraqet sigurimin e trajtimit të barabartë të të gjithë konsumuesve minoritar. Ende nevojitet për tu bërë shumë punë me qëllim që të sigurohet që llogaritë janë të kalkuluara në bazë të konsumimit aktual dhe që të shtypen dhe të lëshohen në qarkullim në gjuhën e cila do të jetë e kuptueshme për konsumuesin<sup>10</sup> dhe që sistemet fleksibile të pagesave janë të pajisura asisoi që lejojnë konsumuesit minoritar që të paguajnë llogaritë e tyre. Ky mekanizëm duhet të fillojë të funksionojë në praktikë para se të fillohet me çkyqjen e këtyre shërbimeve përkatëse.

85. Qasja e besueshme ndaj shërbimeve telefonike ka një ndikim të veçantë në sigurinë dhe mirëqenien e popullatës pakicë në Kosovë, veçanërisht në ata të cilët jetojnë nëpër zona të izoluar apo enklava të ndryshme. Përsëri kufizimet në buxhet parashohin situatën që shkon në dëm të nocionit të qasjes pa të holla në shërbimet telefonike. Sidoqoftë, duke u ballafaquar me gjasat për çkyqje të tyre nga rrjeti telefonik për shkak të pamundësisë për paguar, ku mundësia tjetër e sigurimit të popullatës me kabina telefonike publike është një alternativë e cila meriton për tu marrur në konsideratë në mënyrë serioze dhe sa më shpejtë që është e mundur. Veçanërisht komunitetet që janë të prekur nga gjendja e sigurisë kanë nevojë për të pasur mjete për të komunikuar me shërbimet emergjente dhe ato të sigurisë. Një sistem i tillë poashtu do ti sigurojë ata persona të cilët jetojnë nëpër enklavat e caktuara që të pajisen me mjete për komunikim me familjet e tyre që gjenden larg tyre. Është shumë me rëndësi që njerëzit të kenë mundësi që të mbajnë kontaktet e kësaj natyre në mes veti nëse nëse ndjenja e tyre e izolimit dhe lënies pas dore (braktisjes) nuk dëshirojmë që ajo të bëhet akute.

## **Punësimi**

86. Një prej çështjeve kryesore këtu e cila mund të sigurojë një qëndrueshmëri afatgjatë të komuniteteve minoritare në Kosovë është mundësia e tyre për tu punësuar. Shkalla e lartë e papunësisë mbetet një problem problem jetik për të gjitha komunitetet anembanë Kosovës, mirëpo i cili problem në veçanti i prek më së shumti minoritetet, e cila shkallë e paunësisë në mesin e serbëve të vitisë për shembull është vlerësuar të jetë diku rreth 99%. Komunitetet minoritare shpeshherë janë në pamundësi që të kthehen nëpër vendet e vjetra të punës për arsye të sigurisë, veçanërisht kur ata nuk kanë liri të mjaftueshme të lëvizjes, apo nuk kanë fare, duke shtuar këtu edhe vështirësinë me të cilën ata ballafaqohen gjatë përpjekjeve që të punësohen diku tjetër për shkak të diskriminimit, duke përfshirë këtu edhe diskriminimin që u bëhet nga ana e autoriteteve publikebut. Për komunitetin rom, ashkali dhe atë egjiptas, mungesa e arsimimit shpeshherë paraqet edhe një problem esencial e cila thuhet i minimizon gjasat e tyre për të gjetur punë. Andaj, përpilimi i një politike gjithëpërfshirëse Kosovare mbi punësimin nga ana e UNMIK-ut paraqet një çështje esenciale. Si pjesë e kësaj politike UNMIK-u duhet të sigurojë që ligjet ekzistuese për punësim të zbatohen në rradhë të parë, dhe që një ligj gjithëpërfshirës mbi punësimin të hyjë në fuqi sa më shpejt. Është veçanërisht mjaft me rëndësi që të sigurohet që të gjitha autoritetet të japin një shembull të mirë duke mundësuar një punësim të barabartë nga të gjithë nëpër organet publike.
87. Ka raste që vijnë nga terreni ku për çështjet e sigurisë atje kujdeset KFOR-i, duke iu mundësuar minoriteteve një siguri gjatë shkuarjes në punë. Në Gnjilane/Gjilan, për shembull, serbët e Kosovës janë ri-punësuar nëpër vendet e tyre të punës në guroret e moravës dhe paralovës si një rezultat i një politike të qëndrueshme që ka të bëjë me rekrutimin e minoriteteve dhe sigurimit të tyre. Shënimet e fundit deri te të cilat ka ardhur OSBE-ja tregojnë se 60 serbë punojnë nëpër këto gurore, dhe se ata gjithashtu përcillen gjatë shkuarjes në punë dhe kthyerjes nga puna nga ana e KFOR-it.
88. Ishin shënuar edhe shembuj të ndryshëm të cilët ilustrojnë për nevojën e përpilimit të një politike të qartë në lidhje me punësimin e cila mundëson punësim nëpër organet publike sidomos në Prizren. Gjatë vitit 1999, shumë turq, sllavo-musliman dhe romë ishin pushuar nga puna në mënyrë jo-ligjore. Në të njëjtën kohë shumë shqiptarë të Kosovës

<sup>10</sup> Përveç asaj se ekzistonte një rezistim i konsiderueshëm nga ana e KEK-ut (furnizuesit me energji elektrike) llogaritë në të tre gjuhët ishin lëshuar në qarkullim që prej Shtatorit. Mbetet të shihet se sa në mënyrë efektive ishin shpërndarë këto fletëllogari nëpër terren dhe shumë pjesëtarë të minoriteteve vazhdojnë që të ankohen se ata nuk pranojnë kurrfarë llogarish fare apo pranojnë llogari me një çmim të cilin ata besojnë se ata nuk kanë mundur që ta konsumojnë.

ishin punësuar me një trend jo të rregullt nga drejtorë dhe administratorë të vetë emëruar. Që nga ajo kohë, shumë pak raste të pushimit jo-ligjor nga puna ishin rikompensuar, edhe pse ishin sjellur në qendër të vëmendjes së UNMIK-ut dhe gjyqeve. Gjyqtarët pohojnë se nuk dinë se si të veprojnë me rastet e këtilla. Kjo mungesë e rikompensimit i ka demoralizuar edhe për më shumë pjesëtarët e komuniteteve minoritare, duke bërë edhe mëtej presion në ta me qëllim të lëshimit të vendit dhe duke qenë një lloj pengese për çfarëdo lloj të kthimit. Personat e zhvendosur janë të vetëdijshëm për faktin se do të jetë shumë vështirë për ta që të rikthehen në vendet e vjetra të punës. Sidoqoftë, një gjë është e qartë se në vend se të kenë përkrahje me qëllim të riintegrit të tyre në shoqëri, disa prej personave të zhvendosur të cilët ishin kthyer nëpër vatrat e tyre ishin diskriminuar mëparë nëpër vendet ku qëndronin për shkak se e kishin lëshuar vendin. Për shembull një slavo-musliman i cili e kishte lëshuar Prizrenin dhe kishte shkuar në Mal të Zi në qeshor 1999 pasi që ishte kërcënuar dhe rrahur nga pjesëtarët e UÇK-së përderisa po punonte në spital nuk kishte pasur mundësi kuurë të kthehet në vendin e tij të punës edhe pse kurrë nuk kishte qenë i pushuar zyrtarisht nga puna. Problemet e këtij lloji ishin përcjellur nga afër dhe regjistruar nga ana e shërbimeve siç janë projekti mbi të drejtat qytetare i financuar nga UNHCR-ja, dhe implementuar nga ana e këshillit norvegjez për refugjatë. Ishte arritur paksa një sukses i caktuar në zgjidhjen e rasteve individuale mirëpo problemi mund të zgjidhet vetëm në bazë të një politike të qartë dhe jodiskriminuese të punësimit.

89. **Pushimet joligjore nga puna në organet publike** kanë vazhduar, edhe pse në një numër më të vogël se në vitin 1999, ku këto pushime nga puna kishin ndikuar në mënyrë shpërpjestimore në pjesëtarët e minoriteteve. Për shembull, më 31 maj 2000, 12 të punësuar të SDK/SHKSH, ku 4 prej tyre ishin turq dhe 1 serbë, ishin informuar se nuk kanë mundësi që të punojnë më për abp-në, një organ i cili e kishte zëvendësuar sdk/shksh. Drejtori i filialës së abp-së në Prizren i deklaroi UNMIK-ut se abp-ja nuk është një pasardhëse e sdk/shksh dhe për këtë arsye nuk ka obligim ndaj punëtorëve të këtij ish organi.
90. Shumë pjesëtarë të komuniteteve minoritare (si dhe shqiptarët e Kosovës gjithashtu ishin ankuar se kjo mungesë e respektit për procedurat e formuluar në mënyrë ligjore nuk ishte manifestuar vetëm nëpërmjet të pushimeve joligjore nga puna por edhe nëpërmjet të praktikave të marrjes në punë të njerëzve në mënyrë jo të rregulltë, gradimeve dhe caktimeve nëpër detyra në kuadër të institucioneve publike. Për shembull, kur më shumë persona kishin konkuruar për 12 pozita në entin regjional për punësim të Prizrenit, 4 të punësuar të cilët kishin qenë të punësuar në atë ent për një kohë të gjatë, prej të cilëve dy prej tyre ishin turq, kishin konkuruar për ato vende të punës mirëpo nuk ishin ftuar në intervistë. 4 ish punëtorë të këtij institucioni kishin ngritur padinë kundër departamentit të punës dhe punësimit. Pjesëtarët e minoriteteve vazhduan të ankohen se kur shërbimet publike siç janë shërbimet postale ishin duke u riaktivizuar në mënyrë graduale, këta persona nuk ishin thirrur që të kthehen nëpër ish vendet e tyre të punës. Kjo përvojë si dhe ato të ngjashme demonstrojnë se garat publike për punësim janë shumë të rëndësishme me qëllim që të garantohet një jo-diskriminim dhe vetëm atëherë kur organizohen në mënyrë transparente dhe ku një peshë e rëndësishme i jepet edhe arsimimit dhe përgatitjes së lartë profesionale. Transparenca nuk është një gjë me rëndësi kryesore në garantimin e një korrektesie gjatë procesit të selektimit të kandidatëve, mirëpo gjithashtu kërkohet edhe një perceptim (kuptim) i të ashtuquajturës korrektesie. Momentalisht, minoritetet kanë arsye që të besojnë se ata nuk janë duke garantuar në të njëjtin nivel me akterët e tjerë në fushë të lojës.
91. Janë duke u bërë diskutime rreth miratimit të masave të përkohshme speciale me qëllim të nxitjes së trajnimit dhe mundësive për punësim nga ana e minoriteteve, sidomos ata të komunitetit rom, të cilët janë ata që më së shumti janë të lënë pas dore në këtë fushë. Këto masa duhet të përfshijnë edhe rezervimin e kvotave për aplikantët minoritar dhe duke siguruar marrëveshje fleksibile të punës dhe të sigurisë të cilat do ti inkurajonin pakicat që të aplikojnë si dhe që të vazhdojnë të punësohen nëpër organe publike. Ka raste që vijnë nga terreni ku masat e tilla janë zbatuar në praktikë, edhe pse me një trend ad hoc. Në Gnjilane/Gjilan, për shembull, administrata komunale kishte rezervuar një kvotë prej 20% të vendeve të punës për serbë të Kosovës në po të njëjtën administratë. Megjithatë, administratori komunal kishte deklaruar se kishte qenë një punë mjaft e vështirë për të gjetur një numër të mjaftueshëm të serbëve të Kosovës që do të aplikonin nëpër këto vende të punës, për shkak se shumë individë të kualifikuar nëpër profile të

ndryshme e kishin lëshuar provincën. Një problem i njëjtë ishte identifikuar edhe nëpër komunat e tjera. Trupat mbrojtëse të Kosovës kanë rezervuar një kvotë prej 10% për pjesëtarët e minoriteteve (diku rreth 500 vende në kuadër të tmk-së ku gjer më tani 106 prej tyre janë mbushur). Gjithashtu është duke u paraqitur nevoja për hartimin e një politike gjithë-Kosovare për sa i përket këtyre çështjeve. Nëse këto barrierat të cilat pengojnë minoritetet që të kenë mundësi të punësohen mund të mënjanohej disi nëpërmjet të marrjes së masave speciale, atëherë ekzistojnë gjasa për përmirësimin e gjendjes rreth identifikimit dhe marrjes në punë të personelit minoritar.

### **Mjetet e informimit publik (mediat)**

92. Portretizimi i minoriteteve nëpër media (e sidomos në shtyp), si dhe përdorimi i gjuhës fyese, pastaj pasja në dispozicion si dhe mundësia e qasjes së mediave nga ana e minoriteteve, janë disa prej çështjeve kritike të cilat ndikojnë në zhvillimin e një klime të tolerancës. Në vlerësimin e UNHCR/OSBE-së të katërtin me rradhë mbi gjendjen e minoriteteve, ne deklaroam se “një tregues themelor në shoqërinë civile i cili shërben për të matur kapacitetin e komunitetit minoritar me qëllim të angazhimit të tij në jetën publike janë mediat”. Portretizimi (përshkrimi) negativ i minoriteteve nëpër media dhe mundësia e kufizuar për t’iu qasur mediave dhe si dhe të ndëgjohet zëri i tyre nëpërmjet të shfrytëzimit pozitiv të mjeteve të informimit publik paraqesin ende çështje të cilat brengosin.

#### Artikujt me karakter urrejtës

93. Incidentet që ndodhën për shkak të artikujve me karakter nderës të situatës të cilët publikoheshin nëpër mjetet e informimit publik (sidomos në shtyp) kundër minoriteteve vazhduan të ndodhin mirëpo prapëseprapë duke se kishte filluar të bie numri i tyre gjatë periudhës kohore kur ishte kryer ky vlerësim. Si rezultat i vrasjes së një Serbi të punësuar në UNMIK, i cili kishte qenë i akuzuar në shtyp se ishte një kriminel luftë (artikulli i publikuar në gazetën ditore në gjuhën shqipe dita më 28 prill), autoritetet filluan të marrin edhe hapa formal për të zgjidhur problemin e artikujve me karakter urrejtës. Në qeshor rregulloret 2000/36 dhe 2000/37 i dhanë pushtet (fuqi) komisionerit të përkohshëm të mediave që të dënojë të gjithë ata mbajnë përgjegjësi, si ata në kuadër të shtypit dhe ata të mjeteve transmetuese të informimit publik, për shkeljet e kodit të sjelljes. Një incident tjetër serioz me natyrë të nxitjes së mundshme të dhunës që kishte ndodhur më 4 korrik 2000. Përsëri ishte një artikull i publikuar në ditë, në të cilën ishin shkruar emrat e 12 serbëve të Gjilanit për të cilët pohohej se ishin kriminel të luftës, dhe gjithashtu, për herë të parë në mjetet e informimit publik, u sulmuan haptazi edhe priftërinjtë ortodoks. Më 12 korrik, tre priftërinjë që jetonin nëpër ato anë, të cilët mëparë e ndjenin vetën të sigurtë prej sulmeve, ishin viktimat të një incidenti me të shtëna.<sup>11</sup> Si rrjedhojë e gjithë kësaj, komisioneri i përkohshëm i mediave kishte marrur një sërë masash kundër gazetës dita mirëpo prurja e vendimit përfundimtar në lidhje me rastin është ende në shqyrtim e sipër.<sup>12</sup> KPM-ja gjithashtu ka marrur veprime kundër gazetës Rilindja dhe revistës Kosovarja; ku që të dyjave u është dhënë vërrejtje nga ana e KPM-së për shkak të artikujve në të cilët ishin të shkruar emrat e serbëve të cilët ishin kriminel të mundshëm të luftës, ku edhe komuniteti rom si një tërësi ishte sulmuar gjithashtu. Të dyja këto gazeta deklaruan se i kishin pranuar vërrejtjet e dhëna me shkrim dhe se në të ardhmen do të frenohen nga publikimi i artikujve të ngjashëm.

#### Qasja ndaj mediave

94. Shenja më e qartë e cila na dëfton për qasjen ndaj mediave të cilën e kanë minoritetet është fakti se sa lehtë minoritetet kanë mundësi që ti qasen një informate nëpërmjet

<sup>11</sup> Priftërinjtë nuk ishin përmendur në artikullin në fjalë. Pas publikimit të atij artikulli ata i kishte vizituar KFOR-I dhe policia e UNMIK-ut duke i pyetur se nëse dëshirojnë mbrojtje nga ana e tyre. Priftërinjtë e refuzuan këtë gjë duke u bazuar në faktin se ata gjithmonë kishin udhëtuar të sigurtë mëparë.

<sup>12</sup> KPM që në fillim e kishte përdorur pushtetin e tij që të dënojë gazetën Dita me një gobë, dhe pasi që kjo gazetë e kishte refuzuar që ta paguajë këtë gjobë, ai kishte urdhëruar suspendimin e aktiviteteve të kësaj gazetë më 26 Korrik 2000. Megjithatë, *Dita* vazhdoi që të publikoi artikujt e saj duke shfrytëzuar shtypin e një gazete tjetër, dhe në vendimin e parë të Bordit për Ankesa të Mediave, vendimi i KPM-së ishte hedhur poshtë nga ky Bord më 16 Shtator 2000. Bordi u pajtua me faktin se gazeta Dita kishte shkaktuar një rrezik për jetë dhe siguri, duke cituar në të njëjtën kohë se KPM-ja me veprimet e veta ka shkelur korrektësinë procedurale. Kjo çështje ishte kthyer për rishqyrtim të KPM-ja.



rrjeteve elektronike dhe mediave të shtypura natyrisht në gjuhën e tyre. Pasqyra prezente që tregojnë për qasjen që secili komunitet e ka ndaj minoriteteve ndryshon, me romët, fakt që nuk na befason, të cilët kanë më së paku qasje një grup ky i cili flet në gjuhën romane.

95. *TV RTK* transmeton prej 5 deri në 8 minuta program në gjuhën serbe në ditë, prej transmetimit total i cili është tre orë në ditë, nuk transmeton në gjuhën turke mirëpo citon se nëse fondet lejojnë një gjë të tillë, kjo kompani radiotelevizive ka vullnet për të bërë një gjë të tillë. Ajo transmeton nga dhjetë minuta lajme në gjuhën boshnjake, të cilat prodhohen nga TV i UNMIK-ut.
96. Radio mbetet burimi kryesor i informatave për komunitetin serb në Kosovë. Në njërin anë, ekziston një numër i radio stacioneve të vogla të cilët transmetojnë muzikë dhe zbavitje. Përjashtim janë *Radio Mir* dhe *Radio Contact Plus* (në Mitrovica/Mitrovicë) të cilat gjithashtu transmetojnë edhe lajme. Radio Kosova në frekuencën e dytë të saj transmeton nga dy orë në gjuhën serbe për çdo ditë, ku gjithashtu *bbc* dhe *Deutschewelle* transmetojnë në gjuhën shipe dhe atë serbe. Andaj, transmetuesit e huaj dhe radio stacionet në vetë Serbinë janë sigurues të rëndësishëm të programeve të lajmeve për komunitetin serb në Kosovë. Stacionet e tjera transmetojnë herëpashere programe në gjuhën serbe siç janë *Radio Contact* in Pristina/Prishtinë; *Radio Blue Sky* (radio stacioni i UNMIK-ut duhet të shkrihet në kanalën e dytë të radio Kosovës); *Radio Prizren* dhe *Radio Galaxy*. Një numër i radiostacioneve të vogla gjithashtu transmetojnë në gjuhën serbe. Për turqit, nga dy orë në ditë transmetohet në gjuhën turke në *Radio Kosovo*, dhe *Radio Blue Sky*, *Radio Prizren*, *Radio Sharri* në Dragas/Drage dhe *Radio Contact* in Pristina/Prishtinë gjithashtu transmetojnë programe në gjuhën turke. Pothuajse fare nuk transmetohet në gjuhën rome. *Radio Gracanica* transmeton nga 20 minuta në gjuhën rome në javë, përderisa radio contact transmeton program në gjuhën rome çdo dy javë. *Radio Ferizaj* është zotuar se do të jap një qasje të barabartë në media partisë rome njësoj sikurse edhe të gjitha partitë e tjera, masë e cila u kërkua nga kodi special për qasje ndaj mediave gjatë periudhës para-zgjedhore. *Radio Prizren* ka shprehur vullnet të mirë për të shtuar transmetimet në gjuhën rome në skemën e tyre të transmetimeve.
97. Komunitetet minoritare kalojnë ndryshe për sa i përket qasjes së mediave të shtypura. Përsëri, serbët e Kosovës kanë qasje relativisht të mirë, ku kemi gazetën e vetme në të shtypur në gjuhën serbe në Kosovë (*Novo Jedinstvo*) të cilës i shtohen edhe gazetatat e tjara të cilat vijnë nga vetë Serbia. *Politika* dhe *expres* shpërndahen falas 7 ditë në javë, të cilat vijnë nga beogradi. OSBE vazhdon me shpërndarjen falas të gazetave *Blic* dhe *Danas*. KFOR siguron furnizimin e popullatës serbe me gazetën *Telegraph* për çdo javë. Për komunitetin turk, ekziston vetëm një gazetë turke e quajtur *Yeni Donem*, e cila botohet një herë në javë në Prizren. Për komunitetin boshnjak, gazeta javore *Kosovski Avaz*, e cila gjithashtu botohet në Prizren, shpërndahet edhe në pejë dhe Prishtinë. Nuk është vërejtur se ekziston ndonjë publikim në gjuhën rome.

## Prona

98. Përderisa refuzimi i të drejtave pronësore ndikon në të gjitha komunitetet në Kosovë, si dhe ka një ndikim të rëndësishëm në çështjet që janë prezente sot siç janë kthimi i i pronës si dhe çështjet e ardhshme të privatizimit, disa aspekte të të drejtave të pronës ndikojnë mjaft rreptësisht në minoritetet.
99. Çështjet kryesore brengosëse të cilat ndikojnë në mënyrë negative në interesat negative bijnë në tre kategori të gjera dhe që janë të ndërlidhura në mes veti. Së pari, **okupimi i paligjshëm**; ku në të përfshihet edhe çështja e dëbimit me forcë nga shtëpitë e banueshme, ku në disa raste kjo dukuri shoqërohet edhe me përdorimin e dhunës dhe shkatërrimin e pronave të pjesëtarëve të pakicave pas të cilave zakonisht fillohet me rindërtimet ilegale në tokat ku shtëpitë e pjesëtarëve të pakicave kishin qëndruar aty njëherë. Dhe së dyti është nevoja që kërkues-paditësit e mundshëm të pronave të jenë të njoftuar mbi të drejtën e tyre për të kërkuar pronësinë e ligjshme të pronave nga e cila ishin dëbuar me forcë. Së treti, **ndihma për rindërtim**, qasja në të cilën kishte qenë mjaft problematike dhe e pabarabartë për sa i përket shfrytëzuesve të kësaj të drejte. Një gjë me rëndësi kritike në zgjidhjen e këtyre çështjeve është nevoja për të pasur qasje ndaj mekanizmave të caktuar efektiv, të cilët do të siguronin që pjesëtarët e minoriteteve të kenë mundësi që ti mbrojnë të drejtat e tyre të pronës apo që të kenë

mundësi që të kërkojnë këtë të drejtë në mënyrë të barabartë sikurse edhe popullata shumicë. E dyfishuar me një qasje të tillë është edhe nevoja për një politikë të qartë dhe jo-diskriminuuese e cila do të ishte e vlefshme për të gjitha regjionet dhe komunat, me qëllim të sigurimit të një qasje të qëndrueshme ndaj të gjitha çështjeve pronësore anëmbanë Kosovës.

100. Në disa zona, sidomos nëpër ato me popullatë të përzier, ende ka dëshmi të qarta për minoritetet të cilat shtyhen me forcë që ti lëshojnë shtëpitë e tyre, apo shtyhen me forcë që ti shesin ato me një çmim më të ulët se sa vlera e vërtetë e saj. Kosovo Polje/Fushë Kosova paraqet një shembull të kësaj pasqyre të përmendur; një nivel i ulët i keqtrajtimit të minoriteteve, të cilët mund të vizitohen deri nga 5 herë në ditë nga këta njerëz të cilët u bëjnë atyre presion për ti shitur pronat e tyre, kjo gjë ka qenë mjaft e vërejtur në qytet gjatë tërë vitit. Presioni për të cilin nuk ka shenja të pakësimit të saj, megjithatë mund edhe të rritet dhe shihet se me të vërtetë ka efekt. Raste të këtilla të keqtrajtimit kemi edhe në Lipjan/Lipjan, ku kemi thirrje kërcënuese telefonike të drejtuaras pjesëtarëve të minoriteteve, me qëllim për të bërë presion në ta për ti shitur këto prona, janë bërë një gjë e zakonshme. Në Obiliç/Obiliq, ekziston gjithashtu raste të tilla, mirëpo këtu duket se praktika e mëparshme ku këta pjesëtarë të minoriteteve ofroheshin një shumë e cila ishte më e vogël se vlera e vërtetë e cila sillej në treg për pronat e tyre tani kishte përfunduar dhe se tani të gjitha shitjet të cilat ishin bërë gjatë muajit gusht dhe atij shtator kishin qenë afër çmimeve të vërteta të cilat sillen për një pronë të caktuar. Edhe në vendet e tjera vazhdojnë të ndodhin dëbimet me forcë të cilat shoqërohen edhe me veprime të dhunës. Në vitina/viti, vazhdojnë të ngjajnë veprimet siç janë montimet e eksplozivëve nëpër pronat e serbëve ku mëpastaj këto prona jepen për shitje dhe shiten nga ana e shqiptarëve. Në Gnjilane/Gjilan, pas një pauze prej 9 javëve, në raportin e përpiluar më 20 shtator thuhet se kishin ndodhur sulme me granata mbi pronat e 5 serbëve të Kosovës në periudhën prej 15 deri më 20 shtator, ku gjatë një rreze prej katër sulmeve ishte vlarë edhe një pronar serb. Për shkak se nuk është gjithmonë e mundshme që të jipet mendimi i saktë në lidhje me motivet e këtij sulmi, dhe si rrjedhojë e kësaj është që shumë njerëz pastaj reagojnë në atë mënyrë që i lëshojnë shtëpitë e tyre ndërsa ata që qëndrojnë nëpër shtëpitë e tyre haptazi e vendosin vetën në rrezik.
101. Në Mitrovicë, dëbimet e dhunshme të minoritetit shqiptar të Kosovës në veri të qytetit gjithashtu kanë vazhduar. Në javën prej 15-22 shtator tri familje të shqiptarëve të Kosovës janë dëbuar me dhunë nga shtëpitë e tyre në veri. Siguria në rajonin e "tre soliterëve" e cila ka përjetuar dëbim të dhunshëm gjatë shkurtit 2000, vazhdon edhe më tutje të jetë e nderë edhe pse shumë shqiptarëve të Kosovës dhe të tjerëve u është mundësuar që të rikthehen në shtëpitë e tyre. Disa sulme përfshirë këtu edhe përdorimin e mortajave janë rishfaqur gjatë marsit dhe majit dhe rasti më i fundit në shtator.
102. **Drejtorati për Çështje Banesore dhe Pronësore (HPD) dhe Komisioni për Ankesa i tij** është ngarkuar që të përqëndrohet në ankesat (kërkesat) mbi pronësinë e pronës banesore. Hdp-ja është krijuar me rregulloren 1999/23 të datës 15 nëntor mirëpo deri tani ka arritur që të hapë vetëm zyren e përhershme në Prishtinë. Procedurat e qarta për zgjidhjen e ankesave/kërkesave nga ana e komisionit ende duhet të shpallen dhe të bëhen të njohura pa marrë parasyshë muaj të tërë të diskutimeve lidhur me këtë çështje. Si rezultat i kësaj një progres në pranimin dhe procesimin e ankesave/kërkesave ka qenë shumë i ngadalshëm dhe ende nuk ka pasur ndonjë përgjegjëje të pranueshme për palën ankuese/që bën kërkesë.
103. Duke pasur parasyshë kufizimet për punë nga qendra, HPD-ja në kuadër të veprimtarisë së saj ka inkorporuar **shërbimin mobil**. Kjo është e mirëseardhur mirëpo rezultati mbetet ende i kufizuar pasi që ende nuk ka mundësi të zgjidhjeve përfundimtare të rasteve. Në korrik HPD-ja ka dërguar ekipet mobile në komunitetet kryesore të minoriteteve në rejonin e Prishtinës që të shpërndajë formularët e ankesave/kërkesave dhe të ofroj ndihmë atyre që dëshirojnë të paraqesin ankesë.<sup>13</sup> ekipi së pari ka vizituar graçanicën/Ulpianën e pastaj Fushë Kosovën dhe planifikon të vizitoj Obiliqin. Një qasje e këtillë është kryesore për të çvendosurit brenda dhe jashtë Kosovës të cilët pohojnë pronësinë mbi pronën në Kosovë, posaqërisht ngase kjo ankesë/kërkesë mund lëshohet kundër asaj prone pa dijen e pronarit minoritar apo pa dijen e shfrytëzuesit. Në disa raste prona në të cilën ka jetuar pjestari i minoritetit mund të ndoshë që është okupuar nga dy apo më shumë persona apo familje. Për atë shkak ekziston rreziku që ankuesi

minoritar nuk do të jetë në dijëni se okupesit e tanishëm janë tani në kontest pronësor lidhur me atë pronë.

104. **Ekipi mobil i HPD-së është tërësisht i rezervuar deri në fund të dhjetorit.** Për atë arsye mjetet për angazhimin e më shumë ekipeve mobile janë mëse të nevojshme në mënyrë që të sigurohet se të gjitha minoritetet në të gjitha rejonet e Kosovës të kenë qasje në mekanizmin e ankesave/kërkesave. Gjithashtu munësimi i qasjes së duhur ndaj këtij shërbimi për të çvendosurit në Serbi, Mal të Zi dhe për refugjatët në maqedoni dhe diku tjetër është esencial. Për rastin e parë do të ishte më mirë që shërbimi të ofrohet nga një lokacion statik në komunat veriore ku do të mund të paraqiteshin ankesat/kërkesat drejtpërdrejtë. Për rastin e fundit do të mund të shërbeheshin ankesat/kërkesat postale apo vizitat periodike të ekipeve mobile. Një iniciativë e këtillë që mekanizmi të dërgohet te ankuesi/kërkuesi potencial, paraqet një shembull të mirë se si qasja ndaj shërbimeve kritike mund tu ofrohet komuniteteve minoritare. Donacionet e fundit për mundësimin e punës së HPD-së mund të ndihmojnë në këtë aspekt, por mjete tjera janë të nevojshme dhe hapat për rritjen e numrit të ankesave janë të pakuptimtë në mungesë të mekanizmit procedural për zgjidhjen e rasteve.
105. Dega e HPD-së për gjetjen e lokacionit ka inicuar sesione trajnuese me autoritetet komunale për vlerësimin e kërkesave humanitare për banim. Kërkesat humanitare i referohen procesit të gjetjes së lokacioneve të pabanuara përkohësisht për personat që kanë nevojë urgjente për vendosje. Programi dy-ditor trajnues organizohet në Prishtinë dhe qëllimi i tij është dhënja e instruksioneve zyrtarëve komunal për qështje të banimit se si të pranojnë dhe regjistrojnë aplikacionet/kërkesat për vendosje të përkohshme, dhe si të verifikojnë dhe vlerësojnë aplikantët në pajtim me instruksionet dhe sistemin e zhvilluar nga HPD-ja. Në kuadër të trajnimit përfshihet gjithashtu metoda që duhet aplikuar për krijimin e regjistrit të fondit të shtëpive. Këto masa janë të mirëseardhura si mjete të parandalimit *ad hoc* të përgjigjeve në terren ku ekziston rreziku i fuqizimit dhe dhënies së pëlqimit për uzurpimet joligjore.
106. Sigurimi i një politike të qartë qëndrore mbi çështjet kritike do të lejojë komunat që të adoptojnë një qasje të vazhdueshme ndaj çështjeve banesoro-pronësoro. Sigurimi i një qasje për minoritetet ndaj mekanizmave për pruarjen e vendimeve rreth ankesave të ndryshme siguron që të gjitha këto mekanizma të jenë njëlloj të qasshme. Kombinimi i një politike të qartë qëndrore dhe mekanizmave efektiv dhe të qasshëm, me masa të tjera speciale dhe të nevojshme që të sigurohet e ardhmja, mund të përmirësojë dukshëm situatën rreth pronës në tërësi. Prioritet tani është që të sigurohet një pajtueshmëri në nivelin lokal, si dhe të bëhet shtrirja e këtyre masave speciale përgjatë ekspansionit të përgjithshëm të HPD-së (Drejtoratit për Çështje Banesore dhe Pronësore) nëpër secilin rajon të Kosovës.
107. **Programi zyrtar i UNMIK-ut për rindërtimin e shtëpive**, program ky i cili ishte lehtësuar nëpërmjet të shtyllës IV-të (BE) e cila ka filluar me rindërtimin dhe rehabilitimin e mëse 8000 shtëpive anëmbanë Kosovës deri në shtator 2000. Megjithatë, Departamenti për Rindërtim pranon se një pjesë e vogël e kësaj ndihme kishte shkuar në shtëpitë pronarë të cilave janë minoritetet. Kjo mund të shpjegohet pjesërisht me faktin se vetëm një numër i vogël i shtëpive të minoriteteve ishin shkatërruar në krahasim me ato të shqiptarëve dhe tjetër është fakti se shumica e pronarëve të shtëpive të minoriteteve që janë mëse të shkatërruara ende mbeten me vendbanim jashtë Kosovës, në pamundësi për tu kthyer në Kosovë për shkaqe sigurie. Megjithatë ekziston edhe një fakt tjetër se pse këto projekte të tilla të rindërtimit mund të bllokohen edhe nga ana e komiteteve komunale për çështje banesore ashtu që aplikantët minoritar nëpër shumë vendbanime nuk ishin marrur parrasysh në krahasim me ato shqiptarë. Departamenti për rindërtim ishte alarmuar në mënyrë të përsëritur për faktin se implementimi i sistemit të tanishëm nuk ka arritur që të përmbush kërkesat/nevojat e komuniteteve të minoriteteve. Me kalimin e periudhës kohore të paraparë për këtë sezonë vjetore të ndërtimit, nuk shihet se ndërrimet edhe nëse do të kishin qenë të implementuara menjëherë, do të kenë ndonjë ndikim me rëndësi. Departamenti ishte zotuar se do të bënte vlerësimin e mënyrave që do ta bënin ndihmën e dhënë për rindërtim praktikisht të mundshme për minoritetet në vitin 2001, duke përfshirë këtu edhe një përgjegje më fleksibile të dhënë për nevojat e të kthyerve. Duke iu referuar të kthyerve minoritar duhet të theksohet një fakt se shumica e vendbanimeve të tyre ishin

okupuar në mënyrë të paligjshme ose shkatërruar që prej kohës kur ata e kishin lëshuar vendin, dhe nëse bashkësia ndërkombëtare është me të vërtetë e zotuar për të bërë më të lehtë kthimin e këtyre personave, atëherë duhet siguruar fonde të mjaftueshme me qëllim që këto fonde të kenë mundësi ti mbulojnë të gjitha nevojat që dalin nga ndihma e dhënë për rindërtim.

108. **Rindërtimi i paligjshëm** është një fushë mjaft me rëndësi e cila kohëve të fundit ka dalur në shesh. Kjo ndikon në të dyja komunitetet si në atë shumicë ashtu edhe në atë pakicë, mirëpo më shumë ka një ndikim të rreptë në minoritetet. Kudo që minoritetet ishin detyruar që ti lëshojnë shtëpitë e tyre, atëherë të gjitha ato ahtëpi ishin plaçkitur dhe demoluar si dhe pastaj toka ku ajo ahtëpi kishte qëndruar ishte bërë e përshtatshme për ndërtim të ri. Deri kohëve të fundit, komunat kishin adoptuar një brez të gjerë të masave të ndryshme me qëllim të marrjes me këtë çështje. Megjithatë, pas vrasjes së bashkëdrejtuesit shqiptar të Drejtoratit për Planifikim dhe Zhvillim të Prishtinës më 11 shtator, menjëherë ishin marrur veprime konkrete me qëllim që të sigurohet një qasje më e plotë ndaj kësaj çështjeje. Besohet se vrasja e tillë të ketë pasur lidhje me vendimin e marrur për demolimin e ndërtimeve të paligjshme në zonën e qytetit të quajtur gërmia. Viktima i ishte bashkuar vendimit të marrë edhe pse nuk e kishte nënshkruar vetë urdhrin për shembje. Pas vrasjes së tij, rregullorja mbi ndërtimin (rregullorja 'Luci' e cila e kishte marrur emrin e personit të vvarë) ishte nënshkruar ishte miratuar nga ana e PSSP-së. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të sigurohet marrja e veprimeve uniforme në nivel të komunave me qëllim të rrokjes më të mirë të këtij problemi dhe atë në pajtim me udhëzimet e lëshuara në nivel qëndror.

### **Shifrat e popullatës/zhvendosja/kthimi.**

109. Siç kemi bërë edhe me raportet e kaluara ne jemi përpjekur që të monitorojmë lëvizjet e popullatës dhe të sigurojmë shifra të sakta për popullatën pakicë, kurdo që kemi pasur mundësi. Brengosjet për shkak të gjendjes së sigurisë të cilat janë duke ndodhur edhe mëtej nënkupton se disa prej komuniteteve minoritare janë mjaft të syhapura për sa i përket deklaramit publik të tyre si të tillë. Mu për këtë arsye ne nuk potencojmë se kush është pjesëtarë i minoriteteve (veçanërisht ashkalinjtë dhe egjiptasit) në disa prej lokacioneve në të cilat këta persona gëzojnë një shkallë të lartë të integritimit/asimilimit me fqinjët e tyre shqiptarë. Tërheqja e vëmendjes kah këta persona është e panevojshme dhe mund të jetë e dëmshme për sigurinë e tyre. Më shumë se një vit pune intenzive dhe bashkëveprimi me komunitetet minoritare i kishte mundësuar UNHCR-së dhe OSBE-së që të mësojnë shumë për komunitetet minoritare dhe që në këtë mënyrë të sigurojnë shifra të përgjithshme në lidhje me popullatën e zonave të ndryshme. Sidoqoftë, asnjë organizatë, nuk është e pajisur në mënyrë të përshtatshme që të mbajnë statistikat për popullatën. Nuk ka pasur ndonjë regjistrim të popullatës për tërë provincën që nga regjistrimi fatkeq i vitit 1991 e cila ishte bojkotuar në tërësi nga shqiptarët si dhe nga shumë ashkalinjtë dhe egjiptasë. Faza e parë e regjistrimit civil ishte mbajtur nën përkujdesjen e UNMIK-ut në korrik 2000. Ky lloj regjistrimi nuk mundet të trajtohet njësoj si regjistrimi i vërtetë i popullatës dhe nuk lejon që shifrat e sakta të ekstrapolohen në baza të përkatësisë etnike, për shkak se origjina etnike nuk kishte qenë një prej fushave të cilat janë mbërthyer nga regjistrimi civil. Në vazhdim një numër i madh i popullatës pakicë, sidomos serbët dhe turqit e bojkotuan fazën e parë të regjistrimit.
110. Kosova vazhdon të ballafaqohet me plagët e konfliktit, urrejtjes ndëretnike dhe zhvendosjes së popullatës si rezultat i gjithë kësaj. Përgjatë provincës ka raste kur grupet etnike ende janë në pamundësi për tu kthyer në vendet e tyre të origjinës. Sidomos kemi edhe rastin me shqiptarët që vijnë nga veriu i Mitrovicës një zonë e cila është e dominuar nga serbët e Kosovës. Relativisht një numër i madh i serbëve të Kosovës dhe romëve mbeten ende në situata të tilla ku ata jetojnë si persona të zhvendosur dhe presin për t'ju ofruar mundësia për tu kthyer në vendet e tyre të origjinës. Serbët e Kosovës të zhvendosur nga Prizreni dhe Uroševac/Ferizaji për shembull janë më shumë të përqëndruar në Strpce/Shtërpce. Romët dhe ashkalinjtë e zonave të ndryshme vazhdojnë të jetojnë në strehimore kolektive gjysmë të përhershme në kampin për persona të zhvendosur në Plemetina/Plementine dhe në tre lokacione të tjera që ndodhen në veri të Mitrovicës. Numri i personave të zhvendosur të cilët janë absorbuar nëpër familjet të cilat i mirëpresin ato është mjaft e vështirë për tu vlerësuar mirëpo prapëseprapë mbetet një realitet i vazhdueshëm. Ndërkohë numri i personave që

janë të zhvendosur jashtë kufinjve të Kosovës mbetet ende i madh. Shqiptarët e Kosovës ende në një numër të madh të vendeve evropiane mbeten të qëndrojnë si refugjatë, kërkues azili ose nën çfarëdo regjimi të përkohshëm. Shumica absolute e atyre që kishin lëshuar vendin dhe shkuar në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë nën programin e evakuimit humanitar në peshën e situatës emergjente të vitit të kaluar, janë kthyer tani në Kosovë. Romët, serbët dhe grupet e tjera etnike, edhe pse në një numër shumë më të vogël se shqiptarët e Kosovës gjithashtu figurojnë nëpër numrat e lëndëve për refugjatë nëpër shumë vende të ndryshme. Në ndërkohë regjistrimi i numrit të personave të zhvendosur e mbajtur në Serbi dhe Mal të Zi me përkrahjen e UNHCR-së identifikojë një shumicë prej 180,000 dhe 30,000 persona të zhvendosur nga Kosova nëpër vende të ndryshme. Shumica dërmuese e këtyre personave të zhvendosur janë pjesëtarë të grupeve minoritare të cilët e lëshuan Kosovën pas vendosjes së misionit të kombeve të bashkuara në Kosovë. Këto shifra paraqesin numrin e përgjithshëm të personave të zhvendosur të cilët uparaqitën në mënyrë vullnetare për tu regjistruar.

111. Riatdhesimi në shkallë të gjerë për shqiptarët e Kosovës është në proces e sipër me vetëm 41,500 persona të cilët janë kthyer gjatë periudhës kohore prej qeshorit deri në shtator duke e përfshirë këtu edhe shtatorin. Kthimi me forcë sot është bërë një dukuri e rëndomtë, me rreth 7,600 persona të deportuar gjatë të njëjtit muaj. Shumica e shqiptarëve të Kosovës nuk janë të ballafaquar m ndonjë problem serioz që kërkon mbrojtjen e tyre i cili do të pengonte kthimin e tyre. Megjithatë shumë prej tyre ballafaqohen me probleme të tjera serioze sociale dhe humanitare, në veçanti për sa i përket mundësive për punësim, arsimim, strehim, qasjen ndaj shërbimeve sociale dhe nevojave të tjera esenciale. Në vazhdim, ekziston një numër i shqiptarëve të Kosovës të cilëve ende iu nevojitet mbrojtja ndërkombëtare dhe janë ende në pamundësi që të kthehen në Kosovë në këtë kohë sidomos për shkak të frikës se do ti nënshtrohen ndonjë lloj persekutimi apo shkeljeje të të drejtave të tyre të njeriut. Për të gjitha këto arsye PSSP-ja kishte kërkuar në mënyrë të përsëritur nga vendet të cilat kishin pranuar këto persona azilantë që të kontribuojnë për të mirën e një procesi të ndarë në faza të kthimit të këtyre personave me qëllim që të mos rrezikohet stabiliteti i një përparimi të arritur fillestar me ri-vendosjen e ligjit dhe rendit publik në Kosovë si dhe shërbimeve të tjera themelore sociale apo që të rrezikohen jetërat e individëve të ndryshëm. Kjo kërkesë ishte shprehur publikisht në dokumentin e politikës së UNMIK-ut mbi riatdhesimin e shqiptarëve të Kosovës, të lëshuar në qarkullim në fillim të tetorit.
- Riatdhesimi i shqiptarëve të Kosovës nuk është e ndërlidhur me çështjen e stabilitetit minoriteteve dhe mrojtjes së tyre.** Brengat që kanë të bëjnë me kthimin e një shkalle të gjerë e cila është në zhvillim e sipër do të ndikojë në mënyrë të paevitueshme në komunitetet minoritare përderisa sektorët e ndryshëm të shoqërisë bëjnë gara ndërmjet veti për ti siguruar vetës strehim, punësim dhe mundësi që ti qasen edhe shërbimeve të tjera. Sipas të gjitha gjasave komunitetet e minoriteteve dp të jenë ato që do të kalojnë më së keqi/ pësojnë keq si rrjedhojë e një garimi të tillë.
112. Pjesëtarët e komuniteteve, sikurse edhe personat e tjerë në Kosovë, kanë të drejtë që të kthehen nëpër shtëpitë e tyre. Një kthim i tillë do të ishte dashur të ndodh sa më shpejt që është e mundur nën rrethanat të një sigurie dhe dinjiteti të tërësishtëm. Kjo mund të ngjajë vetëm nëse kushtet në terren janë të përshtatshme. Çështja se a duhet kthimi i popullatës pakicë të jetë i inkurajuar nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, ende mbetet një çështje mjaft komplekse dhe përgjegjja për këtë çështje ndërron prej vendit në vend. Çka duhet të ndjeket në mënyrë aktive në këtë fazë është promovimi i idesë për përmirësimin e kushteve që do të ishin të përshtatshme për kthim të këtyre personave. Nëse kushtet e sigurisë mund të stabilizohen dhe nëse komunitetet minoritare kishin me ofruar mundësi realiste për një të ardhme në Kosovë, atëherë kthimi i këtyre personave do të pasojë vetvetiu pasi që dëshira e shumicës së refugjatëve dhe personave të zhvendosur është që të kthehen në vend kur për këtë të lejojnë kushtet. Se a është një kthim i tillë nëpër disa lokacione të veçanta momentalisht i mundshëm, kjo varet nga një sërë faktorë që janë ndërlidhës në mes veti, duke përfshirë këtu përkatësinë etnike, vendin e origjinës, marrëdhëniet e mëparshme në mes të popullatave fqinje, liri të lëvizjes, qasje ndaj shtëpive të tyre dhe, çka është më e rëndësishmja gjendja e sigurisë.
113. UNHCR and OSBE theksojnë se, përderisa projektet për kthimin e këtyre personave nëpër disa rajone specifike mund të jenë të mundshme dhe meritojnë një përkrahje të plotë, si dhe të gjithë të kthyerë që kthehen nëpër shtëpitë e tyre spontanisht atyre

duhet t'ju sigurohet një përkrahje e plotë për riintegrimin e tyre në shoqëri, prapëseprapë ende nuk është koha për për promovimin e idesë për një kthim të organizuar të një shkalle të gjerë. Rrethanat e sigurisë ende nuk janë të përshtatshme për një gjë të tillë. Komuniteti ndërkombëtar duhet të jetë i kujdesshëm gjatë promovimit të çfarëdo ideje për kthim të këtyre personave i cili kthim nuk është as i sigurtë e as i mundshëm (qëndrueshëm). Çështjet e potencuara me këtë raport janë më shumë ilustruese për sa i përket problemeve të vazhdueshme me të cilat ballafaqohen komunitetet minoritare si dhe sigurojnë bazat në të cilat çfarëdo kthimi i këtyre personave do të duhej të bazohej. Shtetet pranuese të azilantëve kanë pranuar faktin se një kthim i shkallës së gjerë i minoriteteve nuk është e mundshme në këtë fazë. Megjithatë ka pasur disa raste të izoluara të deportimit të cilat vënin jetërat e këtyre njerëzve në rrezik. Komuniteti ndërkombëtar duhet të përqëndrojë tërë energjinë dhe burimet e tij për krijimin e kushteve të cilat si rrjedojë do të na shpiejnë në kthimin e këtyre personave. Një përmirësim në kushtet e përgjithshme nën të cilat jetojnë komunitetet e minoriteteve të cilat kanë mbetur në Kosovë do të jetë porosia më e fortë për ata të cilët e kanë lëshuar vendin se ka shpresa për kthimin e tyre. Kthimi i refugjatëve dhe personave të zhvendosur nuk mund të trajtohet njësoj sikurse edhe çfarëdo akti tjetër i thjeshtë i bartjes së njerëzve prej një lokacioni në tjetrin; ku përndryshe i gjithë ky proces do të mirret si një humbje e kohës dhe një çështje mjaft komplekse. Një proces i tillë i cili gjithmonë duhet të ketë karakter humanitar, duke u fokusuar më shumë në nevojat dhe interesat e vetë personave të zhvendosur e jo në interesat politike të çfarëdo akteri të përfshirë në këtë proces.

114. Periudha e mbuluar me këtë raport është shënuar me një sërë zhvillimesh pozitive të cilat kanë hapur rrugën për diskutime të mëtutjeshme mbi atë se si bashkësia ndërkombëtare mund të lehtësojë dhe përkrah kthimin e minoriteteve nëpër rajone specifike dhe aty ku kushtet lejojnë. U shënuan një sërë rastesh të kthimit spontan të njerëzve në disa lokacione të ndryshme anembanë Kosovës. Edhe pse është ende herët që të kvantifikojë kthimin aktual të personave në formë të një treguesi pozitiv, është e qartë se të dy llojet e kthimit si ai i lehtësuar/organizuar e edhe ai spontan janë një trend i cili është në zhvillim e sipër dhe kjo mund të ndjell mirë e cila e mirë do të jetë një bazë e shëndoshë për një përparim në të ardhmen. Sidoqoftë, diskutimet rreth kthimit të këtyre personave duhet të bazohen më shumë në realitetin e sotëm, duke mos u bazuar në faktin se zhvendosja e komuniteteve minoritare e cila ndodh edhe sot e kësaj dite. Serbët e Kosovës dhe romët vazhdojnë që ta lëshojnë provincën për shkaqe sigurie. Shembulli i tanishëm i lëshimit të vendit ka më shumë natyrë sikurse që uji pikon ndalngadalë sesa kur ai rrjedh me shpejtësi gjë që ishte vërejtur verën e kaluar me lëshimin e vendit nga ana e minoriteteve. Për sa i përket grupeve të tjera etnike siç janë goranët, sllavo-muslimanët, turqit dhe kroatët ishin shënuar raste të lëshimeve individuale të vendit. Disa lëshime të vendit poashtu ishin shkaktuar si rrjedhojë e disa incidenteve të izoluara kundër pjesëtarëve të grupeve etnike në fjalë përderisa të tjerët duket se janë të lidhur me perceptimin e faktit se ka hapësirë të kufizuar veprimi për minoritetet në shoqërinë e dominuar nga shqiptarët e Kosovës.
115. Për serbët e Kosovës themelimi i komitetit të përbashkët për kthimin në maj 2000 ka siguruar një forum brenda të cilit do të duhej të diskutoheshin realitetet praktike të kthimit të serbëve. Ky organ udhëheqet bashkarisht nga PSSP-ja si dhe nga shefat e misionëve të UNHCR-së, OSBE-së, shtyllës së dytë të UNMIK-ut, komandantit të KFOR-it dhe kns-së. Komiteti drejtues i kpk-së i cili mbledhet një herë në javë, udhëheqet nga UNHCR-ja. Aktivitetet e ndërmarra nga ana e këtij komiteti janë të fokusuara më shumë në vlerësimin e gjendjes nëpër fshatrat të cilat janë vende të mundshme për kthimin e këtyre personave si dhe në lehtësimin e lidhjeve të komunikimit në mes të serbëve të Kosovës të zhvendosur në Serbi dhe vendeve të tyre të origjinës. Në vazhdim kpk-ja kishte shërbyer në shkëmbimin e informatave në lidhje me kthimin spontan si dhe në sigurimin e një përkrahje të ko-ordinuar për këta të kthyer. E arritura kryesore e këtij komiteti ka qenë ko-ordinimi i punës me të gjitha palët. Shkëmbimi i informatave dhe komunikimi direkt nëpërmjet të kpk-së ka mundësuar që të kemi një qasje realiste dhe të ko-ordinuar ndaj çështjes së kthimit. Një theks i veçantë është dhënë në rëndësinë e përfshirjes së vetë këtyre personave të zhvendosur në diskutimin e çështjeve siç është ajo se a është e mundshme për këta njerëz që të kthehen nëpër shtëpitë e tyre mu në këtë kohë. Vizitat shkuarëse dhe ardhëse janë rezultatet më të dukshme të përpjekjeve të bëra gjer më tani. Përveç këtij përparimi të bërë gjer më tani komuniteti serb vazhdon të ankohet se përparimi në lidhje me kthimin e serbëve është shumë i ngadalshëm.

Barra bie mbi të gjithë akterët e përfshirë në këtë proces që të punojnë bashkarisht në një bashkëpunim të ngushtë në mes vetime qëllim të gjetjes së mënyrave praktike me qëllim të shkuarjes përpara dhe në arritjen, gjer më tani, të sukseseve të kufizuara.

116. Siç u përmend më lartë, kemi vërejtur raste të kthimit spontan të serbëve nëpër disa lokacione të caktuara anembanë Kosovës. Kjo kryesisht është bërë në shkallë të vogël. Lëvizjet që janë duke ndodhur për sa i përket për në dhe nga Serbia e bëjnë të vështirë kvantifikimin e kthimit spontan të këtyre personave ku shumë serbë të Kosovës kanë përfutur nga rasti gjatë kësaj vere që të vizitojnë shtëpitë e tyre mirëpo pa qëllim të ndonjë kthimi të përhershëm në Kosovë. Shumë prej tyre nuk mund të binden për faktin se situata e përgjithshme në vend tani është e përshtatshme për kthimin definitiv të tyre në këtë kohë. Një brengë e veçantë e cila i shtyente serbët që të mos qëndrojnë më në Kosovë pas verës që shkoi ishte qasja ndaj shkollimit. Të kthyerit spontan gjithashtu ishin ballafaquar me probleme shtesë, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me çështje të pronës dhe qasje të kufizuar ndaj ndihmës së dhënë për rindërtim dhe shërbimeve tjera thelbësore. Vërehet se kthimet spontane të një shkalle të ultë kishin ndodhur në një numër të zonave të caktuara, sidomos në zonat rurale. Në përgjithësi numri i pjesëtarëve të komunitetit serb që jetojnë nëpër zonat urbane vazhdon të zvogëlohet. Shumë prej tyre që të cilët qëndrojnë në vend dhe ata që kthehen përkohësisht angazhohen rreth shitjes së pronave të tyre, e pasi që të arrijnë që ti shesin ato ata largohen nga Kosova përgjithmonë. Faktori shtyje-ngrehe i cili është në punë-përderisa kushtet e jetesës të personave të zhvendosur në vetë Serbinë vazhdojnë të jenë të rënda, ku kthimet paraqiten të ndodhin kur situata e sigurisë në disa zona të caktuara në Kosovë duket se është stabilizuar. Keqësimi i situatës së sigurisë si rrjedhojë e çfarëdo incidenti do të vendoste një stop të përkohshëm çfarëdo kthimi. Se me çfarë kthimi kemi të bëjmë kjo mund të shihet në kontekst të asaj se çka u tha gjer më tani. Siguria e të kthyerve të kohëve të fundit (në të gjitha zonat e tjera përveç atyre që janë të dominuara nga serbët më veriun e Kosovës) në përgjithësi bazohet në shkallën e lartë të prezencës ushtarake. Aktivitetet shko e shiko të cilat i bëjnë serbët e Kosovës, janë të karakterizuara me një shkallë të lartë të sigurisë. Një zotim i tillë nga ana e forcave të sigurisë, i cili është mirëseardhës dhe i nevojshëm, është i qëndrueshëm vetëm për një periudhë të kufizuar kohore dhe në një numër të kufizuar të vendeve.
117. Për romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit, miratimi i platformës për veprim të përbashkët është treguar të jetë një faktor mjaft i rëndësishëm në hapjen e rrugës për diskutime konstruktive për sa i përket kthimit. Një numër i këtyre vizitave shko dhe shih ishin të mundësuar dhe lehtësuara nga UNHCR-ja duke i lejuar refugjatët e ikur në maqedoni dhe personat e zhvendosur në Mal të Zi që të rivendosin lidhjet e tyre me komunitetet e tyre të origjinës. Pasi që shumë ashkalinjë dhe egjiptas që e konsiderojnë vetveten të jenë më afër me shqiptarët se sa me romët, andaj shumë vizita spontane dhe madje edhe kthimet e tyre në disa lokacione të caktuara kanë filluar me iniciativën e tyre, pa ndonjë involvim formal nga ana e bashkësisë ndërkombëtare në këtë drejtim. Sidoqoftë të kthyerit shpeshherë kanë nevojë për ndihmë të konsiderueshme humanitare për gjatë arritjes së tyre nëpër ato vende. Këto kthime spontane, pa marrur parrasys se deri në çfarë shkalle bëhen ato, prapsepapë paraqesin një zhvillim inkurajues. Nuk ishin të gjitha përpjekjet për kthim edhe aq të sukseshme; p.sh një familje ashkallike e cila ishte kthyer me vetë-iniciativë nga IRJM-ja në Stimlje/shtime në maj 2000, kishin qenë mëpastaj shënjestër e sulmeve të kryera nga persona të panjohur dhe pasi që i kishin përballuar një varg sulmesh me granata, ishin zhvendosur brenda në Kosovë në një shtëpi të kushërinjve të tyre për të ikur mëpastaj në maqedoni në kërkim të një jete më të sigurtë. Kthimi i mundshëm i një numri të vogël të familjeve egjiptase nga Mali i Zi në komunën e Pejës gjatë muajit shtator, kishte dështuar për shkaqe sigurie pasi që një person i zhvendosur e cila ishte kthyer në vend me vetë-iniciativë kishte pohuar se ishte rrahur nga një grup shqiptarësh. Në vazhdim, një numër i shtëpive të pjesëtarëve të minoriteteve në dhe përreth vendeve të destinacionit të tyre, ishin djegur gjatë muajit shtator. Cikli i vazhdueshëm i zhvendosjeve të popullatës vazhdon të ndikojë në pjesëtarët ekomunitetit rom. Komunitetet ashkali dhe egjiptas, në veçanti, ankohen për faktin se edhe pse ishin ballafaquar mëparë me zhvendosjet e popullatës së tyre së bashku me shqiptarët e Kosovës, pjesëtarët e komunitetit të tyre janë ende në pamundësi për tu kthyer nëpër shtëpitë e tyre të sigurtë, si dhe ende bëhet presion mbi pjesëtarët e këtij komuniteti të cilët kanë mbetur në Kosovë që të lëshojnë shtëpitë e tyre. Në anën tjetër është fuqia e lidhjeve të vjetra që këta njerëz i kishin me shqiptarët e

Kosovës ajo e cila ndalngadalë hap rrugën për kthimin e tyre nëpër disa prej lokacioneve të caktuara.

118. Problemet e sigurisë të cilat janë ende duke ndodhur kufizojnë gjasat për çfarëdo kthimi të mundshëm të popullatës pakicë dhe atë brenda një afati të shkurtër kohor. Kjo nuk do të thotë se përpjekjet për ti dhënë përkrahje çfarëdo kthimi të mundshëm duhet të jetë gjithashtu i kufizuar. Vetëm nëpërmjet të fokusimit në krijimin e kushteve të përshtatshme për kthim mund të ketë arsye për optimizëm që një kthim i tillë mund të ndodhë prej një afati të mesëm kohor e deri në një afat të gjatë kohor. Edhe nëpër ato lokacione ku problemet e paraqitura për arsye të sigurisë thuajse janë pakësuar, pengesa praktike të cilat e pengonin çfarëdo kthimi të mundshëm kishin dalur në pah. Qasja e kufizuar dhe e pabarabartë ndaj ndihmës së dhënë për rindërtim mbetet një brengë e veçantë për komunitetet minoritare, veçanërisht romët të cilët nuk kanë të njëjtat mundësi sikurse shqiptarët e Kosovës që kanë mundësi t'ua shtojnë ndihmës së dhënë ndërkombëtare, përkrahjen financiare të familjes së tyre që jetojnë jashtë vendit. Një përparim i ngadalshëm në themelimin dhe punën e drejtoratit për çështje banesore dhe pronësore dhe komisionit për ankesa paraqet një pengesë shtesë për të gjitha ato minoritete shtëpitë e të cilëve gjinden nëpër vende relativisht të sigurta mirëpo janë të okupuara nga të tjerët. Qasja e barabartë dhe jo-diskriminuese ndaj punësimit dhe shërbimeve të ndryshme e cila është cituar nga shumë njerëz të cilët përndryshe mund të marrin në konsideratë edhe opcionin e kthimit të tyre. Qasja ndaj shkollimit është një faktor tjetër i cili i bind minoritetet që të mos kthehen apo edhe të lëshojnë vendin në fillim të vitit shkollor në shtator. Pengesat e tilla duhet të trajtohen si pjesë e një strategjie të përgjithshme për minoritetet. Vetëm nëpërmjet të sigurimit të një mbrojtje të suksesshme për të drejtat e minoriteteve, do të arrihej që të bëhet një përparim thelbësor drejt një kthimi të sigurtë dhe të qëndrueshëm, duke ecur hap pas hapi drejt një të arriture pozitive mirëpo të kufizuar gjër më tani.

## **Serbët e Kosovës**

119. Në qytetin e Prishtinës, sipas vlerësimeve të bërë kohëve të fundit është se 600 serbë të Kosovës kanë mbetur në këtë qytet. Shumica e tyre janë të koncentruar nëpër zona të veçanta, me vetëm disa familje të tjera që mbeten të shpërndara në lokacionet e tjera përreth qendrës së qytetit. Në tërësi, ekziston një trend për serbët e Kosovës të cilët jetojnë në afërsi të njëri tjetrit përderisa kjo rrit vetëbesimin e tyre dhe ndjenjën e sigurisë. Liria e lëvizjes praktikisht nuk ekziston, dhe shumë familje të cilat janë si të themi të mbyllura nëpër shtëpitë e tyre. Patrullat në këmbë të KFOR-it vazhdojnë ti vizitojnë këto familje një nga një. Lidhjet emergjente telefonike janë instaluar nëpër disa shtëpi banimi duke i dhënë prioritet edhe çështjes së mirëmbajtjes së lidhjeve ekzistuese telefonike. Ishin vërejtur disa raste të kthimit në qytetin urban të Prishtinës gjatë kësaj periudhe kohore, dhe në fakt kishte vazhduar trendi i lëshimit të Prishtinës nga një apo dy familje në javë. Në muajin e fundit besohet se deri në 15 familje serbe kanë lëshuar zonën e qytetit të quajtur Bregu i Diellit. Shumë serbë të Kosovës theksojnë se ata kanë për qëllim që ta lëshojnë këtë vend menjëherë pasi të kenë arritur që ti shesin apartamentet e tyre. Shumica e shkuarjeve që kanë ndodhur gjër më tani janë bërë për në vetë Serbinë, mirëpo disa prej tyre kanë shkuar edhe për në vendet rurale në brendi të Kosovës, siç është graçanica/ulpiana apo fshatrat e banuara me serbë në veriun rural të Prishtinës. Këto shkuarje kanë ndodhur për shkak të kualitetit të jetës i cili të trishton, pa kurrfarë lirie të lëvizjes, mungesë të qasjes së kujdesit shëndetësor, qasjes së vështirë ndaj shkollimit si dhe perceptimin e përgjithshëm të asaj se edhe pse ekziston mbrojtja e KFOR-it për këta njerëz, nuk duken shenja të përmirësimit të gjendjes së sigurisë për sa u përket këtyre personave.
120. Nuk ka gjasa që serbët e Kosovës të kthehen në Prishtinën urbane me vetëdëshirën e tyre pa pasur indikacione të qarta rreth asaj se kushtet e sigurisë janë duke u përmirësuar. Një përpjekje e dukshme është bërë me qëllim të koncentrimin të resurseve drejt përmirësimit të kualitetit të jetës për komunitetin e vogël i cili gjendet në ndërtesat e YU programit. Qëllimet e këtij projekti përfshijnë vendosjen e një klinike mjekësoro-stomatologjike, dyqaneve, zonës ku mund të luajnë fëmijët, qendra e komunitetit për takime dhe aktivitete shoqërore si dhe themelimi i zyrës së propozuar të UNMIK-ut për ndërlidhje me komunitetin në fjalë. Në vazhdim OSBE është duke e lehtësuar krijimin e një komiteti të banorëve i cili do ti përfaqëson të gjitha serbët e Kosovës të cilët jetojnë në ndërtesat e YU programit.



121. Në qytetin e madh të Prishtinës lëvizja e popullatës kishte qenë mjaft dinamike. Vlerësimet e mëparshme për rreth 12 deri në 15,000 serbë të Kosovës të cilët kishin jetuar në tërë komunën e Prishtinës ishin llogaritur në bazë të shifrave mbi popullatën e asaj kohe të cilat ishin dhënë nga ana e liderëve të komuniteteve. Monitorimi i gjendjes i cili është bërë muajve të fundit i ka bërë që vlerësimet rreth popullatës të jenë më të sakta ; përkundër shkuarjeve dhe ardhjeve që paraqesin një dukuri e cila është në zhvillim e sipër, është e pamundshme që të jetë edhe më specifike se kjo. Shumë komunitete të serbëve të Kosovës në zonat qendrore të Kosovës të cilat e rrethojnë Prishtinën, Obiliqin, Lipjanin dhe zonat e tjera, kanë përfituar nga aktivitetet e ndërmarra nga KFOR-i në kuadër të **operacionit trojan**. Ky është një program i cili prek shumë aspekte të jetës, ku pikësëpari ky program është i dedikuar komuniteteve të serbëve të Kosovës dhe i dizajnuar për të përmirësuar kualitetin të përgjithshëm të jetës, duke qenë dobiprurës në disa raste edhe për fqinjët e tyre shqiptarë. Aktivitetet e kryera deri kohëve të fundit kanë qenë ngushtë të ko-ordinuara ndërmjet KFOR-it dhe akterëve të tjerë të përfshirë në këtë proces; në të cilin proces janë përfshirë marrëveshjet për përcjellje me qëllim të lehtësimin të ndjekjes së mësimëve nëpër shkolla nga ana e fëmijëve minoritar; ndërtimi i qasjeve ndaj rrugëve kryesore me qëllim të përmirësimit të lirisë së lëvizjes në rrethana të sigurisë së shtuar; masat e sigurisë së shtuara gjatë periudhës së të lashtave; dhe promovimi i aktiviteteve të ndryshme të cilat sjellin të ardhura personale të përshtatura asisoji që të mund të përmirësojnë vetë-mjaftueshmërinë e komuniteteve në përbushjen e disa prej aspekteve të caktuara të nevojave të tyre ditore p.sh bluarja e miellit dhe prodhimi i bukës. Operacioni trojan është treguar si një model mjaft i sukseshëm për një bashkëpunim efektiv civilo-ushtarak, duke e inkorporuar një element të fortë të bashkëveprimit me komunitetet vendore në zhvillimin dhe implementimin e të gjitha këtyre aktiviteteve.
122. Jnaë rreth 1,350 serbë të Kosovës që jetojnë në një grup të fshatrave që njihen si **veriu rural i Prishtinës**. Përafërsisht 20 burra të nacionalitetit serb të Kosovës nga këto fshatra kishin shkuar për në Serbi në fund të majit 2000 pas thashethëmeve rreth ekzistimit të listës në të cilën figurojnë emrat e disa prej meshkujve serb të kësaj zone si shënjestër e mundshme. Pas hetimeve të kryera nga policia e UNMIK-ut, OSBE-ja dhe KFOR-i, këtyre njerëzve u ishte thënë se nuk ekziston ndonjë kërcënim serioz këtu, ku paskëtaj këta persona ishin kthyer nëpër shtëpitë e tyre. Pa marrë parasysh se ky incident kishte ndodhur dy familje të tjera ishin kthyer në gusht 2000, duke theksuar se mëparë do të kthehen në Kosovë nëpër shtëpitë e tyre sesa të ballafaqohen me gjasa të dobëta ekonomike për të ekzistuar. Një përfaqësues i serbëve të Kosovës kishte pohuar se rreth 20 familje të tjera serbë kishin shprehur vullnet për tu kthyer mirëpo ato ishin frikësuar nga kidnapimi i një Serbi të Kosovës në fund të qeshorit 2000. Serbët e katij rajoni vazhdojnë që të ballafaqohen me liri të kufizuar të lëvizjes dhe mu për këtë arsye ato ballafaqoheshin edhe mëe një mungesë të qasjes ndaj shërbimeve themelore. Në fillim të vitit shkollor 2000, qasja e fëmijëve serb ndaj shkollimit mbeti ende problematike, me një autobus i cili mëparë vinte që ti merrte këta fëmijë nëpër shtëpitë e tyre dhe ti dërgonte nëpër shkolla, dhe nuk kishte zëvendësim për të në jug të Prishtinës, i cili kishte pushuar së funksionuari, dhe nuk kishte kurrfarë zëvendësimi.
123. Në **jug të komunës së Prishtinës** deri në 10,000 serbë të Kosovës vlerëohen të kenë mbetur. Kjo përfshin 4,000 prej tyre janë të koncentruar në enklavën e madhe të Graçanicës/Ulpianës. Gjendja e sigurisë ishte keqësuar pas valës së sulmeve mbi serbët e Kosovës në qeshor 2000. Më 6 qeshor ndodhi një sulm me granatë në vetë Graçanicën. Në vendet e tjera të regjionit ndodhën dy eksploziime të minave të montuara në rrugën e posahapur që lidh Graçanicën/Ulpianën me Fushë Kosovën, gjatë së cilës 4 serbë ishin vrarë. Pa marrë parasysh se kishin ndodhur këto incidente serioz, situata e përgjithshme e sigurisë dukej se ishte duke u përmirësuar ngapak, ku patëm një numër të serbëve që ishin kthyer nga vetë Serbia gjatë këtyre muajve të verës. Është shumë vështirë që të dijmë për shifrën e vërtetë të personave të kthyer për shkak të faktit se shumica e vendasve udhëtojnë për në dhe nga Serbia për vizita të herëpashershme atje duke shfrytëzuar autobusët e Nish Ekspresit. Sidoqoftë, për të gjithë ata që dëshirojnë për tu kthyer në Kosovë përgjithmonë, mungesa e strehimit për ta, veçanërisht për ata të cilët kthehen në një situatë kur ende kemi të bëjmë me zhvendosje të popullatës, ka qenë bariere kryesore për reintegrim të tyre në shoqëri. Shumë shtëpi në Graçanicë u janë lëshuar me qira ndërkombëtarëve gjatë tre muajve të kaluar ku qiratë janë bërë mjaft të larta për shumicën e serbëve të Kosovës. Në zonat rurale në pjesës tjera të regjionit përafërsisht 50 serbë të Kosovës janë kthyer nga vetë

Serbia për të vizituar fshatrat e tyre të origjinës. Kthimi u bë i mundur nëpërmjet të përpjekjeve të përbashkëta të KFOR-it, UNHCR-së, OSBE-së, UNICEF-it dhe OJQ-ve të tjera ndërkombëtare, me qëllim të përkrahjes së dëshirës së shprehur të të kthyerve për tu kthyer përgjithmonë në Kosovë. Për ta bërë të mundur një kthim të shkallës së tillë, ish-in nevojitur burime tepër të mëdha, si p.sh siguria 24 orëshe e ofruar nga ana e KFOR-it dhe një përpjekje intenzive të bëra nga një numër i organizatave ndërkombëtare me qëllim që të sigurohet shpërndarja e ndihmës humanitare dhe rindërtimit të shtëpive dhe objekteve shkollore.

124. Në **Podujevo/Podujevë** ende jetojnë dy gra të vjetra serbe në shtëpitë e tyre në këtë qytet. Siguria e tyre varet nga rojet 24 orëshe të siguruara nga KFOR-i. Në lokacionet e tjera të kësaj komune, ende kemi një grup të vogël serbësh që jetojnë nëpër shtëpitë e tyre të paprishura në sekiraçë (e njohur edhe me emrin medrejovac). Popullata e tanishme e këtyre anëve është zvogëluar ende prej 50 personave për të cilët vlerësohet se kishin mbetur në fillim të vitit. Shkuarjet e mëtutjeshme ishin provokuar nga vetë pasiguria, izolimi dhe mungesa e pensioneve. Gjatë muajve të verës popullatë e këtyre anëve ishte rritur si rezultat i të afërmeve të këtyre personave që kishin ardhur për vizitë nga Serbia. Ky komunitet mbështetet në prezencën e përhershme të KFOR-it e cila prezencë rrit gjendjen e sigurisë. Ekziston një bashkëveprim pozitiv ndërmjet të këtyre personave me fqinjët e tyre shqiptarë, ku incidentet e prerjeve të paligjshme të drunjve dhe vjedhja e bagëtisë vazhdon të rris ndjeshmërinë e serbëve të mbetur në vend dhe ka rritur tensionet ndërmjet tyre duke dekurajuar çdo lëvizje drejt nxitjes/ushqimit të marrëdhënieve të mira.
125. Në komunën e Lipjanit, kemi përrreth 9,500 serbë të Kosovës, të cilët jetojnë në vetë qytetin e Lipjanit (përafërsisht 3000 prej tyre) përdërisa pjesa tjetër e tyre është e shpërndarë nëpër fshatrat përreth. Shifrat për popullatën kanë ndryshuar ngapak me kthimet spontane të serbëve në këtë vend të cilat nuk e kishin prishur balancën e numrit të përgjithshëm të tyre i cili mbetet thuajse stabil. Incidentet me mina për të cilat folëm më lartë, kishin ndikuar në situarën e përgjithshme të sigurisë së këtij rajoni, për shkak se serbët e kësaj zone vareshin nga qasja në rrugën e cila ishte shkatërruar nga minat. Vdekja e një fëmiju serb dhe lëndimi i tre të tjerëve gjatë incidentit "godit dhe ik" si duket të qëllimshëm në skulanovo më 27 gusht, shënoi një keqësim të mëtutjeshëm të situatës së sigurisë. Shkalla e ultë e keqtrajtimit të serbëve, veçanërisht nga ana e fëmijëve shqiptarë, duket se është rritur në këtë komunë gjatë muajit gusht. Shitja e pronës, shpesh edhe me shtrëngim, kishte vazhduar të ngjajë dhe ishte aq serioze saqë edhe administratori komunal morri masa në shtator duke kërkuar që të gjitha shitjet e pronave të bëra nga serbët e Kosovës duhet të rishqyrtohen nga ana e tij me qëllim të përcaktimit se a kemi të bëjmë me procedurë korrekte të shitjes apo jo.
126. Serbët e mbetur në komunën e shtimes janë rreth 30 prej tyre, të cilët jetojnë në vetë qytetin e shtimes. Zvogëlimet e mëtutjeshme të numrit të tyre parashihet të ndodh në të afërmen e afërt për shka se dy serbë të këtij rajoni tentojnë që ta lëshojnë vendin për shkak të mungesës së qasjes në shkollim. Seria e sulmeve mbi shtëpitë serbe në korrik të këtij viti ishte ndalur ngapak pas rritjes së forcave të KFOR-it dhe policisë së UNMIK-ut në atë zonë, mirëpo prapsepër kjo dukuri nuk mundi të ndalet tërësisht. Mungesa e një stacioni policor në këtë komunë është një çështje që brengos. Katër familje serbe kishin shprehur dëshirën për ti vizituar shtëpitë e tyre mirëpo ata nuk u paraqitën në udhëtimin e organizuar nga ana e OSBE-së dhe UNHCR-së në gusht të po këtij viti.
127. Në **Obilic/Obiliq**, serbët e Kosovës mbesin të jetojnë në vetë qytetin dhe fshatrat përreth. Sipas vlerësimeve të bëra, duket të jenë 800 serbë të mbetur në qytet mirëpo ka pasur edhe shkuarje të mëtutjeshme të tyre, ku edhe popullata në vetë zonën urbane ishte zvogëluar mjaft që nga shkurti. Arsyeja kryesore për shkak të cilës serbët e lëshojnë vendin është gjendja e mjerë e sigurisë. Shumica e serbëve të Kosovës që jetojnë nëpër shtëpitë e tyre të cilat janë të shpërndara anëmbanë Kosovës kanë shprehur dëshirën që të shkojnë për në Serbi përdërisa ajo pjesë e popullatës e cila është e koncentruar nëpër pjesët mono-etnike të vendit duket të jetë më këmbëngulëse për të mbetur pa marrë parrasysh rrethanat e sigurisë me të cilat ata ballafaqohen. Në disa prej lokacioneve rurale ishin vërejtur rënie në numrin e popullatës; ku kemi vetëm 45 serbë të mbetur në fshatin e milloshevës, të rënë nga 65 prej tyre, shifër kjo e matur në shkurt 2000; ndërmjet 300 dhe 400 prej tyre në **Crkvena Vodica/Cërkvena Vodic**;

dhe; ndërmjet 800 dhe 900 në **Babin Most/Babi Most**. Shkuarjet e përhershme të serbëve nga vendi mund ti ngarkohen pikëpamjes së tyre se bashkësia ndërkombëtare nuk është duke bërë aq sa duhet për sigurinë e tyre. Një sulm me granatë i cili kishte ndodhur në crkvena vodica/cerkvena vodic, më 18 gusht gjatë së cilës u lënduan disa fëmijë serb të cilët ishin duke luajtur basketboll në momentin kur sulmi në fjalë kishte ngjarë; pastaj zbulimi i trupit të pajetë të një Serbi më 27 gusht në afërsi të po të njëjtit fshat; dhe protestat e ashpra të cilat shpërthyen si rezultat i këtyre dy incidenteve; bëri pak që të kundërshtojë mendimin e opinionit se ky ishte rasti. Incidentet e tjera përfshinin të shtënat nga automjeti në të cilat u vra një burrë serb në afërsi të babin mostit më 31 maj. Plemetini është enklava më e madhe serbe në komunën e Obiliqit, me një popullatë e cila vlerësohet të jetë prej 1,000 deri në 2,000 persona. Shifrat e mëparshme prej 1000 personave ishin të bazuara nga shifrat e dhëna nga liderët e komuniteteve. Të njëjtit liderë tani pohojnë se numri i popullatës tani i afrohet shifrës prej 2000 personave. Pasiqë fshati Plemetinë ka një popullsi të përzier të përbërë prej serbëve të Kosovës (duke përfshirë këtu edhe personat e zhvendosur dhe refugjatët nga Kroacia), romëve dhe shqiptarëve, është e mundshme që shifrat e dhëna nga këta liderë të komuniteteve thjeshtë janë të dyfishuara me qëllim që të dëftojnë për një prezencë të tërë të pakicës e cila shifër thuhet se është e përbërë vetëm nga serbët. Nuk ka pasur ndonjë indikacion rreth kthimit në shkallë të madhe të këtyre personave, dhe nëse vlerësimet për popullatën tani janë të pranuar me shifrën që gjendet lartë shkallës ndërmjet 1000 dhe 2000 personave, i vetmi shpjegim i besueshëm për këtë çështje është se kishim një një nënvlerësim të raporteve të publikuara mëparë.

128. Në komunën e Fushë Kosovës, janë matur të jenë rreth 5,000 serbë të Kosovës, duke përfshirë këtu edhe vetë 2,000 serbët që jetojnë në vetë qytezën e Fushë Kosovës. Numri i tyre në qytezë vazhdon të bie gradualisht me 200 njerëz të cilët e kishin lëshuar vendin gjatë këtij viti deri më tani. Numri i shtëpive të serbëve që janë për shitje në qytet është rreth 80% të numrit të përgjithshëm të tyre. Komuniteti vazhdon të paralajmërojë opinionin se pritet që shumë njerëz të lëshojnë vendin për shkak të keqtrajtimit të vazhdueshme që ndodhin kundër tyre dhe ndjenjës së izolimit dhe lënies pas dore nga të tjerët. Zjarrvëniet dhe sulmet me granata kundër shtëpive të serbëve kurrë nuk kanë pushuar. Në një tentim zjarrvënjeje më 25 korrik, një punëtor shëndetësor serb pasi që ishte kthyer nga kurs multi-etnik trajnues kishte gjetur shtëpinë e tij në flakë. Zjarrfikësit shqiptar pasi që kishin ardhur në vendin e ngjarjes ishin penguar nga pronari i shqetësuar i cili frikohej se ata do të shkaktonin edhe më shumë dëm. Për fat të keq shtëpia ishte djegur tërësisht. Ky incident shërben për të potencuar tensionet e larta dhe dyshimet që ekzistonin ndërmjet komuniteteve të ndryshme. Sidoqoftë, është shumë e rëndësishme që të theksohet se shifrat për serbët që jetojnë në komunën e Fushë Kosovës si një tërësi janë rritur që prej ishin matur herën e fundit. Kjo i ngarkohet si çështjes së kthimit spontan të tyre nëpër vendbanimet rurale dhe përshtatjes me vlerësimet e mëparshme për popullatën të cilat kanë mundur të jenë tepër konzervative.
129. Një numër prej 13,000 serbëve vlerësohet se ka mbetur në disa prej vendbanimeve të shpërndara rreth komunës së Gjilanit. Kjo shifër inkorporon në veti edhe shifrën prej 1000 personave të zhvendosur me nacionalitet serb të cilët kishin arritur që të mbesin në Kosovë të mirëpritur nga familjet e tjera që jetojnë në këtë rajon. Kjo popullatë mund të ndahet përafërsisht në 4 kategori; në atë urbane; enklavat e mëdha të banuara vetëm me serbë, fshatrat e vogla të banuara vetëm me serbë, dhe fshatrat e përzier. Në Gjilanin urban ekziston një numër i serbëve i cili është në zvogëlim e sipër i cili është vlerësuar të jetë rreth 400 prej tyre. Shumica e tyre janë të lidhur për shtëpi për shkak të frikës që e kanë dhe në tërësi varen nga ndihma e dhënë humanitare nga agjencitë e ndryshme. Shërbimet e autobusëve të UNHCR-së kanë lehtësuar deri diku problemet të cilat këta njerëz i kishin për shkak të mungesës së lirisë së lëvizjes, duke i lehtësuar në të njëjtën kohë edhe kontaktet ndërmjet vendbanimeve rurale dhe atyre urbane. Përcjelljet e sigurisë të cilat u siguroheshin këtyre linjave të autobusëve kanë lehtësuar gjithashtu vendosjen e një tregu të vogël ad-hoc në hyrje të qytetit të Gjilanit, e cila siguron që popullatë e cila sidoqoftë është e mbyllur të ketë mundësi që së paku të merr frymë lirisht në atë vend. Jashtë qytetit të Gjilanit, shumica e serbëve i takojnë kategorisë së dytë- në përgjithësi ata jetojnë nëpër enklavat serbe siç janë Pasjane/Pasjan, Partes/Partesh, Donja Budriga, Silovo/Shillove, Gornje Kusce/Kushicë E Epërme, Straza/Stazhe, Stanisor/Stanishor dhe Koretiste/Koretishte. Përqëndrime më të vogla të popullatës mund të gjinden në Paralovo/Parllove, Gornje Makres/Makresh dhe Draganac/Draganace dhe të tjerët të cilët jetojnë nëpër fshatra me popullatë të përzier

siç është Cernica/Cernice, Pones/Ponesh, Kmetovce/Kmetofc and Gornji Livoc/Livoc i Epërm. Situata e sigurisë në komunën e Gjilanit mbetet ende e rrezikshme, ku një bujk serb ishte vrarë në afërsi të Cërnicës më 1 korrik. Cërnica mëparë ishte vatër e incidenteve të dhunës, duke përfshirë këtu të shtëna nga automjeti në drejtim të tre serbëve, ku si rrjedhojë të kësaj kishim një fëmi serb të vrarë. Pesë meshkuj serbë ishin lënduar gjatë një sulmi me granatë dhe incidentit me të shtëna në Pasjane/Pasjan, më 2 tetor. Përveç vështirësive, ishte vërejtur një shkallë e ultë e kthimeve spontane që ende janë duke ndodhur nëpër disa prej vendbanimeve rurale.

130. **Komuna e Kosovska Kamenica/Kamenicës** ka rreth 10,500 banorë serb që jetojnë në atë komunë duke përfshirë këtu edhe 100 persona të zhvendosur. Popullata serbe është e shpërndarë nëpër një numër të vendbanimeve të ndryshme. Situata e sigurisë kishte mbetur relativisht e qetë për një kohë të gjatë përkundër një sërë incidentesh që kishin ndodhur në periudhën kohore prej fund gushtit e deri në fillim të shtatorit të cilat incidente e kishin luhatur vetëbesimin e komunitetit pakicë edhe ashtu të luhatur. Dy serbë të Kosovës ishin zhdukur nga fshati domorovc (fshat ky me popullatë të përzier) më 12 gusht, në mesin e thashethëmeve se këta persona ishin të kidnapuar nga kryengritësit shqiptarë dhe dërguar në jugun e afërt të Serbisë. Ky rast mbetet i pazgjidhur deri më tani përkundër arrestimit (dhe lirim të pasoi pas tij) të disa të dyshuarve shqiptarë të Kosovës. Sipas priftit në kosovska Kamenica/Kamenicë, disa prej familjeve serbe që kishin lëshuar vendin vitin e kaluar janë ende optimist për sa i përket gjasave për kthimin e tyre, edhe nën rrethana të gjendjes së keqësuar të sigurisë. Pengesa më e madhe për një kthim të mundshëm dhe reintegrit të qëndrueshëm të tyre në shoqëri është okupimi i paligjshëm i shtëpive serbe. Në zonën urbane është raportuar nga ana e liderëve të komuniteteve se 116 banesa të identifikuar si pronë e serbëve, vetëm 25 prej tyre mbesin në posedim të pronarëve të tyre origjinal. Gjatë muajve të verës u vlerësua se rreth 100 serbë ishin kthyer për të vizituar shtëpitë e tyre në qytetin e Kamenicës. Ata kanë shprehur dëshirë që të mbesin aty përgjithmonë mirëpo pritet që këto familje të cilat kanë fëmijë të cilët shkojnë nëpër shkolla parashifet që të lëshojnë vendin e të shkojnë në Serbi gjatë muajve. U vërejt një numër i lëshimeve të vendit si dhe kthimeve që ende ishin në shkallë të vogël në këtë komunë.
131. Në komunën e Vitisë, janë rreth 3,700 serbë të Kosovës duke përfshirë këtu edhe 100 persona të zhvendosur. Popullata serbe është e shpërndarë në 6 vendbanimet e ndryshme nëpër tërë komunën, duke përfshirë tre zona të përziera dhe tre që janë të banuara me popullatë të pastër serbe. Në muajt e verës u vërejt një trend i ardhjeve të personave të zhvendosur në Kosovë nga Serbia ku shifrat e përgjithshme mbi popullatën serbe ishin rritur, për shkak se disa vizitorë vendosën (zgjedhën) që të rrijnë. Të kthyerit kishin shprehur brengosjen e tyre për sa i përket rrethanave të ndryshueshme të sigurisë mirëpo është mirë që të theksohet se ata mëparë preferojnë që të kthehen nëpër shtëpitë e tyre sesa të jetojnë si persona të zhvendosur në kushte shumë të vështira në sërbi. Rreth 80 të kthyer janë identifikuar se janë kthyer dhe ka indikacione se edhe më shumë të tjerë do të mund të kthehen në të ardhmen. Një përjashtim këtu është komuna e vitisë ku kishte më shumë shkuarje sesa kthyerje. Serbët e Kosovës të cilat e kanë lëshuar vendin shpeshherë kanë qenë të obliguar ti shesin pronat e tyre me çmim shumë më të ulët sesa çmimi i vërtetë i cili sillet në treg; apo thjeshtë i kanë lëshuar ato. Ka pasur edhe incidente të tjera ku shqiptarët e Kosovës kanë qenë shënjestër e sulmeve me qëllim të dekurajimit të tyre që të mos angazhohen në marrëveshje pronësoro-juridike me serbët e Kosovës. Incidentet e fundit kishin ngjarë më 1 tetor, ku dy shtëpi ishin dëmtuar dhe një prej tyre ishte shkatërruar plotësisht nga eksplozimi në veri të vitisë. Ishte raportuar se të tre shtëpitë ishin pronë e serbëve dhe njëra ishte në proces të shitjes një shqiptari të Kosovës. Situata e sigurisë u tensionua edhe më shumë më 12 korrik pas sulmit mbi klerikun serb (e paraqitur edhe në seksionin për media të përmendur më lartë).
132. Në **komunën e Novo Bërdes** popullata e atjeshme serbe ka mbetur stabile me rreth 1,600 prej tyre që jetojnë në këtë vend. Në vazhdim, kjo komunë njihet gjithashtu me një numër të vogël të personave të zhvendosur. Situata e sigurisë në këtë komunë ka qenë relativisht e qetë mirëpo më 19 korrik një serb i Kosovës ishte lënduar përderisa ishte duke e punuar tokën e tij. Sulmet e këtij tipi kufizojnë mundësinë e komuniteteve që ta mbajnë vetën, përderisa janë të frikësuar që të shkojnë nëpër tokat e tyre me qëllim që ti punojnë ato.

133. Komuna e Shtërpces është enklava më e madhe serbe në rajonin e Gjilanit. Popullata e tanishme aty vlerësohet të jetë rreth 11,000 si rrjedhojë e ardhjes së personave të zhvendosur nga Serbia gjatë këtyre muajve të verës. Shumica e këtyre personave janë kthyer në një vend ku ka shumë persona të zhvendosur dhe ku gjasat e tyre për tu kthyer në vendet e tyre të origjinës janë shumë të vogla. Situata e përgjithshme në ato anë ende mbetet e tensionuar për shkak se shumë shqiptarë të Kosovës të cilët ishin zhvendosur nga ato anë gjatë konfliktit të vitit të kaluar ende janë në pamundësi që të kthehen në këtë rajon të dominuar me popullatë serbe. Është arritur një përparim në këtë aspekt, ku vlerësohet se rreth 4,000 shqiptarë të Kosovës janë kthyer nëpër shtëpitë e tyre në këto anë dhe madje kanë filluar edhe ti rindërtojnë shtëpitë e tyre. Zhdukja e një Serbi më 24 qeshor dhe zbulimi i trupit të pajetë të tij disa ditë më vonë, nxiti shpërthimin e protestave të ashpra nga ana e këtij komuniteti kundër bashkësisë ndërkombëtare duke e akuzuar atë se ka dështuar që ti mbrojë këta njerëz. Trazira e shkaktoar kishte si rrjedhojë shkatërrimin e pronës së UNMIK-ut. Si rezultat i kësaj KFOR-i suspendoi përkohësisht përcjelljet që ata ua bënin këtyre njerëzve nëpërmjet të linjës së autobusëve e cila përdorej ekskluzivisht nga vetë serbët. Qetësia u kthye përsëri në atë vend mirëpo situata e sigurisë ende konsiderohet të jetë e tensionuar.
134. Në komunën e Ferizajit, popullata serbe e këtyre anëve përbëhet nga disa persona të moshuar të mbyllur nëpër shtëpitë e tyre për shkak të frikës e cila ekziston tek ta, të cilët kanë edhe qasje të kufizuar ndaj shërbimeve të ndryshme dhe pa liri të lëvizjes. Duke përdorur konvojën e cili rregullisht udhëton prej Shtërpces për në Ferizaj nën përcjellje të KFOR-it mundëson vizitat të cilat personat e zhvendosur në këto anë ua bëjnë shtëpive të tyre. Këto vizita krijojnë mundësi për serbët që vetë të jenë në gjendje ta vlerësojnë situatën e krijuar. Megjithatë ata i gjejnë shtëpitë e tyre ose të shkatërruara ose të okupuara nga shqiptarët e Kosovës, gjë që minon çdo gjasë të tyre për tu kthyer. Komandanti i KFOR-it i asaj zone deklaroi se nën rrethanat e tanishme nuk është e mundur që të realizohet një kthim i serbëve në Ferizaj, edhe pse mundësia për një gjë të tillë nuk përjashtohet plotësisht. Në një rast, pas intervenimit të bërë nga ana e OSBE-së dhe UNHCR-së, KFOR-i u pajtua se do të sigurojë mbrojtje për të gjithë të kthyerit spontan të cilët kishin deklaruar se do të qëndrojnë për aq kohë për sa do të arrijnë ti shesin pronat e tyre.
135. Në komunën e Pejës, popullata e përzier me pjesëtarë të nacionalitetit serb dhe atij rom në fshatin e izoluar në Gorazdevac/Gorazhdec është rritur në 1,200 prej tyre, një rritje prej shifrës 400 e cila ishte matur në shkurt të vitit 2000. Shumica absolute e kësaj popullate janë serbë të Kosovës me vetëm një grusht romësh, dhe disa familje shqiptare shtëpitë e të cilëve janë të vendosura në vijat kufitare të asaj enklave mirëpo të cilat anë nuk konsiderohen të jenë pjesë e kësaj enklave. Linja e autobusit që udhëton rregullisht nga Serbia për në këtë enklavë, kishte lehtësuar procesin e kthimeve spontane. Disa persona të zhvendosur ishin kthyer për të qëndruar në ato anë në një situatë të zhvendosjes së popullatës, duke qenë në pritje të asaj se ata do të kenë mundësi që të kthehen nëpër shtëpitë e tyre për një periudhë të shkurtër kohore anëmbanë komunës së tyre. Kjo nuk ka ngjarë mëparë dhe nuk parashifet që një gjë e tillë të ndodh në të ardhmen e afërt për shkak të mungesës së kushteve adekuate të sigurisë. Vetë gorazhdecit vazhdon që të ballafaqohet me një gjendje lëkundëse të sigurisë pa marrë parasysh se aty kemi një prezencë mjaft të dukshme të KFOR-it dhe atë në numër të madh. Sulmet me mortaja kishin për shënjestër fshatin në fjalë më 6 qeshor, 3 korrik dhe 20 korrik. Për fat të mirë nuk kishte pasoja gjatë këtyre sulmeve mirëpo kjo ishte më shumë një çështje e fatit. OSBE kishte ndjekur një iniciativë për pajtim ndërmjet të fshatit gorazhdec dhe fshatrave të tjerë përreth të banuara me popullatë shqiptare mirëpo nuk u arrit ndonjë sukses i veçantë gjër më tani. UNICEF do të financojë një projekt i cili është i dedikuar për përmbushjen e nevojave të fëmijëve. Për shkak se ky projekt do të ketë vendin e tij të destinacionit në gorazhdec dhe fshatrat tjera përreth, ka mundësi që të kontribuohet në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet këtyre fshatrave nëpërmjet të lehtësimit të kontakteve ndërmjet komuniteteve të ndryshme mbi çështjet me rëndësi të përbashkët. Në pjesët e tjera në këtë komunë kemi një numër të vogël të serbëve të cilët jetojnë në pariarkinë që është një vend i shenjtë për kishën ortodokse serbe. Përpjekjet e bëra të cilat kanë përfshirë edhe pjesëmarrjen e një përfaqësuesi serb në administratën komunale kanë pasur një sukses të kufizuar për shkak se prifti në fjalë kishte kërkuar përcjellje të rrepta të sigurisë ku në të njëjtën kohë ai është dashur të ballafaqohet me turmën e zemëruar sa herë që ka dashur të marrë pjesë në mbledhjet e kësaj administrate.

136. Në **Istok/Istog**, popullata serbe në përgjithësi është e koncentruar në fshatin cërkolez me një numër prej 79 prej tyre i cili numër ishte në rritje për shkak të kthimit spontan të mëse 15 personave të zhvendosur në shtator. Vrasja e një fshatari të vjetër seb më 14 shtator jehoi anëmbanë komunitetit duke nxitur shkuarje të mëtutjeshme nga vendi. Kjo duket se frenon kthimet e mëtutjeshme që mund të ngjajnë në të ardhmen e afërt. Vizitat e ndryshme “shko e shiko” ishin lehtësuar dhe mundësuar për shumë persona të zhvendosur të cilët jetojnë në Serbi për të vizituar shtëpitë e tyre nëpër fshatrat e tjera të kësaj komune. **Një fshat në veçanti** ishte propozuar që të jetë një vend për projektin pilot të kthimit të serbëve që duhej të ndodhte në të ardhmen e afërt. Këto vizita të të ashtuquajturat “shko e shiko” mundësuan personave të zhvendosur që të kthehen e ti shohin ish shtëpitë e tyre dhe në bazë të kësaj edhe të vlerësojnë situatën dhe kushtet në ato vende. Këto vizita ishin bërë të mundshme nëpërmjet të prezencës së madhe të forcave të sigurisë. Ky fakt nuk parasheh mirë përse i përket kthimit i cili mund të ndodhte në të ardhmen e afërt mirëpo përpjekjet janë duke u si dhe hulumtimit të mëtutjeshëm të të gjitha gjasave të mundshme që do të mundësonin kthimin e atyre personave të cilët kanë shprehur dëshirën që të kthehen nëpër shtëpitë e tyre. Ndërmjet komunave të Gjakovës dhe Deçanit, kemi një numër të kombinuar të serbëve të mbetur i cili nuk është më shumë se 50 persona, shumica e tyre kallogjerë dhe murgësia, të cilët jetojnë nëpër objekte fetare dhe varen nga prezenca 24 orëshe e KFOR-it e cila është e autorizuar që të ofroi siguri për këta njerëz dhe për këto objekte fetare në përgjithësi.
137. Në qytetin e Prizrenit kemi një numër prej 120 serbëve që jetojnë në atë vend. Kishte edhe shkuarje individuale nga ky vend ku edhe disa prej familjeve të mbetura në atë vend kanë bërë me dije se dëshirojnë që edhe ata të shkojnë, duke mos mundur që të përjetojnë më kushtet e ashpra të cilat u imponohen për shkak të faktit se nuk kanë kurrfarë lirie të lëvizjes. Ekziston një numër shumë i vogël i minoriteteve të cilët jetojnë në një mësonjtore fetare ortodokse të cilët janë të mbyllur aty për shkak të gjendjes së sigurisë e cila mbisundon në ato anë gati më shumë se një vjet. Përderisa nevojat e tyre humanitare janë përbushur, kualiteti i jetës i këtyre njerëzve e sidomos i fëmijëve është tejet i varfër. Në luginën e zhupës e cila gjendet në rajonin e komunës së Prizrenit, popullata serbe ka mbetur stabile me afro 130 prej tyre të cilët kryesisht jetojnë në vendbanime rurale. Një numër i vogël i serbëve të moshuar para pak kohe ishin kthyer në fshatin e mushnikovës, shumë shpejt pasi që kishin marrur pjesë në vizitat e ashtuquajtura “shko dhe shiko”. KFOR-i gjithashtu është pajtuar me tre kërkesa për transportim të një numri të madh serbësh për në mushnikovë dhe steckë me qëllim të festimit të festave të tyre fetare. Gjendja e sigurisë nuk është edhe aq e kënaqshme, ku këto vizita të serbëve në një numër të madh të tyre mund të konsiderohet si një provokim për shqiptarët e Kosovës. Serbët e Kosovës të fshatit mushnikovë ishin keqtrajtuar dhe kërcënuar nga një grup i personave të armatosur në natën e 23 gushtit pas të cilës kishte pasuar një sulm mbi varrezat serbe që ishin të ngjitura me kishëzën ortodokse. Këto incidente shërbejnë për të potencuar nevojën për të vazhduar me aktivitetet që kanë të bëjnë me kthimin e serbëve.
138. Në **Orahovac/Rahovec, numri i serbëve** që gjenden në Rahovec si dhe në velika hoçë ka ndryshuar që prej kur është vazhduar mbajtja e linjës së autobusëve të organizuar nga UNHCR-ja në fund të prillit. Popullata e tanishme në ato anë vlerësohet të jetë rreth 1,100 serbë të Kosovës të cilët jetojnë në të dyja këto lokacione. Kjo është një ulje e konsiderueshme e numrit të mëparshëm prej 2,000-2,200 serbëve të cilët jetonin aty në shkurt të këtij viti. Të dyja palët si serbët ashtu edhe romët kanë përfituar nga kjo linjë e autobusëve e cila i transportonte ata për në veri të Kosovës prej nga ata mund të zgjedhnin për të vazhduar mëtej për në Serbi. Numri i udhëtarëve të kthyer ishte gjithmonë më i vogël se i atyre që e lëshonin vendin. Ky trend i kthyer kohëve të fundit duket se është treguar si i mjaft i përshtatshëm dhe si një kontribut i dedikuar më shumë për lirinë e lëvizjes sesa që mund të konsiderohet si një udhëtim jashtë Kosovës. Incidentet e sigurisë vazhdojnë që të ndodhin rregullisht andaj lëshimet e vendit që pasojnë si rezultat i kësaj nuk mund të ndalohen. Në fillim të Korrikut ndodhën një sërë sulmesh me mortaja të lansuara kundër Hoçës së Madhe. Sulmet zjarrvënëse kundër shtëpive serbe dhe rome në Rahovec mund të konsiderohen si një ndodhi e zakonshme, zjarrvënja e fundit kishte ndodhur më 27 shtator.
139. Në **Mitrovica/Mitrovicë** serbët mbesin të jenë pakicë në pjesën jugore të qytetit dhe zonat përreth. Popullata e vogël serbe e cila jeton rreth kishës ortodokse në jug të

qytetit, është zvogëluar gjatë 16 muajve të fundit. Edhe pse ekziston mbrojtja 24 orëshe e siguruar nga KFOR-i prapëprapë popullata e atjeshme serbe jaton në kushte shumë të vështira duke u ballafaquar me kërcënime konstante gjë që si rrjedhojë këta njerëz janë të detyruar që të udhëtojnë vetëm nën përcjellje. Disa prej serbëve të moshuar vazhdojnë që të jetojnë nëpër shtëpitë e tyre që gjenden në pjesën jugore të qytetit. Përpyekjet e bëra nga UNMIK-u për të lehtësuar kthimin e serbëve në dy blloqe të banesave të cilat gjenden në pjesën jugore matanë lumit kishin dështuar gjer në atë moment. Në dy enklavat serbe që ndodhen në jug të Mitrovicës, popullata serbe e suhollit të epërm mbetet e pandryshuar me 150 serbë që jetojnë aty dhe në frashër i madh, popullata e tanishme e serbëve të Kosovës që jetojnë në ato anë vlerësohet të jetë rreth 600 persona. Ky fshat mëparë thuhet se kishte pasur rreth 300 banorë. Kjo rritje e numrit të banorëve serbë mund ti ngarkohet shërbimit të posaçëformuar të trenave, i cili mundëson që të kemi udhëtime për në veri të Mitrovicës. Thuhet se një numër i familjeve serbe ishte kthyer për ti vizituar shtëpitë e tyre, ku disa prej tyre rrinin aty edhe gjatë vikendit. Situata e tensionuar ndërmjet serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve kishte shpërthyer në fillim të gushtit gjatë ceremonisë së hapjes së urës së re. Prezenca e pjesëtarëve të tmk-së ishte konsideruar si një akt provokativ nga serbët e Kosovës të cilët mëpastaj kishin gjuajtur me gurë në drejtim të shqiptarëve të cilëve u kishte ndihmuar KFOR-i dhe UNMIK-u gjatë kthyerjes për në shtëpitë e tyre. Komuna e Skenderajit, me rreth 200 serbë të Kosovës të cilët kishin mbetur në fshatin me popullatë të përzier të banjës. Pas vizitave të organizuara shko dhe shiko”, 4 familje serbe kishin vendosur që të kthehen aty. Të inkurajuar nga ky fakt komuniteti vendor vlerëson seka gjasa që edhe 10-13 familje të tjera të kthehen nga Serbia. Të kthyerit kishin deklaruar se gjendja e përmirësuar e sigurisë në fshat dhe mungesa e burimeve për jetesë në vetë Serbinë, ishin një prej faktorëve motivues për kthimin e tyre. Rreth 120 serbë të Kosovës jetojnë në fshatin suho gerllë ku ndoshta edhe tre familje të tjera serbe planifikojnë që të kthehen aty. Nuk kishte ndodhur asnjë incident në atë rajon kohëve të fundit mirëpo prapëprapë njerëzit që jetojnë në këto anë ishin tmerruar pas vrasjes së një Serbi të moshuar në afërsi të fshatit crkolez (komuna e Istogut). Nëntë murgesha ortodokse jetojnë në manastirin e deviçit nën mbrojtjen 24 orëshe të siguruar nga KFOR-i të cilat herëpashere vizitohen edhe nga priftërinjë të tjerë.

140. Në komunën e Vushtrisë, vlerësohet të kemi një numër prej 4000 serbëve të cilët jetojnë në gati 6 fshatrat e kësaj ane, me një përqëndrim më të madh të tyre prej 3000 deri në 3200 prej tyre në Prilluzhje. Kishte indikacione të qarta të kthimeve spontane të cilat shkaktuan që numri i popullatës të rritet. Vetëm në një fshat, rreth 100 persona janë kthyer gradualisht që prej prillit të këtij viti mirëpo kjo lëvizje e popullatës u ngadalësua gjatë muajit gusht pasi që shumë persona të rinj lëshonin vendin me qëllim të vazhdimit të shkollimit të tyre në Serbi. Rindërtimi i shtëpive dhe i një shkolle në këtë fshat ishte identifikuar nga ana e komitetit të përbashkët mbi kthimet si një prioritet, me qëllim të stabilizimit të popullatës dhe ofrimit të gjasave reale për një reintegrim të qëndrueshëm të tyre në shoqëri. Incidentet zjarrvënëse dhe frikësimet që ndodhën më 21 dhe 26 shtator të këtij viti kishin ndikuar në mënyrë indirekte në vetëbesimin e të kthyerve, mirëpo përkundër këtij fakti ata dukeshin të vendosur që të mbesin aty. Në fshatrat e tjerë; popullata e këtyre anëve ishte rritur gjatë muajve të verës për shkak se personat e rinj përfitonin nga shansi se ishin në pushim shkollor me qëllim që të vizitonin familjet e tyre, trend ky i cili ishte ndalur pak pas fillimit të vitit shkollor. Serbët e Kosovës të cilët jetojnë nëpër vendbanime të izoluara rurale vazhdojnë që të keqtrajtohen thuajse rregullisht. Vjedhja e bagëtisë së tyre dhe djegja e grumbujve të kashtës ndikon serozisht në aftësinë e tyre për ta mbajtur vetveten si dhe bën presion të mëtutjeshëm në ta që ta lëshojnë vendin. Edhe pse KFOR-i kishte rritur numrin e patrollave me qëllim të luftimit të kësaj dukurie, serbët e Kosovës të kësaj komune vazhdojnë të pohojnë se fqinjët e tyre shqiptarë vazhdojnë që ti kërcënojnë ata.

## Romët<sup>13</sup>

141. Në raportet e kaluara ne patëm theksuar për faktin se është shumë vështirë që të flitet për sa i përket homogenitetit të komunitetit rom në Kosovë për shkak të ekzistencës së grupeve etnike siç janë ashkalinjtë dhe egjiptasit. Përveç faktit se këto komunitete kanë lidhje me romët, kjo nuk do të thotë se ata e konsiderojnë vetën si rom. Për një referim më të lehtë ne kemi përsëritur mëposhtë një vërejtje (fusnotë) me karakter shpjegues e cila është marrur nga raportet e kaluara të cilat na sigurojnë një prapavi mbi lidhjet dhe dallimet ndërmjet këtyre grupeve përkatëse. Qasja e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë ka qenë më së shumti që të trajtojë romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit si përbërës të një grupi etnik. Platforma e Aksionit të Përbashkët është nxitur/ushqyer dhe përkrahur në bazë të premisë se të trija këto grupe etnike kanë çështje të përbashkëta që i brengosin ato. Platforma respekton faktin se çdo komunitet përbërës këtu në Kosovë ka të drejtë që ta identifikojë vetveten në bazë të zgjedhjes së vet. Duke u fokusuar në çështjet e përbashkëta që brengosin ka qenë e mundshme që të arrihet një koncenus rreth çështjeve të cilat mund të zgjidhen nëpërmjet të një bashkëpunimi të ndërsjellë për të mirën e komuniteteve të tyre.
142. **Ne kemi vazhduar që të përdorim fjalën rom si një term gjithpërfshirës përgjatë tërë këtij raporti, duke sqaruar se është e nevojshme që të kemi një referim veçanërisht për komunitetet rome, ashkali dhe atë egjiptas duke i përjashtuar të tjerat.** Kjo është bërë duke respektuar karakteristikat kulturore dalluese të tyre dhe me qëllim që të potencohen, siç mund të jetë edhe rasti, se cilat mund të jenë shqetësimet e përbashkëta dhe në cilat aspekte ndryshon situata me të cilën këto komunitete ballafaqohen. Në nivel të fshatrave disa grupe përkatëse nuk i përshkruhen asnjëherë prej klasifikimeve duke preferuar që të mbajnë emrat të cilat i identifikojnë ata në pajtim me strukturat vetjake klanore. Shembujt e këtij lloji janë mjaft të rrallë dhe shumica e njerëzve e identifikojnë vetveten duke iu referuar njëherë prej këtyre tre grupeve etnike.
143. Të trija këto komunitete vazhdojnë të ballafaqohen me probleme të përgjithshme diskriminuese dhe keqtrajtuese. Gjatë periudhës së raportimit, rastet e zjarrvënive, sulmet me granata dhe vrasjet ishin dokumentuar gjithashtu. Ashkalinjtë dhe egjiptasit shpeshherë gëzojnë liri më të madhe të lëvizjes. Kjo ngjan për shkak të lidhjeve të tyre tradicionale me shqiptarët e Kosovës dhe faktin se ata e konsiderojnë gjuhën shqipe si gjuhë të tyre amtare. Shkalla e lirisë së lëvizjes të cilën e gëzojnë ata ndryshon në mënyrë dramatike prej vendit në vend. Disa komunitete janë të lirë për të lëvizur brenda qytetit ku jetojnë ose ndërmjet të qyteteve dhe fshatrave që gjenden në kuadër të zonës të cilën e mbulon komuna në fjalë, mirëpo prapë janë në pamundësi të udhëtojnë mëtej, veçanërisht në Prishtinë. Kjo i pengon ata që të kenë mundësi që ti qasen shërbimeve të ndryshme siç janë spitali i Prishtinës dhe universitetit, strukturave të UNMIK-ut në nivel

<sup>13</sup> Siç është vërejtur në raportet e kaluara (Shiko në faqen 10 të Vlerësimit të Dytë) romët janë shumë larg prej të qenurit si grup i ndërlidhur në mes veti. Të ashtuquajturit "Romët etnik" e identifikojnë qartë vetveten si romë dhe përdorin gjuhën romane si gjuhë të tyre amtare, edhe përkundër faktit se ata mund ta flasin edhe shqip dhe Serbokroatisht. Ata kanë një traditë të nderuar dhe lidhje me komunitetet e tjera rome që jetojnë në vendet e tjera. Përkundrazi Ashkalinjtë (të cilët janë shqipfolës) gjithmonë janë identifikuar si shqiptarë dhe kanë mbijetuar deri më sot. Sidoqoftë ata trajtohen ngapak ndryshe nga shqiptarët etnik. Një komunitet tjetër të cilët e distancojnë vetveten nga romët etnik janë edhe Egjiptasit (të cilët nga ana e disa vëzhguesve konsiderohen të jenë të njëjtë me Ashkalinjtë) të cilët flasin shqip mirëpo pohojnë se origjinën e kanë nga Egjipti. Mendohet se paraardhësit e tyre ta kenë përcjellur Aleksandrin e Madh prej Indisë për në Egjipt ku ishin vendosur për një kohë para se ta kishin marrur guximin që të nisen për në Evropë. Pa marrë parasysh se cila është origjina e tyre ata nga ana e shqiptarëve perceptohen si romë; ku dhjetë vjet mëparë regjimi i Beogradit i kishte zbuluar këto identitete të veçanta etnike me qëllim që të promovojë idenë e një pasqyre të një Kosove multi-etnike e cila nuk ishte e dominuar vetëm nga shqiptarët. Sidoqoftë me kalimin e kohës kemi signale të dhëna nga ana e Egjiptasve të cilët dëshirojnë që të konsiderohen si shqiptarë e jo si minoritet, signale këto të cilat janë duke u bërë gjithnjë e më shumë therrëse. Në ato fshatra ku ata janë të integruar ata trajtohen si shqiptarë nga bashkëfshatarët e tyre, gjë që kjo mund të shkaktojë që shifrat mbi popullatën të mos jenë edhe aq të besueshme. Të dyja komunitetet si ai Ashkali e ashtu edhe ai Egjiptas janë të besimit musliman. Dhe së fundi kemi romët çergarë të cilët janë të besimit ortodoks, flasin serbokroatisht (edhe pse kanë mundësi që të flasin edhe në gjuhën romane) dhe kanë një stil të jetesës nomade, duke udhëtuar prej një vendi në tjetrin të populluar me serb. Të gjithë romët ortodoks, të cilët jetonin në zonat përreth Fushë Kosovës lëshua vendin pas përfundimit të konfliktit, pasi që ishin të lidhur ngushtë me administratën e mëparshme serbe dhe si të tillë ka tendenca që romët e tjerë të distancohen nga ta. Kemi gjithashtu disa romë të besimit katolik të cilët jetojnë në zonat e populluara me kroat në afërsi të Lipjanit. Përshkrimet të cilat janë dhënë për secilin grup në kuadër të komunitetit të gjerë rom dallojnë nga ato të cilat secila grup i jep për vete.



qëndror apo të angazhohen klirisht në aktivitete biznesi. Edhe përkundër përmirësimeve të vërejtshme për sa i përket lirisë së lëvizjes, dhe porosinë e përsëritur se këto komunitete minoritare janë duke përparuar përballë bashkëveprimit të tyre konstruktiv me fqinjët e tyre shqiptarë, ku nocioni i përgjegjësisë kolektive për krimet e kryera në të kaluarën ende ngel si i tillë në këto anë dhe shpeshherë është i cituar nga ana e komunitetit shumicë si një pengesë për kthimin e minoriteteve. Si reagim ndaj gjendjes së përmirësuar të sigurisë nëpër vendet e caktuara, romët, e më shpesh edhe ashkalinjtë dhe egjiptasit, kanë filluar që të angazhohen në dialogje proaktive dhe konstruktive me KFOR-in dhe policinë e UNMIK-ut përballë nevojave të tyre sigurisë. Në disa lokacione kjo ka lejuar që shkalla e sigurisë së shtuar për ta e ofruar nëpërmjet të marrëveshjeve të rëndomta të sigurisë të ulet në mbajtjen e patrollave rutinore. Për fat të keq megjithatë, shumë komunitete ende kërkojnë vëmendje të veçantë për sa i përket nevojave të tyre të sigurisë. Gjendja e sigurisë madje ishte keqësuar nëpër disa zona të caktuara e cila mëparë konsiderohej si stabile dhe si një shembull i mirë i tolerancës ndër-etnike.

144. Në Prishtinën urbane, popullata pakicë mbetet shumë e vogël dhe nuk ka indikacione rreth çfarëdo kthimi të mundshëm aty. Përderisa ashkalinjtë shqipfolës janë në numër më të madh në kuadër të popullatës së mbetur, disa familje romë të izoluar gjithashtu janë vërejtur të jetojnë në këtë zonë. Liria e lëvizjes ende mbetet një problem mjaft serioz për ta, sidomos e atyre të cilët për nga pamja tregojnë të jenë rom. Romët dhe ashkalinjtë me lëkurën e tyre më të zezë janë veçanërisht në rrezik dhe do të mund të ballafaqohen me probleme të ndryshme të frikësimeve dhe keqtrajttimeve nëpër rrugët e Prishtinës. Njëri prej liderëve të shqiptarëve të Kosovës duke iu drejtuar pjesëmarrësve të një tryeze të rrumbullakët humanitare të mbajtur më 12 Prill, tha se duhet për të ardhur keq fakti se romët, të cilët për një kohë të gjatë ishin pjesë përbërëse e Prishtinës nuk shihen më nëpër rrugët e qytetit të angazhuar me bizneset e tyre. Shkalla e zhvendosjes të cilën e përjetuan si romët ashtu edhe ashkalinjtë gjatë largimit të tyre nga Prishtina ka qenë mjaft i madh ku si rrjedhojë e kësaj kemi një numër të madh të romëve të cilët jetojnë si refugjatë në IRJM apo si persona të zhvendosur në Mal të Zi, Serbi dhe në vetë Kosovën.

145. Kohëve të fundit, liderët e komunitetit ashkali kanë shprehur baza për optimizëm se mundësia e kthimit të tyre mund të shëndrohet në një realitet. Përderisa vetëm një familje është vërejtur se është kthyer me vetë-iniciativë nga IRJM-ja, përderisa të tjerët kanë shprehur interesimin se dëshirojnë të marrin pjesë në të astuquajturat vizita "shko dhe ik" pëkundër këtyre signaleve inkurajuese realiteti qëndron në atë se brengat e sigurisë dhe nevojat për rindërtim mbeten pengesa serioze për një kthim të mundshëm të tyre. Përderisa ashkalinjtë e mbetur jetojnë të shpërndarë nëpër shtëpitë e tyre që gjenden në qytet, sidomos lagja e banuar me ashkali e vranjevci ishte shkatërruar shumë keq si gjatë fushtaës së bombardimit ashtu edhe pas saj dhe nuk shihen shenja se refugjatët do të shprehin dëshirën e tyre për tu kthyer pa ndonjë zotim nga dikush rreth çështjes së rindërtimit të shtëpive të tyre, edhe nëse supozojmë se gjendja e sigurisë në ka arritur atë nivel sa që të lejojë një kthim të tyre. Seria e fundit e vizitave të bërë në shtëpitë e ashkalinjve të cilët ende jetojnë në qytet shërbeu si faktor për të nënvizuar problemet me të cilat ballafaqohet ky komunitet. Një familje edhe pse lëkurzëzë nuk ka dalur nga shtëpia pa përcjellje të forcave të sigurisë tash e një vit. Kjo ka ndodhur falë marrëdhënive të mira të tyre me fqinjët e tyre shqiptarë. Një anëtar i kësaj familje me dëshpërim përshkruajti përpjekjen e tij të pasukseshme për të marrur pjesë në marshin kundër dhunës më 9 shtator. Ai u kthye në shtëpi pasi që kishte ecur vetëm ca qindra metra, kur ishte ofenduar nga ana e disa të rinjve shqiptarë. Asnjë prej fëmijëve të kësaj familje nuk i ndjekin mësimet në shkollë, për shkak se prindërit e tyre janë të brengosur për sigurinë e tyre. Shtimi i fundit që ishte bërë në këtë familje, është foshnja një muajshe, e cila kishte lindur në spitalin e Prishtinës vetëm pasi e ëma e tij kishte siguruar përcjelljen e KFOR-it për në spital. Përkundrazi, tre familje të tjera të cilat u vizituan nga ne gëzojnë relativisht liri të mirë të lëvizjes me fëmijët e tyre të cilët shkojnë nëpër shkolla dhe me anëtarët e familjeve të tyre të cilët janë punësuar përkohësisht nëpër organizata ndërkombëtare. Llojllojshmëria në përvoja shërben për të nënvizuar kompleksitetin e problemeve me të cilat ballafaqohen romët dhe ashkalinjtë në disa prej lokacioneve urbane dhe tentojnë që të sugjerojnë që çështja e riatdhesimit nevojitet të shqyrtohet dhe studiohet gradualisht. Edhe nëse brengat për sa i përket strehimit të tyre mund të tejkalohen, pengesat të cilat i shkaktojnë keqtrajtimet dhe frikësimet mbesin ende.

146. Kemi poashtu popullatë rome e cila jeton në komunën e Prishtinës. Sipas vlerësimeve të fundit kemi një shifër prej 600 deri në 800 persona të cilët më së shumti jetojnë në enklavar serbe të Graçanicës, çagllavicës, perocit dhe fshatit Llap. Si të tillë ata ballafaqohen me probleme të sigurisë dhe kufizime në lirinë e lëvizjes sikur fqinjët e tyre serbë. Kemi raporte për marrëdhënie të përzemërta ndër-etnike në kuadër të komuniteteve të tyre. Megjithatë janë pranuar disa ankesa të cilat kanë të bëjnë me shpërndarjen e pabarabartë të ndihmës humanitare. Liderët e romëve theksojnë se për shkak se komuniteti i tij gëzon më pak qasje ndaj tokave të tyre se sa serbët, si rezultat i kësaj atyre duhet tu shpërndahet më shumë ndihma humanitare. Ekziston një numër i romëve të zhvendosur nga Prishtina të cilët përkohësisht janë të vendosur në Graçanicë. Këta të zhvendosur presin shumë pak rreth çështjes së kthimit nëpër shtëpitë e tyre në të ardhmen e afërt.
147. Popullata ashkali e cila jeton në qytetin e Podujevës, paralagjet e saj dhe fshatrat përreth, ka mbetur mjaft stabile. Vlerësohet të jenë prej 800 deri në 900 prej tyre. Kjo është rezultat i mekanizmave të përmirësuar monitorues dhe nga kthimet e tyre të një shkalle më të ulët. Gati të gjithë ashkalinjtë kanë mbetur nëpër shtëpitë e tyre përderisa disa të tjerë jetojnë si mysafirë nëpër shtëpitë e ta afërmeve të tyre. Situata e përgjithshme në këto anë mbetet e qetë, mirëpo prapsepapë u shënuan dy incidente të sulmeve me granata kundër shtëpive të ashkalinjëve gjatë muajve të verës. Liria e lëvizjes dhe qasja në shërbimet e caktuara në kuadër të komunës së Podujevës është e mirë mirëpo kjo nuk do të thotë që ata mund të udhëtojnë edhe mëtej. Kjo ka ndikim negativ në ashkalinjtë sidomos në aspektin e punësimit të tyre. Kemi një përfaqësim në këshillim komunal e cila siguron që ashkalinjtë të kenë një kanal nëpërmjet të cilit do të dëgjohet zëri i komunitetit të tyre. Në vazhdim, zhvillimi i OJQ-së vendore të quajtur shpresa demokratike ka qenë një instrument sidomos në nxitjen/ushqimin e një imazhi pozitiv për komunitetin si dhe kanë siguruar gjithashtu tërë përkrahjen e nmevojshme në formë të iniciativave shkollore për zanate të ndryshme. Zhvillime pozitive u shënuan edhe në njërin prej zonave rurale në komunën e Podujevës. Muaj të tërë të përpjekjeve intenzive me qëllim të nxitjes/ushqimit të dialogut ndër-etnik të cilat ishin përkrahur nga ana e bashkësisë ndërkombëtare patjetër se kishin dhënë rezultate të mira dhe atë për shkak të angazhimit të denjë të vendasve. 14 ashkalinjtë të zhvendosur ishin kthyer në fshatin e tyre në fund të gushtit me qëllim që të fillojnë punën rreth rindërtimit të shtëpive të tyre, pasi që e kishin kaluar gati një vit si të zhvendosur në një lokacion tjetër në Kosovë. Planifikohet që të rindërtohen 9 shtëpi të tilla dhe pasi që të është arritur kjo pritjet që grupa e mbetur e këtyre personave, gjithsejt 64 prej tyre, do të jenë në mundësi që kthehen në fshatin e tyre përgjithmonë. Deri më tani është arritur një përparim i kufizuar sa i përket rindërtimit të shtëpive dhe nuk është e sigurtë se a do të jetë një kthim i tillë i mundshëm para mbarimit dimrit apo jo. Për tu lavdëruar është edhe fakti se këtu kemi edhe një përkrahje të përgjithshme të popullatës vendore dhe një përfshirje praktike të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, të cilët do të jenë në gjendje që të përkrahin përpjekjet për rindërtim, të cilët faktorë në këtë rast kanë qenë mjaft esencial që kanë bërë të mundur këto të arritura gjer më tani. Përvoja e treguar në këtë vend nuk mund të jetë edhe shembull i cili do të mund të kopjohej diku tjetër.
148. Ende ekziston një numër i madh i popullatës ashkallike e cila jeton në Fushë Kosovë, ku në bazë të statistikave të fundit thuhet se janë rreth 2,500 prej tyre. Është shumë vështirë që të bazohemi në shifrat që i kemi në dispozicion për shkak se të dhënat e ofruara nga liderët e komuniteteve në fjalë ndryshojnë njëra prej tjetrës, si dhe për shkak të faktit se kohëve të fundit kemi pasur tyë bëjmë me lëvizje të popullatës nga dhe për në këtë vend. Fushë Kosova është një vend i cili ka mirëpritur një numër të madh të personave të zhvendosur nga vendet e tjera anembanë Kosovës, ku kohëve të fundit gjithashtu kemi pasur një kthim të kufizuar të refugjatëve nga IRJM. Ashkalinjtë tentojnë që të jetojnë të koncentruar në atë pjesë të qytetit e cila është disi e larguar nga qendra e qytetit. Në kuadër të vendbanimit ku jetojnë, ata gëzojnë një liri të duhur të lëvizjes të cilën nuk e gëzojnë në pjesën tjetër të qytetit. Këto kufizime ndikojnë seriozisht në mundësinë e komunitetit për të gjetur punë si dhe mundësinë për tu integruar në jetën e përditshme. Situata e përgjithshme e sigurisë për ashkalinjtë mund të thuhet se ishte qetë me një apo dy incidente të shënuara. Është shënuar një përparim i dukshëm kohëve të fundit për sa i përket integritet të fëmijëve ashkalinjë në sistemin shkollor vendor. Që nga fillimi i vitit shkollor në shtator të ketij viti, fëmijët ashkalinjë kanë pasur mundësi që ti ndjekin mësimet e tyre nëpër shkolla së bashku me fëmijët shqiptarë. Ky

është një zhvillim i cili duhet mirëpritur dhe meritë e përpjekjeve të UNICEF-it dhe të tjerëve në ofrimin e ndihmës për sa i përket ndjekjes së mësimave nga ana e nxënësve ashkalinjë. Për shkak të problemeve të cilat ishin rezultat i keqtrajtimit dhe ndjekjeve që iu bëheshin nxënësve ashkali, prindërit e të dyja komuniteteve u zotuan se duhet ruajtur linjën e mbajtjes së dialogjeve konstruktive ndërmjet të dyja këtyre komuniteteve dhe vazhdimin të përpjekjeve të cilat do të mundësojnë që të gjithë fëmijët të ndjekin mësimet e tyre nëpër shkolla pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike.

149. Vetëm një numër i vogël i romëve dhe ashkalinjëve, më pak se 100 prej tyre, arritën të qëndrojnë në qytezën e Obiliqit. Përkundër faktit se janë bërë mjaft përpjekje në nivel të komunës me qëllim të arritjes tek familjet e zhvendosura të cilat jetojnë në strehimoren për të zhvendosur në plemetin, nuk është arritur ndonjë përparim i dukshëm në këtë drejtim. Romët dhe ashkalinjtë, së bashku me grupet e tjera etnike ballafaqohen me një qëndrim mjaft armiqësor të cilin popullata shumicë shqiptare e ka ndaj tyre. Një dukuri e shprehur këtu është keqtrajtimi i vazhdueshëm që i bëhet pjesëtarëve të këtyre komuniteteve me qëllim të shitjes së shtëpive të tyre.
150. Në pjesën tjetër të komunës së Obiliqit, kemi një numër të vogël të romëve dhe ashkalinjëve të cilët jetojnë në fshatrat Crkvena Vodice dhe Plemetinë. Një koncentrim më i madh i popullatës romë në këto anë mund të vërehet në strehimoren për persona të zhvendosur në plemetin (koncentrim ky paksa më i madh se në vetë fshatin e plemetit). Statistikat e fundit rreth popullatës që jeton në këto anë sillen prej 700 deri në 800 persona. Në krahasim me shifrën 890, shifër kjo e matur në janar të këtij viti, duket se numri i popullatës ka rënë paksa sidomos pas renovimeve të bëra në barrakat e kësaj strehimoreje ku një pjesë e personave të zhvendosur u detyruan të transferohen në tentat e vendosura në Krushevc. Oshilimet në numrin e popullatës mund ti ngarkohen një sërë faktorëve siç janë edhe zhvendosjet e popullatës të cilat ishin rezultat i shkuarjeve të një pjese të kësaj popullate për në Serbi dhe gjetiu, për shkak të frustrimit të tyre e cila ishte rrjedhojë e një përparimi jo të mjaftueshëm për sa i përket çështjes së kthimit të tyre nëpër vendet e tyre të origjinës. Në të njëjtën kohë një numër i vogël i personave kishin ardhur në strehimoren për persona të zhvendosur, disa për shkak se bashkoheshin me pjesën tjetër të familjes e disa të tjerë për shkak se vendoseshin aty nga ana e UNHCR-së . Këta në fund të fundit janë persona të cilët janë deportuar nga vendet evropere ndimore me thujse kurrfarë gjasash për tu kthyer në vendet e tyre të origjinës, nën kushtet të cilat mbizotërojnë sot në vend. Edhe pse janë bërë përpjekje të mëdha rreth përmirësimit të kushteve të jetesës për banorët e kësaj strehimoreje, kjo strehimore ende mbetet një vend i izoluar dhe i mbrojtur i cili ofron zgjidhje të përkohshme për të zhvendosurit. Vlen të përmendet këtu se në kuadër të kampit kemi parë edhe iniciativa joformale për mbajtjen e procesit mësimor, iniciativa këto mjaft të qëlluara. Si rezultat i kësaj shumica e fëmijëve të këtyre komuniteteve janë duke i ndjekur mësimet në nivelin e arsimin fillor, dhe pritet se ata fëmijë të cilët do ti japin provimet e tyre me sukses do të pranojnë një njohje zyrtare për të arriturat e tyre nga ana e departamentit për arsim të UNMIK-ut. Në vazhdim patëm rastin të shohim se ata të cilët nxitën këtë ide në kuadër të vetë popullatës së zhvendosur pranuan mësimet nga ana e mësuesve profesionalë, me qëllim të përmirësimit të aftësive të tyre për tu përfshirë në mënyrë aktive në procesin e përmirësimit të nevojave për arsimim të komuniteteve të tyre.
151. Deri më tani vetëm një numër i caktuar i familjeve kishin arritur që të kthehen nëpër vendet e tyre të origjinës. Situata e sigurisë së bashku me mungesën e ndihmës së dhënë për rindërtim vazhdojnë të jenë pengesat kryesore të cilat do ti nxitnin këta persona që me gjithë dëshirë ta lëshojnë kampin dhe të kthehen nëpër shtëpitë e tyre. Si një zhvillim mjaft pozitiv vlen të përmendet edhe fakti se agjencioni zviceran për zhvillim dhe kooperim u pajtua që të të fillojë me renovimin e disa prej shtëpive pronë të ashkalinjëve në komunën e Fushë Kosovës, veprim ky i cili do të hap rrugën për një kthim të mundshëm të një numri të familjeve nga kampi në plemetin për në vendet e tyre të origjinës. Disa familje veç kanë pranuar një ndihmë të tillë, dhe si rezultat i kësaj ata kanë zgjedhur që ta lëshojnë kampin për tu kthyer nëpër shtëpitë e tyre.
152. Në qytezën e Lipjanit jetojnë rreth 600 pjesëtarë të komunitetit rom dhe atij ashkali. Gjetiu në komunën e Lipjanit, ashkalinjtë dhe romët janë më shumë të koncentruar në fshatrat siç janë Janjeva, Hallaçi i Vogël. Medveçë dhe Vërshec. Numri i përgjithshëm i

popullatës duke përfshirë këtu edhe popullatën e cila jeton në zonat urbane, vlerësohet të jetë rreth 1,500 prej tyre, mirëpo prapsepapë është tejet vështirë që të përcaktohet saktësisht për shkak të faktit se kemi të bëjmë me një shkallë të ndryshueshme të integritit të tyre në shoqëri dhe fakt tjetër është se disa seksione të këtyre komuniteteve e identifikojnë vetveten me grupe të tjera etnike duke i rezistuar tezës se janë pakica kombëtare. Turniri ndër-etnik i futbollit i përkrahur nga stafi lokal i UNHCR-së dhe OSBE-së të cilët kishin vepruar me iniciativë të tyre rreth organizimit të saj, u tregua si një arritje e madhe në marrjen pjesë së bashku të ekipeve të fëmijëve të përkatësive të ndryshme etnike në një ngjarje sportive të papërllyer me çfarëdo ngjyre të tensioneve ndër-etnike. Iniciativat e tilla meritojnë vëmendje të veçantë dhe çdo lëndatë, për shkak se ofrojnë dëshmi konkrete për faktin se, përkundër vështirësive të cilat janë prezente sot, prapsepapë ekziston një vullnet i mirë në nivelin lokal për të kultivuar tolerancë dhe bashkëpunim ndërmjet komuniteteve të ndryshme etnike. Hapat e tillë janë mëse të nevojshëm për të ofruar alternativa të cilat mundësojnë thyerjen e ciklit të pazvogëluar të dhunës i cili ka ndikim serioz në komunitetet minoritare. Një numër i incidenteve serioze kishin ndodhur në këtë komunë gjatë periudhë kur jemi duke raportuar, nga të cilat më tragjika ishte vrasja e tre ashkalinjëve në fshatin hallaç i vogël më 2 Gusht. Ata u vranë gjatë shpërthimit të një pajisjeje të improvizuar eksplozuese të montuar në afërsi të shtëpisë së tyre. Përkundër këtij incidenti popullata vazhdon me përpjekjet e saj për mbajtjen e fqinjëve shqiptarë për sa i përket çështjes së kthimit të personave të zhvendosur të këtij komuniteti dhe integrimin e fëmijëve të tyre nëpër shkollat vendore. Një incident tjetër i cili kishte ndodhur më 14 shtator, gjatë së cilit ishte plagosur një person i nacionalitetit ashkali, prapë si pasojë e shpërthimit të një pajisjeje të improvizuar eksplozuese, incident ky i cili i kishte minuar në mënyrë serioze përpjekjet e deritanishme për përmirësimin e situatës. Komuniteti rom i cili jeton në janjevë numëron mëse 200 persona, ka mbetur stabil. Gjatë muajve të fundit nuk ishte shënuar ndonjë incident serioz në këto anë.

153. Popullata rome e cila jeton në Mitrovicë është e koncentruar më shumë në veri të lumit ibër dhe përbëhet nga 275 persona të zhvendosur, shumica e të cilëve vijnë nga lagjet e romëve që ndodhen në pjesën jugore matanë lumit, e cila lagje ishte shkatërruar plotësisht gjatë periudhës së pasluftës. Ky grup i personave të zhvendosur ishin strehuar së pari në vendbanimin me tenda në zitkovac mirëpo që nga janari i këtij viti këta persona ishin ri-strehuar në njësitë e prifabrikuara që ndodhen në pjesën urbane të veriut të Mitrovicës. Edhe përkundër marrëdhënieve të mira që i kanë me fqinjët e tyre serbë, ky komunitet ende ballafaqohet me probleme të ndryshme. Këta persona nuk kanë qasje në punësim dhe janë tërësisht të varur nga ndihma humanitare. Raportet e fundit që vijnë për fëmijët rom të cilët keqtrajtohen nga ana e fëmijëve serbë, situatë kjo e cila kishte rezultuar me një rënie dramatike të numrit të fëmijëve romë të cilët i ndjekin mësimet e tyre nëpër shkollat e atjeshme, ku 10 prej tyre sapo ishin regjistruar në shkollat përkundër numrit prej 75 prej tyre të cilët ishin regjistruar mëparë. Sulmi me granatë i cili kishte ndodhur kundër kampit të zhvendosurve më 30 qeshor, e cila si pasojë la 4 pjesëtarë të këtij komuniteti të lënduar duke përfshirë një fëmijë i cili ishte dashur ti nënshtrohej operacionit të kirurgjisë. Motivi për këtë sulm kur nuk ishte zbuluar dhe askush nuk ishte arrestuar në lidhje me këtë rast. Ky kamp, i cili është ngjashëm me atë në Plemetin, ofron zgjidhje të përkohshme për personat e zhvendosur. **Diskutimet ndërmjet të akterëve të ndryshëm** të cilat kishin qenë duke u mbajtur gjatë muajve të fundit në lidhje me mundësinë e themelimit të një strehimoreje të përkohshme në jug të lumit ibër. Një strehim i tillë në formë të të njëjësive të prifabrikuara të themeluara në afërsi të shtëpive të këtyre personave të zhvendosur do të paraqes hapin e parë drejt procesit i cili do të na shpiente në formimin e lagjes së re të romëve. Një zhvillim i tillë do të ishte tejet e dobishme për të zhvendosurit të cilët momentalisht jetojnë në veri të lumit ibër, për ata të cilët janë të zhvendosur në Zveçan dhe Leposaviq si dhe për ata të cilët janë të zhvendosur jashtë Kosovës. Interesimi i personave të zhvendosur rreth kësaj çështjeje u dëshmua qartë pas pjesëmarrjes së tyre në një numër të vizitave “shko dhe ik” me qëllim të vlerësimit të zbatueshmërisë së këtij plani. Përkundër përkrahjes së dhënë nga vetë komuniteti vendor, patëm rastin të shohim edhe një përkrahje të fuqishme të dhënë nga ana e akterëve ndërkombëtar siç janë UNHCR-ja, duke përfshirë edhe identifikimin e donatorëve të mundshëm të cilët janë të gatshëm të angazhohen rreth dhënies së fondeve të mjaftueshme të cilat do të mbulonin nevojat e strehimit gjatë fazës fillestare të projektit, prapsepapë problemi i sigurisë mbetet një pengesë e dukshme. KFOR-i kishte bërë me dije se për shkak të kufizimeve në personel ata nuk do të jenë në pozitë të rrisin masat e sigurisë të cilat parashihen të jenë një kërkesë esenciale për fillimin e

mbarëvajtshëm të këtij projekti dhe atë nën rrethana të sigurisë dhe dinjitetit për personat e zhvendosur të përfshirë në këtë projekt. Ky mossakses erdhi si goditje për përfituesit e mundshëm të cilët ndalngadalë mirëpo me hapa të sigurtë kishin larguar mënjane frikën e tyre fillestare dhe gjithashtu shtyri që të dyshohet në zbatueshmërinë e këtij projekti i cili paraqet një zgjidhje realiste për nevojat e tyre afatgjate.

154. Popullata e vogël e ashkalinjëve numëron rreth 170 persona të cilët janë të koncentruar më shumë në jug të Mitrovicës. Kemi edhe një komunitet të vogël të përbërë vetëm nga disa familje i cili është i koncentruar në veri të lumit ibër. Përderisa komuniteti i cili jeton në pjesën jugore të qytetit ka edhe përfaqësuesit e tij politik dhe ekziston një bashkëveprim pozitiv të tyre me grupet e tjera etnike, ende pranojmë raste ku pjesëtarët e këtij komuniteti vazhdojnë të raportojnë probleme rreth pranimit të tyre nga pjesa tjetër e shoqërisë. Ende vërehen raste të keqpërdorimeve të cilat raportohen nga pjesëtarët meshkuj të këtij komuniteti, të cilat kufizojnë lirinë e lëvizjes së tyre dhe mundësinë për të gjetur punë.
155. Sipas vlerësimeve të dhëna nga lideri i komunitetit në fjalë në Leposaviq, numri i popullatës së përgjithshme të strehuar në qendrën kolektive për të zhvendosur qëndron rreth shifrës 190. Shifrat për numrin e popullatës oshilojnë në mënyrë konstante për shkak të udhëtimeve të tyre për në Serbi dhe Mal të Zi. Popullata e kësaj qendre përbëhet më së shumti nga romët e zhvendosur prej pjesës jugore të Mitrovicës. Gjithashtu në këtë qendër kemi edhe egjiptas dhe ashkalinjë të zhvendosur nga rajonet e tjera të Kosovës. Shikuar nga ana e përgjithshme të zhvendosurit e tillë janë të pranuar mirë nga ana e fqinjëve të tyre serb të Kosovës dhe si rezultat i kësaj ata janë në gjendje të qasen shërbimeve mjekësore nëpër objektet vendore shëndetësore. Qasja ndaj shkollimit mbetet ende një problem për shkak se disa prej fëmijëve të këtyre komuniteteve konsiderohen se nuk flasin një Serbishte të mjaftueshme në mënyrë që të jenë në gjendje të ndjekin mësimet e tyre nëpër shkollat vendore. Për këtë arsye shumë nxënës detyrohen që të udhëtojnë për në Mitrovicë, me përkrahjen e dhënë nga ana e OJQ-ve, duke i ndjekur mësimet në për shkolla serbe të udhëhequr nga mësues me përvojë të përgjithshme në dhënien e mësimeve për fëmijët romë.
156. Në komunën e Zveçanit, ish kampi për të zhvendosur në Zitkovac është ballafaquar me një rritje të popullsisë në kuadër të saj si rezultat i ardhjeve të romëve të zhvendosur nga Mali i Zi. Këta njerëz janë duke u kthyer në një situatë të zhvendosjes në Kosovë. Janë rreth 144 persona të cilët jetojnë në tenda me gjasa të vogla për tu kthyer në vendet e tyre të origjinës në Kosovë në planin afatshkurtë. Fëmijët e këtij komuniteti janë në gjendje që të ndjekin mësimet në shkollën e Zveçanit, përderisa pjesa tjetër e komunitetit ballafaqohet me një qëndrim pozitiv dhe përkrahës që kundrejt tyre e kanë fqinjët e tyre serbë. Duhet shikuar rreth gjetjes së një alternative tjetër për strehimin e këtyre personave para fillimit të dimrit.
157. Numri i ashkalinjëve të mbetur në Vushtri ka mbetur stabil, numër ky i cili silltet rreth shifrës prej 130 personave. Edhe pse numri i incidenteve serioze të ndodhura në këto anë është zvogëluar drastikisht, ende kemi raste kur këta persona iu nënshtrohen keqtrajtimit gojorë, gjuajtjes me gurë, dhe vjedhjes së bagëtisë. Përpos vështirësive me të cilat ballafaqohen këta njerëz, ata prapëprapë insistojnë se ekziston nevoja për kthimin e personave të zhvendosur të komunitetit të tyre nga Serbia dhe gjetiu. Nuk ka gjasa se një gjë e tillë mund të ndodhë së shpejti, për shkak se okupimi ilegal i pronave të ashkalinjëve është një çështje e cila është në shqyrtim e sipër. Me qëllim të marrjes me këtë problem, një OJQ ndërkombëtare kishte iniciuar diskutimet me shqiptarët e Kosovës rreth gjurmimit të mundësive për dhënien e ndihmave shqiptarëve të Kosovës për rindërtimin e shtëpive të tyre me qëllim të lirim të pronave të ashkalinjëve. Linjat e tilla të komunikimit janë pjesë e një procesi të përgjithshëm të dialogut dhe si e tillë është mjaft e vlefshme. Megjithatë kujdesi i veçantë për këto komunitete duhet të jetë një parim udhëzues në këtë aspekt. Sulmi i fundit me granatë kundër komunitetit ashkali i cili ndodhi në maj të këtij viti, si duket ky akt kishte qenë një hakmarrje kundër debimit të një familjeje shqiptare me qëllim të kthimit të një familjeje ashkallike. Një gjë është e qartë këtu se situata në të cilin jeton ky komunitet është ende e tensionuar dhe çdo hap përpara në këtë drejtim kërkon maturi të veçantë. Në ndërkohë në fshatin prilluzhje, fshat ky me popullatë të përzier, komuniteti rom ende vuan për shkak të lirisë së kufizuar

të lëvizjes. Megjithatë popullata e kësaj ane ka mbetur stabile me rreth 160 persona që jetojnë aty.

158. Në komunën e Skenderajit vlerësohet të jetojnë një numër i vogël i familjeve ashklike. Në një fshat me popullatë të përzier, popullata e paraluftës me rreth 120 persona të nacionalitetit ashkali nuk pati mundësi që të kthehet në ato anë dhe andaj vendosi që të mbetet edhe për një kohë si e zhvendosur gjetiu nëpër vendbanimet e tjera në Kosovë. Kohëve të fundit vërehen disa indikatorë inkurajues të cilët dëftojnë për interesimin e shprehur nga ana e disa familjeve për tu kthyer nëpër shtëpitë e tyre. Këto familje sapo i kishin kryer disa vizita nëpër shtëpitë e tyre me vetëiniciativën e tyre. Një OJQ kishte shprehur interesimin e saj në dhënien e ndihmës për rindërtimin e disa shtëpive të ashkalinjëve që jetojnë aty. Kjo mund të nxis dëshirën e tyre për tu kthyer, dëshirë kjo e cila mund të shëndrrohet në realitet, së paku për një numër të vogël të këtyre familjeve.
159. Në **Urosvac/Ferizaj numri i ashkalinjëve që jetojnë** në këto anë ka mbetur stabil me një numër prej 4,200 personave të cilët jetojnë kryesisht në tre prej lagjeve të zonës urbane të qytetit dhe pjesa tjetër e cila jerton në fshatin e populluar kryesisht nga ashkalinjtë të quajtur dubrava/lisnaje. Ashkalinjtë që jetojnë në këto zona kanë një përfaqësim mjaft të fortë politik, të cilët karakterizohen të kenë lidhje të forta me komunitetin e shqiptarëve të Kosovës. Në fakt shumica e ashkalinjëve e konsiderojnë vetën të jenë shqiptarë duke e hedhur poshtë nocionin e çfarëdo shoqërimi të tyre me komunitetin rom. Vizitën të cilën anëtarët e këshillit të përkohshëm administrativ ja bënë Ferizajit, më 7 qeshor, duke i përsëritur edhe njëherë zotimet e tyre të shprehura në platformën për veprim të përbashkët, ishte pranuar mjaft mirë nga ana e komunitetit rom dhe atij ashkali. Ana e mirë e kësaj vizite ishte se incidentet e sigurisë kishin rënë paksa. Megjithatë pas një kohe ato ishin paraqitur përsëri. Përderisa disa ashkalinjë kishin pasur mundësi që të kthehen në Ferizaj, të tjerët detyroheshin që ti nënshtrohen presionit të vazhdueshëm për shkak të keqtrajtimit që ubëheshin atyre si rezultat i sulmeve fizike të kohëpaskohshme të cilat kryheshin kundër tyre dhe incidenteve zjarrvënëse. Përpos këtyre vështirësive liderët e komunitetit ashkali mbeten optimist për sa i përket stabilizimit të gjendjes së sigurisë, ku si rezultat i kësaj pritet të kemi një kthim të mëtutjeshëm të këtyre personave. Gjithashtu kemi vërejtur edhe një interesim të shprehur nga ana e disa refugjatëve që jetojnë në IRJM për të kryer disa vizita “shko dhe shiko” nëpër shtëpitë e tyre, ide kjo e cila është duke u përkrahur në mënyrë aktive nga ana e UNHCR-ja. Lidërshipi i komunitetit ashkali deklaroi se ekziston një prezencë e shprehur e ashkalinjëve në rajon, për të cilën bashkësia ndërkombëtare nuk ka njohuri të mjaftueshme, për shkak se shumica e tyre e identifikojnë vetveten si shqiptarë. Ende ekziston nevoja për pëerpjekje të koncentruara në këtë drejtim me qëllim të rritjes së shkallës së fëmijëve rom dhe ashkali të cilët i ndjekin mësimet nëpër shkollat vendore. Kësaj çështjeje i është dhënë rëndësi në mënyrë aktive nga ana e OSBE-së dhe për këtë arsye ende ka hapësirë për përparim në këtë drejtim.
160. Romët e Ferizajit, përkundrazi janë ballafaquar me një përkeqësim serioz/akut të situatës së sigurisë. Ata janë të izoluar prej komunitetit ashkali të cilët nuk ndiejnë ndonjë afërsi ndërmjet njëri tjetrit dhe tentojnë të fajësojnë romët për gjendjen e keqësuar të sigurisë duke theksuar se ata janë më shumë shënjestra të sulmeve sesa vetë ashkalinjtë, të cilët më shumë janë zënë në kurth të dhunës për shkak të fatkeqësisë se konsiderohen gabimisht të kenë lidhje me romët. Numri i romëve që jetojnë në këto anë është zvogëluar në masë të konsiderueshme. Shifra e cila sillet prej 300 deri në 500 tani është zvogëluar dukshëm. Derisa një lagje e Ferizajit e cila ishte vendqëndrim i rreth 30 familjeve romë në fillim të vitit, tani strehon vetëm 6 familje të mbetura. Të tjerët ishin detyruar që të shesin shtëpitë e tyre me një çmim i cili ishte më i ulët sesa vlera e vërtetë e saj e cila sillet në treg. Ata ishin të detyruar ta bëjnë një gjë të tillë për shkak të gjendjes së keqe të sigurisë. Pritet që edhe familje të tjera ta lëshojnë vendin në planin afatshkurtë dhe atë afatmesëm përpos nëse shohim një përmirësim të dukshëm në gjendjen e sigurisë.
161. Në qytetin e Gjilanit, popullata e deritanishme kishte pësuar rënie të dukshme edhe mëtej, me një numër prej tyre i cili numëron rreth 330 persona në krahasim me shifrën prej disa mijërave të cilët jetonin para konfliktit aty. Përderisa shumica e romëve kishin lëshuar vendin si rezultat i një shkalle të lartë të dhunës e cila ishte mëse prezente verën e kaluar dhe zvogëlimi i dukshëm i popullatës romë në vetëm dhjetra prej tyre, kjo është shumë e rëndësishme sidomos për një komunitet i cili është pakësuar dramatikisht në

numër dhe që është e detyruar të jetojë në rrethana të shtetrrrethimit duke mos qenë të sigurtë se çka i pret e nesërmja. Njëri prej liderëve të komunitetit rom kishte shkuar për ti vizituar refugjatët e vendosur në IRJM të cilët origjinojnë nga komuna e Gjilanit me qëllim të diskutimit të problemeve me të cilat ata ballafaqohen. Përderisa lideri në fjalë ishte shprehur optimist për sa i përket faktit se ka mundësi strehimi në kuadër të kuartit rom në të cilin do të integroheshin disa prej familjeve të kthyer nga maqedonia nën rrethana më miqësore të cilat do të mbizotëronin aty, gjatë së cilës ai ishte gjithashtu edhe i sqartë dhe i hapur për sa i përket faktit se problemet e sigurisë janë ende prezente, duke potencuar edhe një fakt tjetër se liria e lëvizjes thuhet nuk ekziston. Refugjatët ishin të vetëdijshëm për faktin se kishte ndodhur një tentim zjarrvënjeje në një shkollë romë në Gjilan, një sulm i cili kishte ndodhur disa ditë para vizitës së bërë nga ana e këtij lideri më 20 shtator. Ata shprehën mirëseardhje për vizitën e bërë dhe falenderim për mundësinë e marrjes së informatave të përshtatshme nga dora e parë, mirëpo është e natyrshme fakti se pse ata kishin rezervë ndaj gjasave për kthimin e tyre nën kushtet e sotshme. UNHCR-ja tenton të kryejë edhe mëtej vizita të tipit "shko dhe shiko" dhe pritet që disa prej refugjatëve të strehuar në IRJM të shprehin interesimin e tyre për të marrur pjesë në këtë program me qëllim të vizitimit të shtëpive të tyre dhe vlerësimit të situatës atje. Indikacionet e kohëve të fundit bëjnë me dije për një numër të vogël të romëve të kthyer me vetëiniciativë.

162. Një problem tjetër me të cilin ky komunitet detyrohej u detyrua të ballafaqohej ishte pamundësia e tyre për të paguar llogaritë e shpenzimeve komunale. Edhe pse shumica e familjeve që jetojnë në këto anë kanë aplikuar për tu përjashtuar nga pagimi i këtyre shërbimeve nën projektin e përbashkët mbi këtë çështje, ata ende nuk janë njoftuar për faktin se a janë pranuar apo jo. Në ndërkohë kompania për furnizim me energji elektrike, KEK-u, është përpjekur dy herë radhazi që t'ua ndërpres furnizimin me energji elektrike këtyre personave duke theksuar se nuk mund të presin më për ndonjë vendin mbi këtë çështje. Intervenimi i KFOR-it në lidhje me këtë çështje kishte parandaluar aktin e ndërprerjes së rrymës elektrike për këta persona, mirëpo pritet që problemet e tilla të dalin në shesh përsëri për shkak se projekti do të funksionojë deri në mars të vitit të ardhshëm dhe mu për këtë shkak këta persona do të jenë në pamundësi që ti shlyejnë borxhet e tyre në të ardhmen. Llogaritë për shpenzimin e energjisë elektrike deri më tani kanë qenë të shtypura vetëm në gjuhën shqipe dhe atë angleze, përderisa shumica e pjesëtarëve të këtij komuniteti flasin vetëm në gjuhën serbe. Deri më sot llogaritë nuk janë shpërndarë fare, mirëpo njerëzve u është treguar një libër i cili tregon konsumimin e energjisë elektrike deri në atë moment. Njëri prej liderëve të këtij komuniteti kishte pranuar rradhazi llogaritë të cilat indikonin për një zero konsumim të energjisë elektrike deri në qeshor të këtij viti, ku mëpastaj po i njëjti person ishte informuar nga ana e KEK-ut se llogaria e tij e akumuluar është 1,100 DM, e cila shumë është përafërsisht e barabartë me 10 pagesa të ndihmës sociale dhe atë në shkallën më të lartë të kësaj pagese.
163. Në lokacionet e tjera të cilat ndodhen në rajonin e Kosovës Lindore, ende kemi një numër të vogël të romëve të mbetur në ato anë mirëpo prapsepapë shifrat për popullatën vazhdojnë të oshilojnë edhe më tutje për shkak të lëshimeve të vendit nga disa dhe ardhjes në shkallë të vogël nga të tjerët. Në qytetin e Vitisë kemi një numër të romëve të mbetur aty i cili silltet rreth shifrës prej dhjetëra sish, mirëpo më tutje ishte vërejtur një riatdhesim spontan i disa familjeve romë nga bosnja si dhe interesimi i shprehur nga ana e disa familjeve të refugjatëve të strehuar në ijm për të vizituar shtëpitë e tyre. Qyteza e Vitisë vazhdon të mbetet një zonë e ndryshueshme për sa i përket shkallës së dhunës e cila kryesisht është e drejtuar kundër serbëve të mbetur. Romët janë mjaft të kujdesshëm për sa i përket mundësive për kryerjen e sulmeve kundër tyre e cila gjë parandalon çfarëdo kthimi të mundshëm të pjesëtarëve të këtij komuniteti. Në Shtërpce, jetojnë gjithsej 34 romë të përqëndruar në tërë komunën. Përderisa një familje ishte kthyer nga Serbia, numri i përgjithshëm i tyre mbeti i pandryshueshëm për shkak të lëshimit të Kosovës nga ana e disa familjeve të tjera. Duke iu referuar çështjes së ndihmës humanitare, liderët serbë në shtërpce kishin theksuar se romët trajtohen njësoj si pjesa tjetër e komunitetit që jeton atje, mirëpo informuan se një shtëpi romë ishte djegur për shkak të faktit se ajo familje romë kishte kultivuar ndjenja pro-shqiptare. Në Kamenicë vlerësohet të kenë mbetur rreth 450 romë, të përqëndruar në vetë qytetin e Kamenicës dhe të tjerët të cilët jetojnë në fshatrat me popullatë të përzier shqiptare dhe romë të cilat gjenden përreth. Në Novo Bërdë

komuniteti i vogël rom i cili jeton në Bostane/Bostan, e cila mëparë është vlerësuar të jetë rreth 50 persona, është zvogëluar edhe mëtej për shkak të shkuarjes së dy familjeve rome.

164. **Në qytezën e Shtimjes, komuniteti ashkali** ishte ballafaquar me një përkeqësim serioz të situatës së sigurisë në atë vend. Vlerësohet se komuniteti ashkali në këtë zonë numëron rreth 400 persona numër ky paksa i shtuar për shkak të disa kthimeve në masë të vogël. Megjithatë gjatë muajit Qeshor, një familje e cila ishte kthyer spontanisht nga IRJM-ja, u detyrua ta lëshoi Shtimjen për herë të dytë për shkak se i ishte nënshtruar një sulmi me granatë kundër tyre. Raste të sulmeve të ngjashme vazhduan të ndodhin gjatë tërë muajve të verës. Disa prej këtyre sulmeve të cilat kishin ndodhur kohëve të fundit veçanërisht kishin në shënjestër një familje të tërë të cilët u detyruan ta lëshojnë vendin në fillim të Shtatorit si rezultat i gjithë kësaj. Komuniteti i mbetur ashkali kishte shprehur optimizëm për sa i përket çështjes së stabilizimit të situatës së sigurisë, tani pasi kjo familje e kishte lëshuar vendin, duke deklaruar në fund se ata nuk janë në ndonjë rrezik të dukshëm. Frekuenca me të cilën sulmet e tilla ndodhnin, kishte rënë paksa mirëpo nuk kishte pushuar tërësisht. Kishte edhe sulme me granata mbi shtëpitë e ashkalinjëve në qytet më 27 shtator dhe 18 tetor. Duke bërë me dije në mënyrë të qartë se situata mbetet ende e ndieshme. Numri i ashkalinjëve gjetiu nëpër komunën e Shtimjes ka rënë paksa mirëpo besohet se kjo nuk ka të bëjë aq shumë me shkuarjet e familjeve nga ky vend sesa me faktin se disa pjesëtarë të këtij komuniteti preferojnë ta identifikojnë më shumë veten si shqiptarë.
165. Në Prizren popullata rome mbetet stabile dhe momentalisht vlerësohet se në këtë vend të jetojnë rreth 4,500 pesona apo më shumë. Romët gëzojnë një liri paksa të mirë të lëvizjes në kuadër të zonës urbane të kësaj komune me një apo dy incidente të ndodhura kundër popullatës rome e cila jeton në zonën urbane të kësaj komune. Megjithatë, një burrë rom ishte gjetur i rrahur për vdekje në afërsi të fshatit landovicë në fund të gushtit. Kishte edhe incidente të tjera zjarrvënëse kundër shtëpive rome e cila është lidhur më shumë me faktin e shfrytëzimit të pronave të lëshuara për rindërtim ilegal tokën e asaj prone. Anëtarët shqiptarë të KPA-së kishin vizituar Prizrenin më 7 qeshor duke iu përmbajtur aktiviteteve të platformës për veprim të përbashkët. Kjo vizitë ishte mirëpritur nga ana e komunitetit rom.
166. Të dyja komunitetet si romët ashtu edhe egjiptasit vazhdojnë që të jetojnë në Rahovec në afërsi të enklavës serbe e cila gjendet në ato anë. Popullata e tanishme në këtë zonë vlerësohet të jetë 450. Kjo popullatë ende vazhdon që të ballafaqohet me një situatë tejet tensionuar. Në fund të gushtit, ishin gjetur trupat e pajetë të dy romëve në afërsi të fshatit Malësi e Vogël të komunës së Rahovecit. Nuk u arrit që të merret vesh për motivin me të cilin ishin kryer këto vrasje, si dhe askush nuk ishte arrestuar në lidhje me këtë incident. Në natën e 28 shtatorit patëm rastin të shohim një zjarrvënie në një shtëpi rome liria e lëvizjes mbetet ende e kufizuar dhe në masë të madhe e varur nga shërbimet e autobusëve të UNHCR-së. Megjithatë, u vërejtën edhe ca zhvillime të tjera pozitive. Në këshillin komunal kemi edhe një përfaqësues të komunitetit rom i cili merr pjesë edhe në tryezat e rrumbullakëta të mbajtura në mes të grupeve të ndryshme etnike. Ai kohëve të fundit kishte marrur pjesë në një mbledhje ndërmjet përfaqësuesve të komuniteteve rome, ashklike dhe egjiptase të mbajtur në Prishtinë dhe krerëve të departamenteve të spha-ve (JIAS), në të cilin takim përcjelli brengat e sigurisë me të cilat ballafaqohet komuniteti rom dhe ai egjiptas. Në qendër për punë sociale e organizuar nga gratë rome u kishte mundësuar grave rome që të diskutojnë për problemet të cilat i brengosin. Një grua rome e përfshirë në këtë iniciativë gjithashtu kishte marrur pjesë edhe një mbledhje të mbajtur me zyrtarët e UNMIK-ut të mbajtur në Prishtinë më 25 shtator. Si fëmijët rom ashtu edhe ata egjiptas kanë përfituar nga puna e qendrës baltazar për fëmijë, një iniciativë e OJQ-së e përkrahur nga UNHCR-ja e cila ka qasje në fëmijët e të gjitha grupeve etnike.
167. Në komunën e Deçanit jetojnë prej 350 deri në 400 romë dhe egjiptas të cilët janë të shpërndarë në një sërë fshatrash. Shumica absolute e pjesëtarëve të këtij komuniteti e identifikojnë vetveten si egjiptas të cilët për gjuhë amtare e kanë gjuhën shqipe e cila iu mundëson relativisht një bashkëveprimi më të lehtë me fqinjët e tyre shqiptarë. Është vërejtur një përmirësim i dukshëm në lidhje me pranimin e egjiptasve nga popullata e shqiptarëve të Kosovës. Liderët lokal të shqiptarëve të Kosovës kanë shprehur vullnetin e mirë për të diskutuar në lidhje me nevojat e kësaj grupe minoritare. Shumë egjiptas



ishin zhvendosur nga kjo komunë gjatë konfliktit dhe nuk ishin kthyer përsëri për shkak se shtëpitë e tyre ishin shkatërruar. Vënia në dispozicion e ndihmës për rindërtim është mjaft e kufizuar. Një grup reprezentativ lokal, e cila është organizata shqiptaro-egjiptase ka iniciuar procesin e vlerësimit të dëmeve të luftës dhe shtëpive të shkatërruara, në mënyrë që të gjejnë ndihmë adekuate për rindërtim. Një përgjegje e dhënë për përmbushjen e nevojave të këtyre personave nga ana e bashkësisë ndërkombëtare mund të hap rrugën për një kthim të mundshëm të tyre.

168. Në komunën e Gjakovës jetojnë rreth 6,700 rom dhe egjiptas të cilët kanë mbetur në këto anë. Shumica absolute e pjesëtarëve të këtij grupi etnik e identifikojnë vetveten si egjiptas. Shumica e tyre janë të përqëndruar në vetë qytetin e Gjakovës, mirëpo edhe fshatrat e tjera përreth kanë regjistruar një popullatë rome e cila jeton në to siç është rasti i fshatit Brekoc në të cilën jetojnë rreth 600 persona. Egjiptasit, në përgjithësi bëjnë me dije për marrëdhënie të ngrohta me fqinjët e tyre shqiptarë. Këta njerëz flasin flasin shqip dhe mu për këtë shkak ata gëzojnë një liri të mirë të lëvizjes dhe qasje ndaj shërbimeve themelore shoqërore siç janë shkollimi dhe shëndetësia. Ekziston edhe një pjesëmarrje e egjiptasve si në këshillin komunal ashtu edhe në bordin administrativ. Gjithashtu edhe dy egjiptas janë regjistruar për të marrur pjesë si kandidatë të pavarur në zgjedhjet e ardhshme komunale. Gjatë muajve të verës që shkuan shumë fëmijë rom dhe egjiptas kishin pasur rast që të luajnë dhe shoqërohen me fëmijët shqiptarë në një kamp veror të sponsoruar nga një OJQ ndërkombëtare. Kjo iniciativë e tillë konsiderohet të jetë një sukses i madh sidomos gjetja e hapësirës së përshtatshme për aktivitetet e të rinjve dhe të rriturve, të të gjitha komuniteteve në përgjithësi, aktivitete këto që shuajnë sado pak diskriminimin me të cilin ishin ballafaquar komunitetet minoritare.
169. Në komunën e Pejës, popullata e mbetur rome dhe egjiptase numëron rreth 2,000 persona. Përsëri shumica e këtyre personave e identifikojnë vetën si egjiptas. Shumica e tyre janë të përqëndruar në qytetin e Pejës, ku jetojnë romët dhe egjiptasit. Edhe fshatrat përreth janë të populluar me këto komunitete mirëpo në masë më të vogël. Numri i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve që jetojnë nëpër fshatra është zvogëluar dukshëm, mirëpo kjo nuk do të thotë se ka të bëjë me shkuarjet e tyre. Shifet se si romët ashtu edhe egjiptasit të cilët preferojnë më shumë që të identifikohen si shqiptarë e egjiptas e më pak si romë, janë duke u përballuar me një përmirësim të situatës për sa i përket lirisë së lëvizjes gjatë këtyre muajve të fundit. Ishin vërejtur gjithashtu edhe një përmirësim i situatës për sa i përket bashkëveprimit pozitiv të këtyre dy komuniteteve me popullatën shumicë shqiptare. Të dyja këto komunitete kanë përfaqësuesit e vet në administratën komunale. Përfaqësuesit e këtyre komuniteteve, sidoqoftë, vazhdojnë të ankohen për sa i përket statusit të tyre të qytetarit të rendit të dytë dhe kërkojnë veprime të mëtutjeshme që duket bërë në aspektin e qasjes së tyre ndaj shërbimeve përkatëse, punësimit dhe rritjes së vëmendjes për nevojat e rindërtimit, për të cilën ata dtheksojnë se paraqet një prirekuizitë/parakusht themelore për një kthim të tyre.
170. Peja ka qenë një fokus për sa i përket vizitave të organizuara nga UNHCR-ja në ato anë. Gjatë 5 muajve të fundit ishin bërë 4 vizita në këto anë duke i lejuar rreth 16 personave të zhvendosur që të vijnë nga Mali i Zi dhe ripërtrijnë lidhjet e tyre me vendet e tyre të origjinës, dhe në të njëjtën kohë duke vlerësuar situatën atje me qëllim të vendosjes se a do të kthehen nëpër shtëpitë e tyre apo jo. Iniciativat e tilla të tipit “shko dhe shiko” nuk kanë rezultuar me ndonjë kthim, mirëpo kanë kontribuar pozitivisht në përmirësimin e rrjedhjes së informatave ndërmjet komunitetit të mbetur në pejë dhe atyre që janë të zhvendosur në Mal të Zi. Në të njëjtën vijë, stafi i UNHCR-së ka vizituar kampin e të zhvendosurve në Mal të Zi duke iu përgjigjur thirrjeve të tyre, dhe në bazë të kërkesës së tyre edhe gazeta në gjuhën shqipe ishin dërguar atje me qëllim që këta persona të kenë mundësi të jenë në ngjarje për sa i përket zhvillimeve të fundit në Kosovë. Ata kishin përcjellur me një interesim të veçantë vizitën e anëtarëve shqiptarë të KPA-së që ata ia kishin bërë Pejës. Kjo ngjarje me rëndësi ishte mbajtur më 4 shtator, ku të tre liderët shqiptarë së bashku me PSSP-në, Dr Bernard Kouchner ishin pritur në mënyrë të mrekullueshme nga ana e popullatës vendore.
171. Kishte pasur edhe raste të kthimeve spontane të familjeve që ishin kthyer nga Mali i Zi, Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina në komunën e Pejës. Gjithashtu kishim pasur edhe raste të kthimeve të personave të zhvendosur me qëllim të vlerësimit të situatës atje. Dinamika e lëvizjeve të tilla e bën shumë të vështirë vlerësimin e shkallës së kthimeve spontane. Megjithatë numri i atyre të cilët u ishin përgjigjur kësaj iniciative vlerësohet të

jetë në dhjetëra sish e jo në qindra. Suksesi i një kthimi të tillë është i natyrës së përzier. Disa familje kishin arritur që të kthehen nëpër vendet e tyre të origjinës duke u bazuar në informatat pozitive të cilat i pranonin nga anëtarët e familjeve të tyre të cilët kishin mbetur atje. Në rastet e tilla riintegrimi i tyre në shoqëri ishte bërë mjaft lehtë, edhe pse të kthyerit tentojnë që të varen më shumë nga ndihmat humanitare të cilat u jipen atyre. Familjet e tjera të cilët jetojnë si të zhvendosur dhe momentalisht ata janë të strehuar nëpër shtëpitë e miqve dhe të afërmeve të tyre, përderisa ndjekin ndihmën financiare të nevojshëm për rindërtimin apo renovimin e shtëpive të tyre të shkatërruara.

172. Në një fshat të komunës së Pejës, ishte raportuar mbi rrahjen e një gruaje romë nga një grup i të rinjve shqiptarë më 19 shtator. Viktima, në këtë rast një grua e moshuar, ishte kthyer me vetëiniciativë nga Mali i Zi para pak kohësh. Ajo kishte qenë e shoqëruar nga vajza e saj, dhe ishte në proces të këshillimit të anëtarëve të tjerë të familjes të cilët gjendeshin në Mal të Zi që të kthehen nëpër shtëpitë e tyre. Lëndimet të cilat ajo i kishte pësuar ishin thuajse minimale të cilat dëftonin për faktin se kjo grua kishte qenë më shumë e keqtrajtuar më shumë sesa që kishte qenë e rrahur nga persona shumë më të fuqishëm se ajo. Pa marrë parasysh natyrën e lëndimeve të saja, ajo ishte e shqetësuar dhe e tronditur, pas së cilës kishte bërë me dije se nuk kishte qenë e trajtuar në nivel gjatë kurimit të saj në spital, duke deklaruar se stafi mjekësor në atë spital nuk ia merrnin fjalët seriozisht dhe bënë shaka në lidhje me gjendjen e saj shëndetësore. Kur më 21 shtator UNHCR-ja vizitoi fshatin në të cilin kishte ndodhur ky incident për të marrur vesh diçka më shumë në lidhje me të, gjatë së cilës morrën vesh se edhe tre shtëpi të romëve ishin djegur, duke përfshirë këtu edhe një shtëpi të një të zhvendosuri i cili rishtazi kishte vizituar Kosovën në vizitat e organizuara nga UNHCR-ja. Gjatë hetimeve të mëtutjeshme në lidhje me këtë rast, ishte zbuluar gjithashtu se 6 shtëpi romë të vendosura në atë rajon janë djegur, ku dy prej tyre janë prona të dy personave të zhvendosur në Mal të Zi, të cilët ishin duke shqyrtuar mundësinë e tyre për tu kthyer. Motivi për një rritje të numrit të sulmeve kundër pronave të romëve e cila erdhi pas një periudhe relativisht të qetë, ende mbetet i paqartë për shumë njerëz. Një gjë e cila është e qartë këtu është se informatat të cilat jehonin anembanë popullatës së zhvendosur në Mal të Zi, bënë që planet për kthim vullnetar të këtyre personave me përkrahjen e UNHCR-së ishin hedhur poshtë si rezultat i frikës e cila i kishte kapluar kthyesit e mundshëm. Kjo paraqet një mospasë serioz pas shumë e shumë muajve të përkujdesit dhe punës së kujdeseshme e cila sapo kishte filluar të shkrep rezultate për sa i përket çështjes së fitimit të besimit nga ana e popullatës së zhvendosur. Incidentet e tilla ndikojnë në atë mënyrë që shërbejnë për të potencuar faktin se gjasat për kthim mbeten si provë në të ardhmen. Gjithashtu të gjitha aktivitetet e cilat kanë të bëjnë me kthimin e këtyre personave duhet t'ju qasemi me kujdes, durim dhe përgjegjësi.
173. Në komunën e Klinës dhe Istogut kemi një popullatë romë dhe egjiptase e cila numëron deri në 1000 persona të cilët janë të shpërndarë në një numër vendbanimesh rurale. Në të dyja rastet numri i këtyre personave është më i madh sesa që ishte raportuar në shkurt të vitit 2000. Kjo i ngarkohet shembullit të kthimit në shkallë të ulët të disa prej familjeve. Ky kthim do të pasojë si përgjegje përmirësimit të situatës së sigurisë dhe marrëdhënieve ndëretnike. Këto masa provuese drejt një kthimi të caktuar meritojnë një përkrahje të plotë të bashkësisë ndërkombëtare. Ekziston nevoja për një përgjegje proaktive me qëllim të mbajtjes së kushteve të favorshme të sigurisë dhe shtim të ndihmës për rindërtim nëse dëshirojmë të shohim një kthim më të madh të personave të zhvendosur nga Mali i Zi dhe gjetiu në planin afatmesëm. Në fshatin Zhaq, një pjesë e komunitetit rom dhe atij egjiptas të cilët jetojnë nën mbrojtje 24 orëshe të KFOR-it dhe janë duke ecur me hapa të shpejtë drejt përmirësimit të lidhjeve të tyre me fqinjët e tyre shqiptarë dhe me kalimin e kohës ata do të kërkojnë që siguria e ofruar nga KFOR-i të zvogëlohet në të ardhmen e afërt.

### **Sllavo muslimanët**

174. Ky grup përbëhet nga muslimanët të cilët flasin sllavisht dhe të cilët mëparë janë quajtur me emrin muslimanë emër ky i krijuar në kuadër të republikës socialiste federative të jugosllavisë. Sllavo muslimanët e identifikojnë veten si boshnjak, tyrbesh, sllavo musliman dhe ndonjëherë thjeshtë edhe muslimanë. Ata kanë afërsi të caktuara kulturore, duke përfshirë këtu edhe ngjashmëritë për sa i përket gjuhës së tyre të folur dhe religjionit të përbashkët me goranët, sllavo muslimanët tjerë të cilët kryesisht janë të koncentruar në rajonin e Dragashit që gjendet në jug të Prizrenit (e quajtur edhe regjioni

i Gorës). Megjithatë, prapsepapë ekzistojnë dallime përkatëse ndërmjet të Goranëve dhe Sllavo Muslimanëve, dhe për qëllime të përpilimit sa më të denjë të këtij raporti ne kemi folur këtu për ta si komunitete të veçanta. Përdorimi i emërtimeve siç janë Bosnian/Bosniak/Bosniac nuk do të thotë që menjëherë duhet të përmbajë në veti një lidhje automatike me shtetin e sotëm të Bosnjë dhe Hercegovinës. Besohet se Sllavo Muslimanët të cilët jetojnë momentalisht në Kosovë mund të pohojnë një me prejardhje nga regjionet e ndryshme siç janë shteti i sotëm i Bosnjë e Hercegovinës, regjioni i Sanxhakut dhe disa pjesëve të Maqedonisë. Këto emërtime janë zhvilluar me kohë, të influencuara nga një sërë arsyes historike, politike dhe kulturore. Në tekstin e mëposhtëm jemi munduar që të përshkruajmë secilës popullatë nga një emërtim të cilin ata më së shpeshti e përdorin për ta identifikuar vetveten. Ndryshimet për sa i përket shqiptimeve të termit Bosniac dhe Bosniak, ku që të dyja përdoren në mënyrë të ndryshueshme të cilat i referohen grupit etnik dhe gjuhës të cilën ata e flasin. Shumë Sllavo Muslimanë në Kosovë janë lojal të Partisa së Aksionit Demokratik (PAD) selia e së cilës është në vetë Bosnjë dhe Hercegovinën. Sidoqoftë kemi edhe partitë e tjera të cilat gjejnë përkrahësit e tyre në kuadër të komunitetit të gjerë sllavo-musliman e ato janë: Partia e Aksionit Demokratik për Kosovën dhe Partia e Reformave Demokratike të Muslimanëve.

175. Ekziston edhe komuniteti sllavo-musliman (boshnjak) i cili është i përqëndruar në qytetin urban të Prishtinës, e cila para konfliktit numëronte prej 3,400 deri në 4,000 persona. Kjo shifër është zvogëluar dukshëm prej mpërfundimit të konfliktit në Qeshor 1999 dhe tani kjo shifër sillet në mes të numrit 1,600 dhe 1,800 në kohën e publikimit të Vlerësimit të katërt me rradhë të UNHCR/OSBE-së në Shkurt 2000. Përfaqësuesit e këtij komuniteti i referohen shembullit të shkuarjeve dhe pohojnë se tani kjo popullatë është diku rreth 10% të shifrës së paraluftës. Nuk mund të mirret me mend se kemi një rënie drastike të numrit të Sllavo-Muslimanëve sikur kjo e prezantuar nga ky përfaqësues, mirëpo duhet të pranojmë faktin se ka pasur raste të shkuarjeve të tyre dhe ka ende. Familjet sllavo-muslimane ballafaqohen me vështirësi për shkak të gjuhës të cilën e flasin dhe iu nënshtrohen keqtrajtimeve dhe fyerjeve gojore si pjesë e përditshme e jetës së tyre. Shifra prej 1,000 personave të nacionalitetit sllavo-musliman është më reale, ku shumica e tyre që kanë mbetur në Kosovë gëzojnë një shkallë të lartë të integritetit të tyre në shoqëri së bashku me fqinjët e tyre shqiptarë, ku UNHCR-ja dhe OSBE-ja kanë theksuar se është shumë vështirë të bëhen me dije shifrat e sakta për sa i përket kësaj çështjeje. Shifra prej 1,000 personave është si të them një shifër e përgjithësuar.
176. Në Mitrovicë komuniteti Sllavo Musliman e identifikojnë vetën si Boshnjakë, të cilët vazhdojnë që të jetojnë në të dy anët e Ibrit. Liderët e komuniteteve citojnë për një shifër prej 3,000 personave që jetojnë aty në krahasim me shifrën 6,000 të paraluftës. Dhe gjithashtu deklarojnë se janë optimist për sa i përket gjasave të tyre për kthim. Megjithatë shifra prej 2,000 personave (shifër kjo e rritur prej 1,750, shifër kjo e matur në Janar 2000) besohet të jetë më e saktë. Situata e përgjithshme e sigurisë për Boshnjakët në atë vend është e qetë dhe stabile. Megjithatë, në ta ndikon situata e tensionuar e cila mbretëron në qytet dhe e cila situatë kohëpaskohe shpërthen në një dhunë të hapur. Boshnjakët të cilët jetojnë në jug të lumit Ibër mbeten të kujdesshëm dhe syhapur për sa i përket përdorimit publik të gjuhës së tyre duke preferuar që të flasin shqip, ku sidoqoftë prezenca e tyre tolerohet nga ana e popullatës shumicë shqiptare. Mahalla e përzier e quajtur "mahalla e boshnjakëve" ku shumë prej boshnjakëve jetojnë në këto anë, është përfshirë në Zonën e Besimit e cila ishte e vendosur aty nga bashkësia ndërkombëtare si përgjegje e dhunës së shpërthyer në Shkurt të vitit 2000. Implementimi i "Zonës së Besimit" iu ka lejuar Boshnjakëve që të qëndrojnë nëpër shtëpitë e tyre përkundër ciklit të dhunës i cili ishte prezent gjatë këtyre muajve të fundit.
177. Në regionin e Prizrenit ende jetojnë një numër pak a shumë i madh i popullatës e cila quhet Sllavo-Muslimanë apo ndryshe edhe si Boshnjakë, Torbeshë apo thjeshtë Muslimanë. Në vetë qytetin e Prizrenit dhe fshatrat e komunës së Prizrenit jetojnë rreth 25,000 Sllavo-Muslimanë (shifër kjo e cila është shumë vështirë që të përcaktohet me saktësi për shkak se disa burime të këtyre informatave nuk bëjnë dallim ndërmjet Sllavo Muslimanëve dhe Goranëve). Ende janë prezente një sërë problemesh me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e këtij komuniteti, siç janë qasja e plotë ndaj strukturave komunale dhe shërbimeve themelore, të cilat kanë lindur më së shumti si rezultat i barrierave gjuhësore. Si rezultat i gjithkësaj Sllavo Muslimanët vazhdojnë të bëjnë me

dije për gjasat e kufizuara të tyre për të qëndruar mëtutje në Kosovë dhe deklarojnë se do preferonin më shumë që të shkojnë nga këtu. Edhe pse nuk është vërejtur ndonjë indikacion i cili na tregon për shkuarje në masë më të madhe të këtyre personavesidomos gjatë periudhës kohore kur jemi duke raportuar besohet se kemi shkuarje të njerëzve në masë të vogël. Shumica e Sllavo-Muslimanëve u kthyen në Prizren gjatë muajve të verës për ti vizituar miqtë dhe familjet e tyre mirëpo pa ndonjë tentativë për të mbetur aty përgjithmonë. Shumicës së Sllavo-Muslimanëve u mungon vullneti i mirë që të përdorin gjuhën e tyre publikisht duke u frikuar se mos do të mirren si serbë nga ana e të tjerëve. Sidoqoftë liria e tyre e lëvizjes konsiderohet të jetë përmirësuar dhe si rezultat i kësaj njerëzit ndalngadalë po e marrin guximin që ta përdorin gjuhën e tyre publikisht. Në disa prej zonave rurale Sllavo-Muslimanët jetojnë së bashku me serbët në një fshat të përzier, faktor ky i cili mund të ketë implikime serioze në lidhje me sigurinë e tyre. Incidentet e fundit të ndodhura në fshatin Mushnikovo, për shembull sipas të gjitha gjasave ato kanë qenë të drejtuara kah një numër i vogël i serbëve që jetojnë aty, sidomos kah ata të cilët rishtazi ishin kthyer nëpër vatrën e tyre, sulme këto të cilat kishin pasur ndikim edhe tek Sllavo-Muslimanët e atjeshëm. Sllavo-Muslimanët gjithashtu kanë qenë shënjestër e një krimi të përbashkët, sidomos e plaçkitjeve. Më 6 Shtator, gjashtë burra të maskuar dhe të armatosur kishin hyrë me forcë në një shtëpi Boshnjake në Prizren ku kishin kërkuar para. Gruaja e cila kishte qëlluar në shtëpi ishte goditur në kokë me kondak të revoles ku mëpastaj si rezultat i kësaj ajo kishte kërkuar ndihmë mjekësore. Pak më herët gjatë të njëjtit muaj, më 3 Shtator, një shtëpisë Boshnjake e cila kishte qenë e pazënë deri në atë moment, i ishte ndezur flaka. Një shembull tjetër e cila e përshkruan një trend i cili është i pranishëm në Prizren është shkatërrimi i pronave të pazëna dhe shfrytëzimi i tokës së saj për rindërtim. Shtëpitë e pjesëtarëve të minoriteteve janë më së shpeshti shënjestër e aktiviteteve të tilla.

178. Në Pejë kemi një komunitet Sllavo-Musliman i cili është i cvendosur si në vetë qytetin e Pejës ashtu edhe në vendbanimet e tjera përreth. Shumica e tyre e identifikojnë vetveten si Boshnjak përderisa një numër i vogël i tyre si Goran. Shifrat e përgjithshme të cilat vlejné si për zonat urbane ashtu edhe për ato rurale, sillen diku rreth numrit 4,000, ku 1,600 është shifra e cila vlen vetëm për qytetin e Pejës. Matjet e numrit të popullatës ndryshojnë varësisht prej prej burimit, duke e pasur të njohur faktin se përfaqësuesit e këtij komuniteti disa herë kanë deklaruar për një numër të shkuarjeve të personave të atij komuniteti nga aty. Vrasja e një Boshnjaku të ri në Pejë më 19 Qeshor, kishte lënë në shok komunitetin e atjeshëm dhe besohet se kjo vrasje ka nxitur/shkrepur disa prej shkuarjeve që kanë ndodhur mëpastaj. Në kuadër të vetë strukturave komunale të Pejës ekziston Departamenti për çështje ndërmjet komuniteteve, drejtor i së cilës është një Boshnjak. Kjo i ka mundësuar komunitetit boshnjak që të ketë një kanal të caktuar nëpërmjet të cilit do të ndëgjohet zëri i tyre dhe si punë shtesë që ka bërë ky Departament është edhe nxitja e mbajtjes së një dialogu ndër-etnik ndërmjet shqiptarëve, boshnjakëve, romëve dhe egjiptasve që jetojnë në rajonin e Pejës.
179. Një prej vendeve ku popullata boshnjake është e koncentruar më së shumti në fshatin Vitomiricë në afërsi të komunës së Pejës. Në këtë lokacion vetë, kemi një popullatë boshnjake e cila numëron gjithsej 2,300 Boshnjakë të cilët jetojnë aty së bashku me një popullatë më të vogël rome dhe Egjiptase. Popullata e kësaj ane ka mbetur stabile me disa oshilime të vogla për shkak të shkuarjeve dhe kthyerjeve të tyre në shkallë të ultë. Fëmijët Boshnjakë kanë mundësi që ti ndjekin mësimet e tyre tëshkollimit fillor në Vitomiricë përderisa për ato të shkollimit sekondar ata detyrohen që të udhëtojnë për në vetë qytetin e Pejës. Prindërit kishin shprehur shqetësimet e tyre për shkak të faktit se fëmijët e tyre nuk kanë mundësi që të fitojnë një shkollim më të lartë në gjuhën e tyre amtare. Nevojat primare shëndetësore në përgjithësi përmbushen nga ana e ambulantave, mirëpo që prej Gushtit të këtij viti në këtë ambulantë nuk kemi pasur ndonjë mjek kujdestar, ku si rezultat i kësaj pacientët detyrohen që të shkojnë në spitalin e Pejës. Disa prej tyre nuk kanë vullnet që të udhëtojnë deri në qytet për të marrur ndihmë mjekësore në spital duke nënvizuar faktin se ata nuk flasin shqip dhe se ende kemi probleme të sigurisë në këtë aspekt. Ende ekziston prezenca e KFOR-it e cila kryen patrulla të rregullta përderisa pika kontrolluese e cila kishte qenë e vendosur në rrugën kryesore ishte larguar nga aty. Nuk ka pasur ndonjë incident i cili ka ndodhur këtyre muajve të fundit në Vitomiricë mirëpo popullata e atjeshme ende ankohet për incidentet të cilat kanë natyrë keqtrajtimi dhe frikësimi. Shumica e banorëve të kësaj ane kanë shprehur dëshirën që ti shesin pronat e tyre apo ti lëshojnë ato për arsye se nuk

shohin ndonjë të ardhme të afërt për ta dhe familjet e tyre në Kosovë. Shkuarjet e mëtutjeshme nga Vitomirica nuk mund të mirren më me rezerva.

180. Popullata sllavo-muslimane (Boshnjake), e cila numëron diku rreth 1,000 persona është e përqëndruar në komunën e Istogut. Gjithashtu, përderisa popullata e atjeshme boshnjake ka mbetur stabile, prapsepapë kemi pasur shkuarje të vazhdueshme në shkallë të ulët, cilat rezultojnë me një zvogëlim të numrit të përgjithshëm të popullatës, numër ky i cili ishte raportuar në Shkurt. Frika për të përdorur gjuhën e tyre amtare publikisht dhe kufizimet në lirinë e lëvizjes që rezultojnë nga kjo duke bërë një presion mbi popullatën boshnjake andaj me të drejtë pritet të ballafaqohemi përsëri me një trend të shkuarjeve nga aty. Në Gusht atë e bir të një familjeje boshnjake e cila jeton në një zonë rurale ishin rrahur shumë keq nga disa persona të panjohur mirëpo thuhet të kenë qenë të uniformuar. Përpos këtij incidenti, situata e përgjithshme e sigurisë për Boshnjakët ka qenë e pranueshme, mirëpo prapsepapë komuniteti Boshnjak vë në pyetje të ardhmen e saj në Kosovë në planin afatgjatë.
181. Komuniteti i vogël boshnjak i cili jeton në Gjakovë ishte tmerruar pas vrasjes së 27 Qeshorit të një të riu boshnjak i cili sapo ishte kthyer nga Gjermania për t'iu bashkuar familjes së tij. Si rezultat i këtij incidenti, familja e viktimës u detyrua që menjëherë ta lëshoi vendin dhe të shkoi për në Mal të Zi.

## **Goranët**

182. Siç u përmend mëlartë, Goranët mund të konsiderohen si pjesë e një grupi të gjerë etnik të quajtur Sllavo-Musliman, të cilët dallohen nga të tjerët me karakteristikat e veçanta gjuhësore dhe me faktin se ata jetojnë në një zonë gjeografike të definuar qartë, e cila zonë jo vetëm që ballafaqohet me probleme të sigurisë por edhe me probleme specifike që janë të ndërlidhura me izolimin dhe zhvillimin jo të duhur ekonomik të atij vendi, ashtu që për qëllim të këtij raporti, sikur edhe në raportet e kaluara, ne kemi zgjedhur që të flasim për këtë komunitet në veçanti ndaras prej grupeve të tjera që hyjnë në kategorinë e grupeve të quajtura Sllavo-Musliman.
183. Komuniteti goran më së shumti është i koncentruar në komunën e Dragashit, vend ky i cili ndodhet në jug të Prizrenit. Vlerësimet e fundit tregojnë për faktin se ekzistojnë prej 9,000 deri në 11,000 goranë gjithsejt të cilët jetojnë anembanë komunës në fjalë ku vetëm 1,500 prej tyre jetojnë në qytezën e Dragashit, dhe në një numër fshatrash të cilët ndodhen në rajonin e Gorës. Tradicionalisht, komuniteti goran është një komunitet pjesëtarët e të cilit gjithmonë kanë qenë punëtorë të cilët janë detyruar që të migrojnë jashtë dhe për këtë arsye gjithmonë kemi pasur lëvizje të popullatës nga ai vend që e ka bërë të vështirë procesin e matjes së numrit të saktë të popullatës gorane e cila jeton aty. Shifrat e tanishme të popullatës janë më të vogla se ato të matura në Shkurt 2000 e cila gjë mund ti ngarkohet faktit se gjatë muajit Shkurt dhe Mars 2000 pati disa raste të shkuarjeve nga rajoni i Gorës, si rrjedhojë e e një sërë incidentesh të drejtuara kundër goranëve që jetojnë në komunën e Dragashit dhe ata të cilët jetojnë në Prizren. Gjatë verës që shkoi shumë goranë ishin kthyer për ti vizituar fshatrat e tyre. Përderisa shumica e tyre lëshuan ato fshatra me mbarimin e verës, të tjerët qëndruan aty edhe për një kohë deri në fillimin e vitit të ri shkollor. Eksplozimet që ndodhën në qytezën e Dragashit më 21 dhe më 30 Shtator kishin për shënjestër shtëpitë e goranëve, e cila irritoi popullatën. Incidentet e tilla mund të rezultojnë me shkuarje të mëtutjeshme për shkak të shqetësimit të popullatës për sa i përket çështjes së keqësimit të kushteve të sigurisë së përgjithshme. Shumë Goranë janë ende mjaft të kujdesshëm për sa i përket përdorimit të gjuhës së tyre amtare publikisht jashtë zonave të dominuara nga ky komunitet dhe si pasojë e gjithë kësaj ata ballafaqohen me kufizime të caktuara që kanë të bëjnë me mundësitë e tyre për punësim dhe qasjen e tyre ndaj disa shërbimeve themelore. Arsimi është një problem i veçantë, për shkak të kërkesave specifike gjuhësore të bëra nga ana e këtij komuniteti dhe për shkak të faktit se shumë prej tyre jetojnë në zona të izoluara rurale, dhe janë në pamundësi që ti qasen arsimimit të mesëm. UNICEF-i do të financoi një projekt i cili ka për qëllim që të përmirësojë kualitetin e shkollimit të specializuar për artizanate, me shpresë se do të përmirësojnë gjatat e tyre për gjetjen e vendeve të punës dhe ndërtimin e një ardhmërie më stabile të tyre në Kosovë. Një projekt sportiv i cili ishte mjaft i suksesshëm është ai i mbajtur gjatë muajve të verës në të cilin projekt ishte i përfshirë edhe ylli i futbollit danez, iniciativë kjo e cila ishte mëse e mirëseardhur për të rinjtë, të cilët përndryshe deri atëherë nuk kishin

liri të mjaftueshme të lëvizjes. Në Prizren, komuniteti goran nuk dallohet në përgjithësi shumë nga ai sllavo-musliman, për këtë arsye edhe nuk kemi në dispozicion shifra të sakta për sa i përket kësaj çështjeje.

184. Në qytetin e Mitrovicës, ekziston një komunitet të vogël të Goranëve, i cili vlerësohet të jetë diku rreth 120 persona, prej të cilëve një të tretat jetojnë në Mitrovicën jugore, përdërisa dy të tretat në veri. Shumica e tyre kanë mbetur në pronat e tyre të paraluftës. Sidoqoftë, shtëpitë dhe bizneset e Goranëve të cilat gjenden në jug të qytetit ishin okupuar nga të tjerët në mënyrë të paligjshme e cila gjë i shbind goranët për tu kthyer nëpër shtëpitë e tyre të cilat i kishin lëshuar mëparë.
185. Ka ende familje gorane të cilat kanë mbetur në komunën e Prishtinës. Është shumë vështirë që të dihet numri i saktë i tyre për shkak të faktit se ky komunitet është i shpërndarë nëpër tërë komunën dhe shpesh këta persona nuk dallohen shumë nga Sllavo-Muslimanët. Ishte raportuar mëparë se shumë familje kishin shkuar në Bosnjë, Maqedoni dhe Mal të Zi apo për t'iu bashkuar familjeve të tyre në Dragash. Edhe pse nuk kemi pranuar ndonjë raport i cili flet për shkuarje të goranëve nga vendi kohëve të fundit, goranët tërheqin emendjen se në të ardhmen mund të ndodhin edhe shkuarje të ardhshme për shkak se ata e kanë shumë vështirë që të mbijetojnë në rrethanat e vështira të cilat mbretërojnë në Prishtinë, për shkak të faktit se ata duhet të jenë mëse të kujdesshëm për sa i përket çështjes së përdorimit të gjuhës së tyre publikisht dhe qasjes së kufizuar të cilën e kanë ndaj punësimit dhe shërbimeve të tjera si rezultat i gjithë kësaj. Shihet se ekziston një perceptim i përgjithshëm në kuadër të komunitetit në fjalë se jeta do të ishte më e lehtë për ta po të jetonin në Dragash, ku komuniteti goran është më së shumti i përqëndruar.
186. Në zonën e Prishtinës, kemi komunitetet e vogla të goranëve të cilët janë të përqëndruar kryesisht në Janjevë, Lipjan, Fushë Kosovë, Obiliq, ku këto komunitete shpeshherë nuk përbëhen nga më shumë se një grusht njerëzish të cilët jetojnë të izoluar. Ngjashëm kemi edhe komunitete të vogla të cilat janë të koncentruara në Kamenicë dhe Gjilan, të cilat nuk numërojnë më shumë se 200 persona në të dyja këto lokacione. Këto komunitete nuk kanë raportuar për ndonjë problem serioz me të cilin janë ballafaquar.

### **Turqit e Kosovës**

187. Komuniteti turk i cili jeton në Kosovë mbetet relativisht stabil, me vetëm disa incidente të raportuara. Sidoqoftë, një çështje që i brengos ata është çështja e gjuhës së tyre, dhe veçanërisht njohja e gjuhës turke si gjuhë zyrtare nga ana e UNMIK-ut. Siç e kam shpjeguar edhe më lartë, në seksionin e gjuhës, janë duke u mbajtur negociata intenzive ndërmjet UNMIK-ut dhe liderëve politik turq për sa i përket statusit të gjuhës turke si gjuhë zyrtare, të cilat negociata rezultuan me një kompromis. Megjithatë, kjo ishte arritur tepër vonë, sidomos tani kur nuk kemi pasur pjesëmarrjen e turqve në regjistrimin e verës së kaluar. Për këtë arsye shumica e turqve nuk do të kenë të drejtë të votojnë në zgjedhjet e ardhshme komunale. Parashihet që PSSP-ja do të përdor tërë fuqinë e vet të ko-optimit me qëllim që të sigurojë që komunitetit turk mos të lihet i papërfaqësuar në strukturat komunale në vendet të cilat janë të dominuara me popullatë turke. Zgjedhja e plotë e çështjes së gjuhës turke është në proces e sipër, ku shkollimi në gjuhën turke është një kërkesë primare për këtë komunitet.
188. Në Prizren, duket se ka pasur oshilime të vogla në numrin e popullatës turke, e cila popullatë në bazë të vlerësimeve të liderëve të këtij komuniteti nimëron diku rreth 12,000 në vetë qytetin e Prizrenit dhe 5000 në fshatin e madh turk të quajtur Mamushe. Vetëm disa incidente të vogla ishin raportuar në lidhje me situatën e sigurisë në këto anë.
189. Ngjashëm, janë vërejtur lëvizje të vogla të popullatës turke në komunën e Gjilanit, e cila mbetet 1,500 prej tyre në vetë qytetin e Gjilanit dhe 400 të cilët jetojnë në fshatin Mireshe. Përsëri vetëm disa incidente të vogla ishin raportuar për sa i përket situatës së sigurisë në atë vend.
190. Popullata turke e cila jeton në qytetin e Mitrovicës numëron rreth 600 prej tyre. Liderët e komunitetit turk bëjnë me dije se 40% të tyre jetojnë në pjesën veriore, përdërisa 60% në pjesën jugore. Nuk ka pasur ndonjë ndryshim më të madh në numrin e popullatës,

dallimet e kësaj shifre me ato të prezentuara në raportet e kaluara rezultojnë për shkak të mbledhjes së informatave nga vetë komuniteti. Liderët e komunitetit turk kishin shprehur interesimin e tyre në emër të turqve të Kosovës të cilët momentalisht jetojnë në Turqi për tu kthyer nëpër vatrat e tyre, mirëpo deri më tani nuk kemi ndonjë kthim të tillë. Popullata turke veriu të Mitrovicës kishte pësuar rëndë së bashku me minoritetet të cilat jetojnë atje gjatë shpërthimit të dhunës në Shkurt të vitit 2000 dhe si rezultat i kësaj disa familje turke ishin zhvendosur për në jug të qytetit. Pas një qetësimi të dhunës dhe keqtrajtimeve që ishin prezente në veri të Mitrovicës, Policia e UNMIK-ut kishte deklaruar në fillim të Shtatorit 2000 se ata kishin pranuar dy raporte nga familjet turke në të cilat bëhej me dije okupimi i shtëpive të tyre nga ana e serbëve të Kosovës. Familjet në fjalë sot jetojnë në jug të qytetit.

191. Në qytetin e Vushtrisë gjenden rreth 300 turq të shpërndarë gjetu nëpër qytet. 50-60% e këtij komuniteti janë nën moshën 18 vjeçare, me disa prej tyre të cilët i ndjekin mësimet e tyre në shkollat që gjenden në jug të Mitrovicës e disa në Vushtri.
192. Në Prishtinë jetojnë një numër i vogël i turqve. Ata bëjnë me dije se ekziston ndjenja e përbashkët në mesin e tyre se ata janë lënë pas dore nga ana e bashkësisë ndërkombëtare e cila është duke iu dhënë më shumë vëmendje ekziston ndjenja e përbashkët e dëshprimit në mesin e tyre për faktin se ata janë lënë pas dore nga ana e bashkësisë ndërkombëtare e cila është duke iu dhënë më shumë vëmendje çështjeve që kanë të bëjnë me pakicat e tjera që jetojnë këtu. Turqit që jetojnë në zonën urbane të Prishtinës mjaft shpesh deklarojnë se nëse nuk shohin ndonjë përmirësim të situatës në të cilën ata jetojnë, situatë kjo që ka të bëjë me mundësitë e tyre për punësim, shkollimin në gjuhën e tyre amtare, shumë pjesëtarë të këtij komuniteti do ta lëshojnë Kosovën dhe do të ikin për në Turqi. Një grup i vogël i familjeve turke besohet se jetojnë në Fushë Kosovë.

### **Kroatët**

193. Komuniteti kroat në janjevë besohet së është zvogëluar në numër pas shkuarjeve individuale të pjesëtarëve të këtij komuniteti, i cili momentalisht numëron 370 persona. Nuk ka pasur ndonjë incident më i madh i cili ka ndodhur në këto anë, mirëpo del se komuniteti në fjalë është mjaft i brengosur për të ardhmen e saj afatgjate në Kosovë, veçanërisht për sa i përket mundësive për shkollim të fëmijëve të tyre. Pjesëtarët e mbetur të komunitetit në fjalë mbajnë lidhje të ngushta me Kishën Katolike të fshatit dhe ende kemi priftin kroat i cili i përmbush nevojat e tyre shpirtërore.
194. Popullata kroate e cila jeton në letnicë, komuna e vitisë ka mbetur mjaft stabile edhe pse e vogël në numër, numër ky i cili sillet prej 50 deri në 60 persona. Deri në qindra kroatë e kishin vizituar letnicën gjatë mbajtjes së një festivali religjioz katolik, gjatë muajit gusht. Disa prej vizitorëve ishin edhe ata të cilët kishin lëshuar këtë vend tetorin e kaluar nën përkujdesje të qeverisë kroate. Edhe pse nuk u paraqit ndonjë problem gjatë vizitës në fjalë, disa prej vizitorëve kishin shprehur shqetësimin e tyre se shqiptarët e Kosovës janë duke i okupuar pronat e tyre. Gjatë muajit tetor 1999 kur këta persona kishin shkuar nga këtu, kishte shumë pak kohë për të rregulluar edhe në mënyrë ligjore të drejtën mbi pronën. Shumica e marrëveshjeve ishin bërë na baza të njëfarë ruajtjeje të këtyre pronave nga ana e fqinjëve të tyre. Nga kjo mund të del se marrëveshjet e tilla kanë mundur të kuptohen si okupim i përhershëm i tyre.

Disa prej kroatëve të mbetur ndiejnë njëfarë ndjenje të shtuar të izolimit nga ana e fqinjëve të tyre duke cituar faktin se mesha tani në kishë është duke u mbajtur në gjuhën shqipe e jo në atë kroate si mëparë. Nuk pritet që të kemi ndonjë kthim të këtyre personave në të ardhmen e afërt mirëpo sipas të gjitha gjasave do të kemi vizita të llojit të festave fetare.

### **Çerkezët**

195. Ky grup etnik i ka rrënjët e saja nga malet Kaukaz të cilat ndodhen në Rusi. Ata për nga besimi janë musliman dhe flasin gjuhën e tyre amtare që është çerkishtja, mirëpo ata gjithashtu flasin edhe në gjuhën shqipe dhe atë serbe. Një numër i vogël i familjeve të cilat ishin identifikuar gjatë raporteve të kaluara se kanë mbetur në Kosovë dhe nuk ishin ballafaquar me ndonjë problem që nga raporti i fundit. Është e mundshme që Çerkezët të jetojnë të shpërndarë nëpër tërë Kosovën dhe andaj për këtë arsye nuk kanë mundur

të identifikohen lehtë. Kjo në vetvete është një tregues i faktit se ata kanë marrëdhënie të mira ndër-etnike me grupet e tjera etnike. Nuk ka pasur ndonjë raport i cili na dëfton se Çerkezët kanë qenë shënjestër e sulmeve për shkak të përkatësisë së tyre etnike.

## **REKOMANDIME**

### **Siguria**

1. Policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i duhet të mësojnë nga përvojat e tyre pozitive dhe praktikat superiore të demonstruara në terren dhe gjithashtu duhet të vazhdojnë të zhvillojnë një brez të gjerë dhe më imagjinues të masave të sigurisë, siç janë, p.sh shfrytëzimi i linjave emergjente telefonike, të cilat do të udhëheqen nga vetë pjesëtarët e komuniteteve minoritare.
2. **Burimet për stacione policore lëvizëse (mobile)** duhet të sigurohen dhe atë urgjentisht. Stacionet në fjalë duhet të përkrahen gjithashtu nga oficerët e SHPK-së të të njëjtës përkatësi etnike si komuniteti në fjalë, dhe interpretët me përkatësi të njëjtë etnike sikur komuniteti të cilit i ofrohet shërbimi përkatës me qëllim të rritjes në maksimum të bashkëveprimit pozitiv ndërmjet policisë dhe komunitetit vendor. Kjo nuk bën të ndalojë shfrytëzimin e oficerëve të SHPK-së dhe interpretëve me përkatësi të ndryshme etnike se komuniteti në fjalë nëse natyrisht kjo është një gjë e pranueshme për atë komunitet.
3. Shembujt e vërtetuar për mënyrat e marrjes së masave të sigurisë për minoritetet me qëllim që ata të kenë edhe mundësi që të punojnë duhet të kopjohen. Këtu duhet të përfshihet transporti në dhe prej punës, si dhe siguria gjatë mbajtjes së orarit të punës. Agjencitë duhet, që në kuadër të planit të tyre ta kenë edhe çështjen e rekrutimit të pjesëtarëve të minoriteteve, që të sigurojnë që një siguri e tillë të vëhet në dispozicion, ku është e mundshme edhe burimet e përbashkëta siç janë (autobusët shuttle) me agjencitë e tjera, në mënyrë që asnjëra prej tyre mos të tejkohet për sa i përket kërkesave për përcjellje të sigurisë.
4. Duhet të diskutohet për masat e sigurisë dhe me komunitetet për të cilat ato janë të dedikuara. Kjo nuk përfshin vetëm komunitetet minoritare të cilët mund të përfitojnë nga këto masa mirëpo edhe fqinjët e tyre që vijnë nga rradhët e komunitetit shumicë, ku parashihet që masat e tilla të kenë ndikim edhe në ta gjithashtu.

### **Drejtësia**

5. Në planin afatmesëm, gjyqtarë ndërkombëtarë dhe prokurorë shtesë nevojiten për të punuar në fushën e krimeve të luftës, krimeve me motiv etnik, dhe rasteve me të pandehur që vijnë nga rradhët e minoriteteve. Pasuria e përvojës së mbledhur nga stafi ndërkombëtar gjyqësor duhet të vihet në përdorim me qëllim të zhvillimit të strategjive të mëtutjeshme dhe ushqimit/nxitjes së një gjyqësie fer dhe funksionale.
6. **Masa disiplinore duhet të mirren** kundër atyre gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët në mënyrë të vazhdueshme dështojnë për ti hetuar në mënyrë adekuate rastet e krimeve me motive etnike. Një sistem efektiv për marrjen e masave kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet vënë në përdorim sa më shpejt.
7. **Avokatët minoritar duhet** të përfshihen në të gjitha sesionet trajnuese për avokatë. Duke e pasur të njohur dobësinë me të cilën posedojnë këshilltarët mbrojtës në përgjithësi dhe komplikimeve shtesë të cilat mund të lindin për shkak të problemeve në lidhje me lirinë e kufizuar të lëvizjes, përdorimit pro-aktiv të avokatëve ndërkombëtar duhet të mirret në konsideratë gjithashtu.
8. Duhet bërë të gjitha përpjekjet në drejtim të rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve minoritar, duke përfshirë këtu edhe konsultimet e bëra në fazën paraprake dhe dhënia e premtimeve të qëndrueshme për sa i përket sigurimit të masave të sigurisë që do t'ju mundësojnë këtyre gjyqtarëve dhe prokurorëve që të kryejnë punën e tyre në siguri.
9. Masa speciale të sigurisë kërkohen urgjentisht për sa i përket mbrojtjes së dëshmitarëve minoritar gjatë mbajtjes së gjykimeve për veprat e ndryshme penale. Të gjitha përpjekjet



e përqëndruara të cilat shërbejnë për përmirësimin e gjendjes në të cilën gjendet gjyqësia nëpërmjet të inkuadrimin të një stafi ndërkombëtar si dhe sigurimin e pajisjeve përkrahëse do të bien në ujë nëse dëshmitarët janë në pamundësi apo nuk dëshirojnë që të marrin pjesë në procedurat gjyqësore për shkak të frikës e cila i kaplon.

### **Qasja dhe Ko-ordinimi**

10. **Udhëzimet e detajuara për politikën e organeve të ndryshme duhet të** përpilohen për të siguruar një qasje të plotë për minoritetet ndaj shërbimeve themelore. Këto politika të tilla duhet të marrin parrasysh edhe masat e përkohshme speciale të sigurisë. **Udhëzimet** e tilla duhet të diskutohen me Departamentet relevante të SPPA-së, Asambleve Komunale të cilat do të konstituohen pas zgjedhjeve të ardhshme, dhe të gjitha agjencive përgjegjëse për dhënien e shërbimeve komuniteteve minoritare. Duhet të kërkohet ekspertshmeri nga ana e të gjithë atyre të cilët janë veç duke ofruar shërbime për komunitetet në fjalë, ose përndryshe këto agjenci do të ofrojnë listat e ekspertëve të tyre të cilët i kanë për secilën komunë.
11. **Organizatat të cilat** sapo janë duke formuar masat speciale të sigurisë të cilat do të ju sigurojnë pakicave qasje të caktuar ndaj shërbimeve përkatëse, këto organizata mund të jenë edhe ekipe lëvizëse, duhet të koordinojnë përpjekjet e tyre dhe ti unifikojnë/bashkojnë burimet e tyre në mënyrë që të sigurohet një mbulesë e plotë për tërë Kosovën pa ndonjë dyfishim të përpjekjeve. Objektet lëvizëse apo edhe shfrytëzimi i gjerë i atyre statike, mund të përdoren nga ana e Departamenteve të SPPA-së, Asambleve Komunale, UNMIK-ut dhe OJQ-ve me qëllim të krijimit të “dyqaneve” të cilat ofrojnë një brez të gjerë të shërbimeve. Organizatat e tilla të cilat posedojnë me objekte të tilla lëvizëse duhet të konsiderojnë edhe mundësinë e ofrimit të këtyre objekteve për shfrytëzim nga ana e agjencive të tjera. Këto objekte mëpastaj do të kenë mundësi që të sigurojnë një vend fokus të mirë për marrjen e informatave që kanë të bëjnë me komunitetet minoritare.

### **Gjuha**

12. Duke i përshkruar udhëzimet të cilat janë lëshuar nga ana e PSSP-së, Departamentit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale, Departamentit të Drejtësisë, Departamentit për Shërbime publike, gjithashtu duhet të lëshohen edhe udhëzime të qarta të dedikuara për Departamentet e SPPA-së dhe UNMIK-un në përgjithësi, udhëzime këto që kanë të bëjnë me përdorimin e drejtë të gjuhës në dokumentet publike, fushatat publike dhe nënshkrimet publike. Politikat përkatëse duhet të përfshijnë edhe mundësinë për dhënien e sanksioneve të gjithë atyre të cilët dështojnë që tu përmbahen këtyre udhëzimeve, dhe kudo që është e mundur edhe dispozitat përkatëse me qëllim të sigurimit që në askënd nuk do të ndikohet në mënyrë indirekte për shkak se ata kanë dështuar që tu përmbahen udhëzimeve në një dokument i cili nuk është i lëshuar në gjuhën të cilën ata e kuptojnë.
13. Oficerët e SHPK-së, zyrtarët e zgjedhur dhe nëpunësit publik duhet ti nënshtrohen një trajnimit gjuhësor me qëllim të aftësisë të njohurive të tyre gjuhësore në shqip dhe sërbsisht, ashtu që ata të kenë mundësi të bashkëveprojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë me të gjithë sektorët e shoqërisë të cilëve ata u ofrojnë shërbime. Për zyrtarët të cilët punojnë në komunat me një përpjestim të dukshëm të popullatës turke, atëherë nevojitet edhe gjuha turke në këtë drejtim.
14. Dispozitat gjuhësore të Rregullores 2000/45 duhet të implementohen në tërësi në të gjitha komunat pas zgjedhjes së organeve të reja komunale. Administratorët Komunal të UNMIK-ut duhet të intervenojnë kurdo që është e nevojshme një gjë e tillë për të parë që kjo gjë të kryhet deri në fund.

### **Shkollimi**

15. Një vendim mbi gjuhën e cila duhet të përdoret nëpër shkolla kërkohet urgjentisht. Edhe pse vërehen vështirësi të cilat janë të pandashme gjatë marrjes së këtij vendimi, pa të kurrfarë përpilimi i çfarëdo plan-programi është i penguar.

16. Veprime të përqëndruara kërkohen me qëllim që të sigurohet që të gjithë fëmijët minoritar të ndjekin mësimet nëpër shkolla fillore dhe ato të mesme. Kjo çështje duhet mbërthyer jo vetëm nga ana e prindërve, por edhe nga ana e Drejtorëve të shkollave, mësuesve të shkollave dhe vetë nxënësve. Programe kundër keqtrajtimit të fëmijëve duhet të përpilohen dhe implementohen, me qëllim që të sigurohet që fëmijët të mos nxjerren nga shkollat për shkak të një ndjekjeje të tillë. Për fëmijët minoritar të cilët detyrohen që të udhëtojnë për në dhe jashtë shkollave, duhet t'ju sigurohet një transport adekuat apo përcjellje deri në ato shkolla.
17. **Qasja që duhet ta kenë minoritetet në shkollimin superior** programet trajnuase për mësimin e artizanateve duhet tu jipet një prioritet i veçantë. Objektet shkollore duhet të jenë të hapura edhe për trajnime të specializuara për zanate të ndryshme, si për komunitetin shumicë ashtu edhe për atë pakicë. Veçanërisht romët do të jenë ata të cilët do të përfitojnë nga mësimet e mbajtura për të rritur që ka për qëllim që personave në fjalë tu lëshohen çertifikatat mbi përfundimin e shkollave të mesme, apo nga trajnimet e specializuara për zanate dhe mësimet e gjuhëve të ndryshme.
18. Departamenti I UNMIK-ut për Arsim, UNICEF-i dhe agjencitë e tjera do të vazhdojnë që ti sigurojnë fëmijëve Ashkali, rom dhe ata egjiptas që të zëjnë hapin me mësimet e mbajtura deri më tani dhe sigurimin e mësimeve për ata fëmijë të cilët kanë nevojë për një gjë të tillë.

### **Ndihma sociale**

19. Fonde të mjaftueshme duhet të sigurohen me qëllim të sigurimit të programit të tanishëm të ndihmës sociale i cili u jep të drejtë kërkuesve përkatës të të gjitha komuniteteve, sipas nevojës.
20. Fushta e informimit publik duhet të ndërmerret me qëllim që të sigurojë që të gjithë kërkuesit e mundshëm të ndihmës sociale të dhënë nga UNMIK-u të kuptojnë procedurat për parashtrimin e kërkesës ashtu që në atë mënyrë të jenë në gjendje të parashtrojnë kërkesat e tyre autoriteteve relevante.

### **Punësimi**

21. Sa më shpejt që është e mundur duhet të nxjerret Ligji i plotë mbi punësimin, me dispozitat e saja efektive të cilat do të luftojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe indirekte diskriminimin dhe do të lejojë masa të përkohshme specifike të cilat do të nxisin dhe ushqejnë rritjen e nivelit të punësimit për grupet minoritare.
22. Departamenti i Punës duhet të iniciojë një politikë të punësimit me qëllim të dhënies fund të diskriminimit të pakicave në vendet publike të punës të të gjitha niveleve. Shembuj të praktikës së mirë, siç është rekrutimi i minoriteteve për tu bërë pjesëtarë të SHPK-së dhe sigurimi i trajnimit për minoritetet në Institutin për Shërbime Civile, duhet të shpërndahet gjerë e gjerë e pastaj të kopjohet dhe përshtatet nga ana e punëdhënësve të tjerë publik.

### **Mediat**

23. Komisioneri i Përkohshëm i Mediave duhet të veprojë shpejt me qëllim të implementimit të Kodit të Sjelljes në kuadër të vetë mediave. Një vëmendje vigjilente kërkohet me qëllim të luftimit të publikimeve dhe transmetimit të informatave të cilat mund të nxisin dhunë.
24. Duhet të inkurajohet dhe nxitet një transmetim në gjuhën e pakicave (si në TV ashtu edhe në radio), e cila duhet të implementohet nga RTK-ja si një radiotelevizion publik.

## **Prona**

25. Duhet marrur masa urgjente drejt formulimit dhe prezentimit sa më të shpejtë të rregulloreve procedurale të cilat do ti mundësojnë drejtoratit për çështje banesore dhe ato pronësore që ti përpunojë dhe bie vendime në lidhje me ankesat e pranuar.
26. Fonde të mjaftueshme duhet ti sigurohen këtij drejtorati me qëllim që të sigurohet një qasje e barabartë e minoriteteve, duke përfshirë këtu edhe financimin e ekipeve lëvizëse anembanë Kosovës dhe zyreve të cilat do të jenë më të qasshme nga vetë Serbia dhe Mali i Zi.
27. Udhëzime të qarta dhe uniforme të cilat kanë të bëjnë me ndihmën e dhënë për rindërtim minoriteteve me qëllim të luftimit të problemit të ndërtimeve ilegale në tokat të cilat janë pronë e pjesëtarëve të minoriteteve, duhet të përpunohen edhe mëtej, shpërndahen sa më gjerë dhe në mënyrë sistematike duhet përmbajtur udhëzimeve të tilla. Departamenti për Rindërtim duhet të marrë masa specifike në mënyrë që të sigurojë minoriteteve një qasje korrekte ndaj ndihmës së dhënë për rindërtim për vitin 2001.

## **Qasjet në strukturat politike**

28. PSSP-ja duhet që aq sa duhet të ushtrojë pushtetin e tij të ko-optimit në bazë të Rregullores 2000/45 me qëllim të sigurimit të konstituimit të asambleve komunale të cilat garantojnë një përfaqësim të drejtë dhe fer për minoritetet në secilën komunë.
29. PSSP-ja dhe Administratorët Komunalë duhet të sigurojnë që të drejtat e minoriteteve (duke përfshirë këtu edhe të drejtën për tu kthyer nëpër shtëpitë e tyre) të mbrohen dhe të përkrahen në mënyrë aktive nga ana e autoriteteve lokale në secilën komunë.

## **Iniciativat drejt tolerancës**

30. Brezi i iniciativave që do të promovojnë tolerancë duhet të koordinohen në tërësi si në nivel qëndror ashtu edhe në atë lokal.
31. Standardi Kodi i Praktikës, i rekomanduar nga Vlerësimi i Pestë për Minoritetet duhet të zhvillohet dhe nxjerret nga vetë UNMIK-u e cila u dedikohet të gjitha ndërmarrjeve dhe subjekteve të cilat punojnë nën përkujdësjë të UNMIK-ut, apo funksionojnë nga fondet e siguruara prej bashkësisë ndërkombëtare.
32. Programi i të drejtave të njeriut të bazuara në shkollimin e tyre duhet të zhvillohet edhe më tutje me qëllim që tu jipet shkollave në shfrytëzim, Një program i tillë praktik dhe i ngjashëm duhet të zhvillohet dhe të inkorporohet në kuadër të strukturave trajnuese dhe të gjitha organeve publike në përkrahje të Kodit të Praktikës të mbrojtur si mëlartë.

## **Kthimi**

33. Një strategji e përgjithshme për përmbushjen e nevojave të minoriteteve në vitin 2001 duhet të zhvillohet nga të gjitha agjencitë e përfshira në këtë proces. Kjo do të lejojë një përparim të koordinuar për sa i përket kthimit duke u fokusuar në kushtet të cilat nevojiten të rregullohen me qëllim që të inkurajohet një kthim i mundshëm. Një strategji e tillë duhet të ketë për qëllim që të merret me çështjet kyçe siç janë: siguria, prona dhe qasja ndaj shërbimeve përkatëse dhe për këtë arsye duhet të fokusohet në rradhë të parë në përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetet minoritare me qëllim që ata të mbeten në Kosovë. Siguria e shtuar dhe mirëqenia dhe këtyre komuniteteve do të ketë një porosi të qartë për të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur, e cila do të rezultojë me një kthim të mundshëm të tyre. Karakteri humanitar i kthimit duhet të mbahet edhe mëtej duke i përjashtuar të gjitha konsideratat e marra deri më tani.

**UNHCR/OSBE**  
**23 Tetor 2000.**